

1 E mërkurë, 23 mars 2022

2 [Seancë e hapur]

3 [I akuzuari hyn në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 9.30

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.

6 Sekretare, ju lutem paraqisni lëndën.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëdita të nderuar

8 Gjykatës. Kjo është lënda me numër KSC-BC-2020-05, Prokurori i

9 Specializuar kundër Salih Mustafës.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

11 Faleminderit, znj. Sekretare.

12 Së pari, ju kërkoj të pranishmëve të prezantohen.

13 Znj. Prokurore, kush është i pranishëm nga ana e ZPS-së?

14 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Mirëdita të nderuar Gjykatës.

15 Sot ZPS-ja përfaqësohet nga z. Alex Whiting, Zëvendësprokuror;

16 z. Cezary Michalczuk, Prokuror; Menaxhere e lëndës Line

17 Pedersen; Ryan Marr, stazhier; dhe unë Ndhmësprokurore,

18 Silvia D'Ascoli.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Faleminderit.

21 Znj. Mbrojtëse e Viktimave, keni fjalën.

22 ZNJ. PUES: [Përkthim] Mirëdita të nderuar Gjykatës.

23 Mirëdita të gjithëve. Viktimat pjesëmarrëse në këtë lëndë

24 përfaqësohen nga Bashkëmbrojtësja Annebrecht Vossenberq; dhe

25 unë Anni Pues, si Mbrojtëse.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

2 Faleminderit

3 Avokati i Mbrojtjes, keni fjalën.

4 Z. VON BONE: [Përkthim] Mirëdita, e nderuara Gjykatëse.

5 Mbrojtja sot përfaqësohet nga z. Betim Shala, Bashkëmbrojtës;

6 Fatmir Pelaj, Hetues dhe Përkthyes; unë, Julius von Bone. Dhe

7 sot në sallë është i pranishëm dhe z. Salih Mustafa.

8 Dhe nëse është e mundur, dëshiroj që të ngre një çështje

9 praktike përpara se të fillojmë me dëshmitarin.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më

11 pas mund ta bëjmë këtë gjë.

12 Për procesverbalin, ky proces zhvillohet përpara Trupit

13 Gjykues numër 1. Gjykatësi Mikula është i lidhur me

14 videolidhje me ne.

15 Sot do të dëgjojmë dëshminë e dëshmitarit të Mbrojtjes me

16 numër 200, z. Brahim Mehmetaj. Por, përpara kësaj, Trupi

17 Gjykues dëshiron që të trajtoi disa aspekte.

18 Së pari, me Mbrojtësen e Viktimave dëshirojmë të

19 diskutojmë diçka. Keni bërë të ditur gjatë seancës së datës 21

20 mars se do të dorëzoni një përgjigje ndaj parashtrimin të

21 protokolluar F344 të bërë nga Ministria e Drejtësisë së

22 Republikës së Kosovës, në momentin e duhur. Me këtë duam t'ju

23 themi se Trupi Gjykues pret nga Mbrojtësja e Viktimave që këtë

24 përgjigje ta japë brenda afatit kohor të parashikuar nga

25 rregullorja.

1 Së dyti, edhe kjo ka të bëjë me Mbrojtësen e Viktimave.
2 Kemi vërejtur parashtrimet tuaja që keni bërë gjatë të njëjtës
3 seancë, në të njëjtën datë, ku keni bërë të ditur se synoni të
4 kërkoni emërimin e një eksperti për të llogaritur dëmin
5 material të pretenduar të pësuar nga viktimat e drejtpërdrejta
6 si rezultat i krimeve të pretenduara në aktakuzë.

7 Rrjedhimisht, Trupi Gjykues urdhëron Mbrojtësen e
8 Viktimave të propozojë një ose më shumë ekspertë për të
9 asistuar Trupin Gjykues në vlerësimin e dëmshpërblimit
10 financiar lidhur me dëmin material që pretendohet se kanë
11 pësuar viktimat e drejtpërdrejta, jo më vonë se dita e premte
12 22 prill. Kjo nuk cenon vendimmarrjen përfundimtare të Trupit
13 Gjykues, sa i takon fajësisë apo pafajësisë të të akuzuarit
14 dhe nuk cenon asnjë urdhër që mund të lindë nga ajo
15 vendimmarrje, urdhër për dëmshpërblim pra.

16 Këtu mbyllet ky urdhër i lëshuar gojarisht.

17 Sa i takon aspektit tjetër, znj. Sekretare, ju lutem të
18 kalojmë në seancë private.

19 [Seancë private]

20 [Seancë private teksti i fshirë]

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19 [Seancë e hapur]

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
21 jemi në seancë publike sërish.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
23 Faleminderit.

24 Tani kalojmë në diçka që ka të bëjë me ZPS-në.

25 Vërejmë se ZPS-ja nuk e ka nxjerrë të gjithë materialin

1 që synon të përdorë gjatë kundrapyetjeve që do t'ia bëjë
2 Dëshmitarit 200. Ne e pamë që është në *Legal Workflow* ky
3 material, por nuk është nxjerrë zyrtarisht. Mënyra se si ruhen
4 materialet në *Legal Workflow*, ka edhe gjithashtu pasojë sa i
5 takon mënyrës se si mund t'i gjesh. Prandaj pyetja që Trupi
6 Gjykues ka është: ZPS-ja ka ndërmend që ta nxjerrë materialin,
7 dhe nëse po, kur?

8 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar
9 Gjykatëse.

10 Materialet për të cilën ju e keni fjalën, besoj se janë
11 materialet nga burimi i hapur, nuk janë nxjerrë përmes paketës
12 në *Legal Workflow*, paketës së nxjerrjes, sepse siç e thamë dje
13 nuk synojmë që t'i shtojmë këto materiale në listën e provave
14 materiale. Por, duke qenë se janë aty në dispozicion për arsye
15 kredibiliteti gjatë kundrapyetjeve, ne gjithsesi i kemi futur
16 në listën e prezantimit të materialeve si më parë.

17 Por, nëse të nderuar Gjykatës preferojnë që këto
18 dokumente të nxirren zyrtarisht përmes një pakete në *Legal*
19 *Workflow*, patjetër që këtë mund ta bëjmë.

20 Do të konsultohem me menaxheren e lëndës, por besoj se
21 mund ta bëjmë edhe sot paradite gjatë kohës kur dëshmitarit do
22 t'i bëhen pyetje nga pala thirrëse.

23 Por kjo është arsyeja.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
25 Faleminderit znj. Prokurore.

1 Atëherë unë do të lëshoj një urdhër gojarisht tani. Trupi
2 Gjykues urdhëron ZPS-në që të nxjerrë materialin që synon të
3 përdorë gjatë kundrapyetjeve që do t'ia bëjë dëshmitarit në
4 *Legal Workflow*, sa më shpejt të jetë e mundur. Ju e thatë që
5 do ta bëni gjatë paradites, por maksimumi deri në fund të
6 ditës sot.

7 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë. Për sqarim,
8 të veprojmë kështu për të gjithë dëshmitarët e ardhshëm?

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.

10 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Trupi
12 Gjykues në të ardhmen kërkon që, kur një palë apo pjesëmarrës,
13 synon të përdorë për pyetjet që ia bën dëshmitarit material që
14 nuk është nxjerrë përpara, duhet që të bëhet e ditur qartë se
15 çfarë është e re, çfarë nuk është e re në këto materiale, në
16 mënyrë që të mos detyrohemi që të bëjmë një krahasim të
17 materialeve me materialet që janë nxjerrë më përpara dhe duhet
18 kërkuar leje për t'i përdorur këto materiale siç parashikohet
19 në paragrafin 31 të Vendimit për Zhvillimin e Procesit.

20 Sepse dje e thamë, nuk preferojmë që të bëhet ashtu sepse
21 do të na duhet që ne si Trup Gjykues të bëjmë kërkimin tonë
22 për të parë çfarë është material i ri, çfarë nuk është
23 material i ri. Prandaj do të ishte më e organizuar nëse do të
24 merrnim një njoftim zyrtar.

25 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Patjetër, e nderuara Gjykatëse.

1 Do të shënojmë në një shtyllë të listës materialeve që duam të
2 përdorim se çfarë është nxjerrë përpara dhe për ato që janë të
3 reja do të bëjmë nxjerrje zyrtare. Dhe nëse e pranojnë të
4 nderuarit Gjykatës, ne do të kërkojmë leje për materialin e
5 shtuar rishtazi me anë të postës elektronike të emailit që do
6 të dërgojmë për materialet përkatëse.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
8 Faleminderit.

9 Në rregull. Këtu mbyllet ky urdhër i lëshuar gojarisht.

10 Sa u takon dëshmitarëve të Mbrojtjes të cilët janë
11 planifikuar të japin dëshmi javën e ardhshme, dëshiroj t'ju
12 rikujtoj se në përputhje me paragrafin 34 të Vendimit mbi
13 Zhvillimin e Procesit, pala thirrëse, që në këtë rast është
14 Mbrojtja, duhet t'i vendosi në dispozicion Trupit Gjygues,
15 NJAGJ-së dhe subjekteve jo-thirrëse, listën në fjalë përmes
16 postës elektronike. Pra listën e dëshmitarëve, sepse në varësi
17 se si do të ecim këtë javë, besoj se kjo listë do të jetë në
18 dispozicionin tonë në ditët në vijim.

19 Z. VON BONE: [Përkthim] Patjetër, e nderuara Gjykatëse.
20 Do ta bëjmë këtë gjë. Ka të bëjë dhe me çështjen që desha të
21 ngre më përpara.

22 Që është si vijon. Kemi bërë konsultime me Zyrën e
23 Mbështetjes të Mbrojtjes së Dëshmitarëve. Javën e ardhshme
24 kemi 4 ditë në dispozicion, kështu që është e mundshme të
25 mbarojmë 3 dëshmitarë që janë numri 300, 400 dhe 500.

1 Pas kësaj, javën tjetër, kemi 3 ditë: e hënë, datë 4
2 prill; e martë, datë 5; dhe e mërkurë, datë 6 prill. Nëse nuk
3 do të jemi në gjendje që të përfundojmë 2 dëshmitarë brenda
4 asaj jave, kjo do të thotë që dëshmitari i tretë do të duhet
5 të qëndrojë këtu 4 ditë ose më gjatë, në pritje të ditës kur
6 do të vijë.

7 Në konsultim me Zyrën e Dëshmitarëve, besoj se do të
8 ishte më e pranueshme që për atë javë të parashikojmë vetëm 2
9 dëshmitarë, Dëshmitarin 600 dhe Dëshmitarin 700. Edhe të mos
10 parashikojmë ndonjë të tretë. Të mos ta vendosim me radhë pra,
11 sepse ekziston pastaj mundësia që ai person të qëndrojë këtu 4
12 ditë.

13 Kjo është kërkesa e Mbrojtjes. Jam shumë i sigurt që Zyra
14 e Dëshmitarëve do të preferonte më shumë që të parashikonim 2
15 dëshmitarë dhe jo 3.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do
17 t'ju jap përgjigje për këtë. Por që tani mund t'ju them se
18 Trupi Gjykses preferon shumë që të ketë 3 dëshmitarë. Të
19 paktën të ketë një dëshmitar në radhë, në pritje. Sepse, nëse
20 shikoj kalendarin, shikohen që të dy këta me 2 orë pyetje nga
21 pala thirrëse, sipas vlerësimit, sallën e kemi në dispozicion
22 javën e ardhshme dhe javën tjetër, pastaj çdo javë jemi
23 përpjekur që ta kemi 3 ditë në dispozicion dhe unë mendoj se
24 është shumë e rëndësishme që ta shfrytëzojmë kohën që na jepet
25 në sallën e gjyqit dhe kohën që kemi rezervuar për të

1 zhvilluar procesin.

2 Unë do të këshillohem me koleget për këtë, por ky është
3 qëndrimi fillestar. Nëse do të vazhdonim kështu siç
4 propozojmë, do të thotë që edhe për javët e ardhshme mund të
5 ndodhë që të bëjmë vetëm 2 dëshmitarë, sepse çdo javë do ta
6 kemi 3 ditë në dispozicion sallën e gjyqit. Varet edhe nga
7 zhvillimi i gjërave, sigurisht. Varet se si do të shkojnë
8 gjërat në sallë. Por kam një lloj ngurrimi sa i takon këtij
9 propozimi, por do t'ju përgjigjem.

10 Z. VON BONE: [Përkthim] Unë jam konsultuar me Zyrën e
11 Dëshmitarëve, vetëm për këtë javë ishte ky problem. Por,
12 parimisht e kuptoj mirë se duhen 3 dëshmitarë të parashikuar
13 në javë, kur mendohet se pyetjet do të zgjasin 2 orë, që do të
14 thotë që dëshmitari mund të mbarojë brenda ditës. Mirëpo, për
15 atë javë në veçanti dukej se ishte problematike për Zyrën e
16 Dëshmitarëve, prandaj dhe unë e bëra këtë propozim.
17 Megjithatë, jua lë juve në dorë dhe pastaj në varësi të kësaj,
18 do të kontaktoj Zyrën e Dëshmitarëve.

19 Dhe mund ta bëj kalendarin këtë javë, madje edhe sot, për
20 javën tjetër dhe për javën që vjen pas saj dhe mund t'ju
21 dërgoj me email.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nëse
23 mund ta verifikoj, pse ajo javë? Sepse besoj se më kuptoni se,
24 nëse ne japim pëlqimin për atë javë, do të kthehet pastaj në
25 një lloj precedenti. Është kërkesë vetëm për atë javë, apo

1 është kërkesë për të gjitha javët e ardhshme? Se thuajse të
2 gjithë dëshmitarët parashikojnë 2 orë, ndonjëherë 3.

3 Z. VON BONE: [Përkthim] Po. Siç e thashë, këtë unë e mora
4 nga Zyra e Dëshmitarëve për atë javë, prandaj dhe unë e
5 përmend për atë javë. Për ne, mendojmë se 3 dëshmitarë në javë
6 do të ishte në rregull. Por me sa duket ka diçka aty.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
8 Faleminderit.

9 Z. VON BONE: [Përkthim] Nuk bëhet fjalë për të vendosur
10 një precedent.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Me sa
12 e kuptoj, ka të bëjë vetëm me atë javë. Në rregull, do t'ju
13 kthej përgjigje për këtë.

14 Znj. Prokurore nuk e di a keni diçka për të thënë për
15 këtë?

16 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Jo, nuk kemi gjë. Jemi të
17 gatshëm të vazhdojmë.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
19 Mbrojtësja e Viktimave?

20 ZNJ. PUES: [Përkthim] Jo, asgjë.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
22 mirë. Mund të vijojmë tani me dëshminë e Dëshmitarit të
23 Mbrojtjes me numër 200.

24 Znj. Asistente e sallës, ju lutem shoqërojeni dëshmitarin
25 të hyjë në sallë.

1 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

3 Mehmetaj, mirëdita.

4 DËSHMITARI: Mirëmëngjesi.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë

6 se keni ardhur në Dhomat e Specializuara.

7 DËSHMITARI: Faleminderit.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Besoj

9 më dëgjoni mirë, siç e shikoj.

10 DËSHMITARI: Po.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë

12 mirë. Pikë së pari, si jeni?

13 DËSHMITARI: Mirë, besoj. Faleminderit.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në

15 rregull. Sot do të fillojmë me dëshminë tuaj, z. Mehmetaj. Ju

16 kanë thirrur të dëshmoni përpara Dhomave të Specializuara në

17 çështjen gjyqësore, Prokurori i Specializuar kundër Salih

18 Mustafës, për të ndihmuar Trupin Gjykses që të marrë një

19 vendim.

20 Pasi të bëni deklaratën solemne për të thënë të vërtetën,

21 do t'ju bëjnë pyetje Avokati i Mbrojtjes i z. Mustafa, pastaj

22 avokatët që përfaqësojnë viktimat që janë pranuar të marrin

23 pjesë në këtë çështje gjyqësore, që janë ulur në të majtën

24 tuaj dhe përfaqësuesit e Prokurorisë. Pastaj në fund nga ne,

25 anëtarët e Trupi Gjykses. Në rregull?

1 Dëshiroj që t'ju jap disa udhëzime se si t'ju përgjigjeni
2 pyetjeve që do t'jua bëjnë.

3 Z. Mehmetaj, ju lutem, dëgjojeni me kujdes secilën
4 pyetje. Nëse nuk e kuptoni, lirisht mund të kërkoni që pyetja
5 t'ju përsëritet. Duam që të na thoni të vërtetën, të na thoni
6 se çfarë keni parë vetë, çfarë keni përjetuar, dëgjuar apo
7 keni ndjerë ju vetë. Nëse nuk e keni parë apo dëgjuar vetë,
8 por e keni marrë vesh në ndonjë mënyrë tjetër, duhet të na e
9 thoni këtë gjë dhe të na e shpjegoni. Mund të mos ju kujtohen
10 të gjitha hollësitë e ngjarjeve, kjo s'ka problem. Dëshmoni
11 vetëm për aq sa ju mbani mend. Mos merrni me mend, mos sajoni
12 gjëra, se s'ka asgjë të keqe të thoni që, nuk e di.

13 I kuptuat të gjitha këto z. Mehmetaj?

14 DËSHMITARI: Po.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
16 Mehmetaj, ju lutem do të flisni më afër me mikrofonin. Se për
17 ndryshe nuk ju dëgjojnë përkthyesit se çfarë thoni.

18 DËSHMITARI: OK. Në rregull.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Faleminderit.

21 Dëshiroj t'ju jap tani disa këshilla praktike për
22 dëshminë, z. Mehmetaj.

23 Çdo gjë që themi këtu, përkthehet dhe regjistrohet.
24 Prandaj dhe është e rëndësishme që sapo ju thashë të flisni sa
25 më afër mikrofonit, të flisni qartë dhe të flisni ngadalë që

1 t'ju jepni mundësi përkthyesve të përkthejnë gjithçka. Duhet
2 të flisni vetëm pasi personi që jua bën pyetjen ka mbaruar së
3 foluri. Sepse përndryshe mbivendosen përkthyesit mbi njëri-
4 tjetrin dhe nuk na vjen as neve përkthimi.

5 Kur t'jua bëjnë një pyetje, numëroni njëherë me vete deri
6 në 5 dhe pastaj përgjigjuni. Sepse kjo pauzë prej 5 sekondash
7 është shumë e rëndësishme për ne që të dëgjojmë siç duhet, të
8 përkthejmë siç duhet dhe të regjistrojmë siç duhet ato që po
9 thoni ju.

10 Nëse keni pyetje, nëse keni nevojë për një pushim,
11 mjafton të ngrini dorën dhe unë do t'jua jap fjalën dhe ju
12 mund të na thoni se për çfarë keni nevojë.

13 I keni kuptuar të gjitha këto z. Mehmetaj?

14 DËSHMITARI: Po.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
16 mirë.

17 Siç me çdo dëshmitar, do t'ju kërkoj tani të lexoni
18 deklaratën solemne për të thënë të vërtetën. Ju rikujtoj se
19 përbën vepër penale në juridiksionin e Dhomave të
20 Specializuara dhënia e dëshmisë së rreme. E kuptoni këtë?

21 DËSHMITARI: Po, e kuptoj.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
23 mirë. Z. Mehmetaj, ju lutem lexoni tekstin që jua vunë në
24 dispozicion tani.

25 DËSHMITARI: I ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë sime

1 dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj solemnisht se do të
2 them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe vetëm të vërtetën dhe
3 nuk do të mbaj të fshehtë asgjë për të cilën kam dijeni.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
5 Faleminderit z. Mehmetaj. Tani je nën betim për të thënë të
6 vërtetën.

7 Mund të fillojmë me dëshminë e z. Mehmetaj, duke filluar
8 me pyetjet që do t'ia bëjë Avokati i Mbrojtjes.

9 Z. von Bone, keni vlerësuar se ju duhen 3 ore për
10 pyetjet. Si zakonisht, ju lutem informojeni Trupin Gjykses
11 nëse keni ndonjë ndryshim në lidhje me këtë, për arsye
12 planifikimi.

13 Keni fjalën.

14 Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit e nderuar Gjykatëse.

15 DËSHMITARI: BRAHIM MEHMETAJ

16 Pyetje nga z. Von Bone:

17 Py. Mirëdita, z. Mehmetaj.

18 Z. Dëshmitar, dëshiroj që të kthehemi në vitet '80, në
19 veçanti në periudhën 1998 dhe 1989. Asokohe, i jeni bashkuar
20 një organizate ilegale, mund të na thoni se si quhej kjo
21 organizatë që vepronte në ilegalitet?

22 Pë. Po, i nderuar Avokat. Është e vërtetë që unë nga fundi i
23 viteve '88 i jam bashkuar organizatës ilegale të asaj kohe të
24 ashtuquajtur Lëvizja Për Republikën e Kosovës, ose me
25 shkurtesë LPRK.

1 Py. Po. Asokohe, kjo vepronte nën një grup me tre persona.

2 Pyetja ime është kjo: cili ishte qëllimi i atij grupi të
3 përbërë nga tre persona dhe kësaj organizate që vepronte në
4 ilegalitet?

5 Pë. Realisht në atë kohë për shkak të specifikave që kemi
6 qenë dhe rrezikshmërisë për të zhvilluar aktivitetet,
7 funksionimi ka qenë në grupe të vogla ose "këshilla popullore"
8 i kemi quajtur, të cilët janë të përbërë prej 3 anëtarëve.
9 Këshillat popullore kanë pas për detyrë përgatitjen e mundshme
10 për ndonjë situatë lufte, në atë kohë, kundrejt okupatorit
11 edhe vetëdijesimin, aq sa është e mundshme, të qytetarëve se e
12 vetmja zgjidhje për liri dhe çlirim prej okupatorit ka qenë
13 lufta e armatosur.

14 Py. Z. Dëshmitar.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
16 Avokat i Mbrojtjes, një minutë ju lutem, ju kërkoj ndjesë.
17 Pyes znj. përkthyesë, e ka fjalën për dëshmitarin apo për
18 Avokatin?

19 Z. Dëshmitar, përkthyesit nuk ju dëgjojnë shumë mirë.

20 Duhet të gjejmë një mënyrë se si ta përmirësojmë këtë gjë.

21 Do ta provojmë dhe një herë.

22 Mund të vijoni, z. Avokat.

23 Z. VON BONE: [Përkthim]

24 Py. LPRK siç e thatë ju, po ngiste vetëdijesimin, ndërgjegjen
25 në popullatë. Për çfarë vetëdijesimi e keni fjalën?

1 Pë. Ne realisht ishim nën okupim edhe jetonim nën një presion
2 të madh, nën një dhunë prej një shteti i cili realisht
3 ushtronte çdo të keqe ndaj popullit shqiptar. Dhe ishte
4 vullneti që të bashkoheshim dhe të punonim për të gjetur liri,
5 për të ardhur tek liria sa më parë. Kjo ka qenë synimi i krejt
6 asaj.

7 Py. Kjo LPRK-ja, nga çfarë lloj personash përbëhej?

8 Pë. Tash, persona të vullnetit të mirë për t'u bashkuar rreth
9 konceptit të organizimit për të arritur lirinë. Vullnetarë,
10 djem, vasha të reja e kështu me radhë.

11 Py. Si u zhvillua kjo organizatë, mund të na e thoni?

12 Pë. Se si u zhvillua kjo organizatë, nuk është në
13 përgjegjësinë time. Realisht unë kam qenë i organizuar në një
14 këshill popullor në Prishtinë me tre njerëz edhe organizimi në
15 nivel të përgjithshëm të organizatës, nuk e kam pas të njohur
16 për atë kohë.

17 Py. Kjo lëvizje qëndroi gjithmonë së bashku, apo pati
18 ndonjëherë në ndonjë moment të caktuar ndonjë ndarje brenda
19 organizatës?

20 Pë. Jo, ka ndodh një ndarje dikur në vitin 1993. Është nda
21 lëvizja dhe janë formuar dy organizata prej asaj lëvizje. Ka
22 dalë LPK dhe LKÇK-ja. Dhe unë kam vazhdu me qenë pjesë e LKÇK,
23 Lëvizja Kombëtare për Çlirimin e Kosovës.

24 Py. Në fakt, a ka sjellë ndonjë ndryshim aktiviteti i LKCP
25 [sipas përthimit] në LKRP [sipas përthimit]?

1 Pë. Nuk po e kuptoj pyetjen në çfarë drejtimi, por unë mendoj
2 që një dallim sigurisht ka qenë, sepse...

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,
4 një moment. Ju lutem, a mund ta perifrazoni pak ndryshe
5 pyetjen, se as unë nuk e kisha të qartë se për çfarë pyetet.

6 Z. VON BONE: [Përkthim]

7 Py. Përderisa kishte një ndarje, pra kishim dy degë, kishim
8 LKÇK dhe LPRK. Doja të pyesja, a kishte ndonjë dallim ndërmjet
9 këtyre dy organizatave sa i takon veprimtarisë së tyre?

10 Pë. Për aq sa di unë, dallimi ka qenë sepse LKÇK-ja vepronte
11 ne Kosovë, ndërsa LPRK-ja vepronte jashtë Kosovës. Ndoshta ka
12 pas edhe diçka në Kosovë. Por LKÇK-ja i ka pas strukturat në
13 Kosovë. Për aq sa di unë.

14 Py. Me funksionimin e LPK që vazhdonte, në cilat zona ata
15 kërkonin që njerëzit të mund t'i bashkoheshin këtyre
16 organizatave? Kësaj organizate?

17 Pë. Nuk e di, S'e kam të njohur këtë.

18 Py. Në cilën periudhe kohe iu bashkuat juve LDK-së?

19 Pë. Unë LDK-së ju jam bashku që në themelim, në vitin 1989,
20 1990.

21 Py. Dhe çfarë pozite, çfarë pozicionesh ke pasur në këtë
22 parti?

23 Pë. Kam pasur pozita pothuajse në të gjitha strukturat e
24 funksionimit të LDK-së, duke filluar -- kam qenë kryetar i
25 degës së Rinisë së LDK-në për Prishtinë. Pastaj anëtar kryesie

1 në nivelet e degës e kështu me radhë, deri anëtar i Këshillit
2 të Përgjithshëm të LDK-së.

3 Py. Në rregull. Në cilin vit është formuar njësitit BIA, a e
4 dini këtë?

5 Pë. Guerilja BIA realisht, zyrtarisht është formuar më 20 maj
6 1998. Ndërsa funksionimin edhe punën e kemi ba që nga dalja e
7 Salih Mustafës, komandant Calit nga burgu diku, nëse s'gaboj,
8 në gusht ose aty dikur. Kur është liruar nga burgu unë e kam
9 taku edhe menjëherë jemi marrë vesh që të fillojnë me ba
10 organizimin e strukturave për UÇK-në, njësitit të UÇK-së.

11 Py. Cili ishte qëllimi i njësitit BIA?

12 Pë. Qëllimi i njësitit ose gueriljes BIA, ose qëllimi i
13 ushtarëve të UÇK ka qenë liria, lufta e armikut. Lufta ndaj
14 armikut me qëllim arritjen e lirisë, çlirimin e vendit. Ky ka
15 qenë qëllimi kryesor.

16 Py. Në çfarë zona e ushtronte veprimtarinë e vet njësitit BIA
17 ose njësitet BIA?

18 Pë. Shikoni, në bazë të përgjegjësisë ose kompetencave që ka
19 pas BIA, nuk ka pas përgjegjësi territoriale. Nuk ka pas
20 ndonjë zonë të veçantë të cilën e ka kontrolluar. Ndërsa ka
21 vepruar ose ka operuar ose si me e quajjt, pothuajse në
22 Prishtinë në qytet, në gjithë qytetin, në periferi të
23 Prishtinës, nëpër fshatra zonat rurale. Edhe ka kontribuar
24 edhe në komuna të tjera Obiliq, Fushë-Kosovë dhe në zona të
25 tjera që tash s'po më kujtohen. Por ka kontribuar aty ku ka

1 mundur me dhënë kontribut.

2 Py. Nëse shohim njësitin BIA dhe mënyra se ky njësit ishte i
3 organizuar në Prishtinë, a mund të na thuash ju lutem, se si
4 ishte i organizuar ky njësit? Apo si duhet t'i mendojmë ne
5 personat të cilët ishin anëtarë të BIA-s, ku ishin të vendosur
6 ata? Mund të na thoni diçka më tepër lidhur kësaj?

7 Pë. Po. Koha kur ne vepronim, ishte një kohë me rreziqe mjaft
8 të mëdha. Po flas për Prishtinën. Prishtina ishte komplet nën
9 mbikëqyrjen dhe kontrollin e forcave militare, paramilitare të
10 serbëve të asaj kohe. Organizimi nuk ishte i lehtë. Realisht
11 ne e kemi bazuar organizimin apo ofrimin e njerëzve në të
12 cilët kemi pas besim, jemi nis prej familjeve tona pastaj prej
13 miqve, shokëve, njerëz të cilët kanë pas ndonjë bagazh
14 patriotik, me të cilët kemi mund me bisedu me ta. Dhe ashtu
15 duke biseduar, duke i bindur që jemi në rrugë të drejtë, kemi
16 filluar formimin e njësiteve, në grupe të vogla. Gjithmonë me
17 qëllim që me i ruajt njerëzit, mos me pas shumë njerëzit
18 informacion rreth punës tonë. Dhe kemi vazhduar kështu me i ba
19 njësitet kryesisht me familjarë dhe njerëz të besueshëm,
20 njerëz që realisht kemi mund me besu në ta.

21 Py. Ku në Prishtinë operonte njësiti?

22 Pë. Në varësi të periudhës kohore që ju intereson ju, por në
23 fillim realisht ka operuar në disa lagje të Prishtinës. Pastaj
24 duke u rritur, duke u shumëzuar, pothuajse në të gjithë
25 Prishtinën.

1 Py. E kuptoj. Pra në disa lagje të Prishtinës, në të gjithë
2 Prishtinën. Por, ku e kishin vendin, ku qëndronin njerëzit në
3 fakt?

4 DËSHMITARI: Më vjen keq.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
6 Sekretare, duhet të sjellim diçka tjetër, apo--.

7 DËSHMITARI: Më vjen keq për këtë incident që ndodhi me
8 ujin.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mos u
10 shqetësoni. Mund t'i ndodhë të gjithëve.

11 Znj. Sekretare faleminderit shumë për ndihmën.

12 DËSHMITARI: Kryesisht --. A të vazhdoj me përgjigjen?

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
14 Prisni pak. Do ju kërkoj Avokat i Mbrojtjes, që të bëni edhe
15 njëherë pyetjen dhe pastaj dëshmitari të fillojë sërish të
16 japë përgjigje.

17 Z. Avokat, e keni ju fjalën.

18 Z. VON BONE: [Përkthim]

19 Py. Ju po flisnit për personat të cilët ishin në lagjet e
20 Prishtinës dhe në të gjithë Prishtinën. Pyetja ishte, ku
21 qëndronin këta njerëz? Çfarë kanë bërë prej kësaj pike?

22 Pë. Në fillim të organizimit dhe për një kohë të caktuar, ne
23 të gjithë aktivitetin e kemi ba nëpër shtëpitë tona. Për
24 shembull, një prej bazave, një prej vendeve, vendqëndrimit ku
25 kemi qenë është shtëpia ime. Ka qenë edhe shtëpia e Calit dhe

1 të disa njerëzve të tjerë të besueshëm. Atje jemi takuar, aty
2 kemi biseduar, varësisht prej punëve që kemi pasur. Por,
3 kryesisht i kemi përdorur shtëpitë tona fillimisht, në fillim
4 të organizimit. Pastaj kemi përdorur edhe shtëpi të tjera,
5 shtëpi vendqëndrime që kanë qenë, ne i kemi vlerësuar që kanë
6 qenë pak më të sigurta me ndej në to. Shtëpi të njerëzve që
7 kemi rënë dakord me ta i kemi marrë në shfrytëzim dhe i kemi
8 përdorur.

9 Py. Në fakt, çfarë bëhej kryesisht nga këto shtëpi? Cilat
10 ishin gjërat kryesore që bëheshin?

11 Pë. Në ato shtëpi organizoheshin takime, biseda, shtypeshin
12 materiale edhe bisedohej. Realisht aty edhe vinin shokët tanë
13 që kanë qenë ilegalë, kanë qëndruar ilegal ose që kanë ardhur
14 prej vendeve të tjera, që nuk kanë mund me lëviz lirshëm, kanë
15 qëndruar aty. Kanë qenë ndoshta multifunksionale ato shtëpi
16 për aktivitetin tonë që ne e kemi ba në atë kohë.

17 Py. Njerëzit në një shtëpi, a e dinin apo i njihnin personat
18 që operonin nga një shtëpi tjetër? Apo punonin veçmas?

19 Pë. Në atë drejtim ne kemi qenë të kujdesshëm për shkak të
20 rrezikut dhe disa njerëz e kanë ditur për një shtëpi, njerëz
21 të tjerë që kanë qenë bashkë me ne, nuk e kanë ditur për atë
22 shtëpi, ata kanë pas një vend tjetër ku kanë qëndruar. Edhe
23 kështu, për arsye sigurie nuk ka mund me i dit njeri të gjitha
24 vendet dhe nuk ka mund as me i njoh të gjithë njerëzit të
25 cilët kanë qenë në organizatë.

1 Py. Përveç takimeve, a kishte arsye të tjera se pse duhej të
2 përdorej një shtëpi dhe në qoftë se po, a mund të na thoni ju
3 lutem se çfarë arsyesh kishte për të përdorur një shtëpi?

4 Pë. Jo, nuk më kujtohet që ka pas ndonjë arsye tjetër.

5 Py. Në rregull. Ju keni qenë anëtar i njësitit BIA, është
6 kështu?

7 Pë. Po, sigurisht.

8 Py. Çfarë roli keni pasur juve konkretisht?

9 Pë. Unë kam pas rol, me thënë që nga themelimi ose që
10 marrëveshja me Calin, kam qenë zëvendëskomandant i Calit apo
11 ndihmës i tij. Gjithmonë deri në një periudhë të caktuar kur
12 kam ndërruar detyrën.

13 Py. A mund të na thoni se si ishte organizuar BIA? A kishte
14 njësi konkrete që kishin detyra të caktuara, apo të gjithë
15 bënin çdo gjë? A mund të na thoni pak se si ishte organizuar
16 BIA?

17 Pë. Po, patjetër. Në themelimin, realisht në emërimin zyrtar
18 të BIA-s që ka ndodhur në 20 maj 1998, është formuar shtabi i
19 gueriljes BIA, i cili brenda shtabit kanë qenë të themeluara
20 apo u themeluan 4 sektorë për funksionim brenda BIA-s. Ato
21 sektorë ishin: sektori i shëndetësisë, sektori i logjistikës,
22 sektori i informacionit dhe sektori për moralin politik.

23 Realisht, komplet misioni i BIA-s përmbyllej me këto
24 sektorë që i thashë, pastaj përveç edhe lufta që ishte ndaj
25 armikut, si qëllimi ynë kryesor.

1 Py. Në rregull. A mund të na shpjegoni për shembull se çfarë
2 bënte sektori i shëndetësisë i BIA-s?

3 Pë. Rrethanat e atëhershme, kushtet e jetesës ishin mizerje,
4 të popullatës. Po flas për në Prishtinë, por kjo vlen për
5 krejt Kosovën. Kjo për shkak se okupatori kishte futur duart
6 edhe në shëndetësi, e kishte ndal edhe humanizmin i cili i
7 takon ta ketë çdo njeri në këtë botë, kishte penguar edhe që
8 njerëz që ruhen nëpër -- shqiptarë që ruhen nëpër institucione
9 dhe ne në këtë drejtim u detyruam realisht të bënim diçka.

10 Biseduam me doktoreshën Flora Brovina, ajo ashtu edhe ma herët
11 i kishte disa, kishte një organizatë humanitare ku
12 kontribuonte në këtë drejtim, biseduam dhe informuam. Realisht
13 në atë kohë, në fillim, kemi ba disa qendra shëndetësore ku
14 janë shëndoshë njerëz që kanë pas nevojë me u shëndosh, janë
15 trajtuar të plagosurit që kanë ardh nga lufta, e kështu me
16 radhë. Derisa ne kemi mund me qëndru në qytet, që i bie deri
17 më 24 mars 1999, ato qendra kanë funksionuar, në këtë drejtim.
18 Mirëpo kanë qenë në kuadër të organizimit të BIA-s dhe
19 përgjegjëse për sektorin e shëndetësisë ka qene Flora Brovina,
20 bashkë me një staf, që e ka pas, të profesionistëve të cilët
21 kanë kontribuar në këtë drejtim. Ky ka qenë një rol.

22 Pastaj ka pas edhe role të tjera, grumbullimin e
23 medikamenteve dhe furnizimin me medikamente nëpër spitale
24 ushtarake që kanë qenë në zonën operative të Llapit, por edhe
25 më tutje, ku ka mundur me ndihmu.

1 Flora Brovina ka qenë jashtëzakonisht në këtë drejtim, e
2 angazhuar.

3 Py. E kuptova që kishte edhe një sektor që merrej me
4 logjistiken. A mund të na e shpjegoni pak se çfarë bënte ky
5 sektor?

6 Pë. Kryesisht edhe ky sektor ndoshta më shumë e ka pas
7 aspektin humanitar, por edhe [të] nevojës për ekzistence. Në
8 aspektin humanitar ka qenë, në atë kohë ka pas jashtëzakonisht
9 shumë të zhvendosur nga zonat e luftës të cilët kanë ardhur në
10 Prishtinë dhe kanë gjetur strehë, por kanë pasur mungesë
11 ushqimi, mungesë veshmbathje, mungesë shtroje, mbuloje,
12 batanije e gjëra të tjera. Dhe në atë drejtim ka kontribuar ai
13 sektori i logjistikës. Edhe në anën tjetër gjithmonë, duke i
14 pasur parasysh nevojat për furnizim për njësitet edhe për të
15 gjithë ushtarët e lirisë të asaj kohe. Janë ndihmuar edhe
16 brigada edhe zona prej Prishtinës. Sepse Prishtina ka qenë
17 burim furnizimi për gjithçka në atë kohë. E vetmja qendër që
18 ka pas gjithçka dhe kemi mund me ble gjithçka. Realisht po
19 flas deri sa s'kanë ndodhur bombardimet. Dhe ky sektor e ka ba
20 punën në këtë drejtim, ka ndihmuar popullatën, ka ndihmuar
21 brigadat me ushqim me veshmbathje, batanije e gjëra të tjera,
22 e kështu me radhë.

23 Py. Këto artikuj ushqimore ose batanijet, ku ruheshin, ku
24 magazinoheshin, ku i mbanit ato?

25 Pë. Sistemi tek ne atje, realisht me marrëveshjet e partive

1 politike, është formuar këshilli republikan për ndihma
2 emergjente. Është në nivel të qeverisë së përkohshme të asaj
3 kohe. Dhe unë e kam udhëhequr degën e Prishtinës të këshillit
4 komunal për ndihma emergjente. Këshilli komunal për ndihma
5 emergjente ka grumbulluar në depot që ka pas në Prishtinë dhe
6 në vende të tjera, ka grumbulluar ushqime, veshmbathje,
7 batanije, shtretër e gjëra të tjera. Dhe pastaj prej aty janë
8 shpërndarë. Unë e kam udhëhequr atë këshill për një kohë të
9 caktuar.

10 Dhe nga aty në marrëveshje -- realisht këtë marrëveshje
11 nuk e kanë ditur njerëzit që e kanë themeluar atë këshill
12 komunal që unë e përdorja edhe për nevojat tona të luftës,
13 deri në një moment të caktuar. Kur ka ardhur koha atëherë e
14 kanë ditur. Por fillimisht kemi funksionuar kështu.

15 Py. A kishte ndonjë sektor tjetër brenda BIA-s?

16 Pë. Po, ka qenë sektori për informacion dhe sektori për moral
17 politik, që i përmenda.

18 Py. Çfarë bënte sektori për informacion?

19 Pë. Në atë kohë sektori për informacion kishte qëllim
20 grumbullimin e informacionit me qëllim të njoftimit të
21 qytetarëve, njoftime të ushtarëve, njoftime të strukturave të
22 UÇK-së për lëvizjet e armikut, njoftime të organizmave të
23 tjerë ndërkombëtar për dhunën që ndodhte në Prishtinë,
24 njoftime në shoqatat që kanë qenë për mbrojtjen e të drejtave
25 dhe lirive të njeriut, për dhunën që ka ndodhur tek qytetarët.

1 Aktualisht ka qenë një koordinim legal-ilegal në këtë drejtim,
2 informacionet janë dërguar edhe tek Këshilli për Mbrojtjen e
3 të Drejtave të Njeriut, edhe janë raportuar--.

4 Në aspektin ushtarak janë bërë përcjelljet e lëvizjeve të
5 armikut, kemi pas aksione të caktuara ku janë monitoruar
6 kazermat, në aspektin sa mjete motorike ka, çfarë sipërfaqe
7 ka, kur dalin. Dhe kështu është përcjellë ai informacion.
8 Kryesisht ka qenë ky roli.

9 Py. Nga ku bëheshin konstatime, vëzhgime të tilla?

10 Pë. Brenda në Prishtinë dhe rreth Prishtinës. Kryesisht
11 brenda në Prishtinë aty ku kanë qenë të vendosur ushtria
12 paramilitarët, militarët. Ne i kemi vëzhguar, është bërë një
13 raport dhe është konstatuar ku janë, në çfarë kohe janë, a
14 kanë lëvizur, ku çfarë drejtimi po shkojnë, e kështu me radhë.
15 Dhe janë njoftuar të tjerët pastaj që kanë pas interes me e
16 ditë këtë lajm.

17 Py. Kush ishin këta personat e tjerë që kanë pas interes ta
18 dinin këtë?

19 Pë. Për shembull, tash me sa më kujtohet mua se është kohë e
20 gjatë, e di që një herë ka ndodhë e kemi marrë një detyrë prej
21 komandant Calit që me dalë me i regjistru të gjitha kazermat
22 që janë në Prishtinë, brenda Prishtinës. Bile ka pas edhe
23 xhirime me kamera, ka pas skica, ka pas edhe përshkrime edhe
24 atë raport a ka kërkuar Shtabi i Zonës Operative të Llapit. Ne
25 e kemi dërguar raportin tek Cali, Cali e ka përcjellë në Zonën

1 Operative të Llapit, në Shtab të Zonës. Nëse kjo ju ndihmon.
2 Py. Dhe së fundi, njësia për moral dhe politikë. A mund të na
3 shpjegoni se çfarë bënte ky sektor?
4 Pë. Deri në fillimin e bombardimeve, ky sektor në gueriljen
5 BIA ka pas kontakte me pjesëtarët e njësive të saj, me
6 qëllim të vetëdijesimit të tyre që lufta është e vetmja
7 zgjidhje dhe realisht që ne do të fitojmë. Moral, kemi ba
8 moral dhe jemi munduar që të mos lejojmë propagandën e
9 atëhershme që ishte shumë e madhe prej serbëve, për mos me
10 depërtu tek njerëzit me kriju frikë e gjëra të tjera. E kemi
11 mbajt moralin e ushtrisë se lufta jonë është e drejtë, është e
12 pastër dhe ne do të fitojmë. Me këtë motiv kemi shkuar, pastaj
13 kur kemi dalë ne, kur na është prononcu me qëndru në
14 Prishtinë, kur kemi dalë në periferi të Prishtinës, përsëri
15 njësoj kemi vazhduar. Por, takimet kanë qenë atëherë pak më të
16 shpeshta.

17 Por kjo ka qenë kryesisht, mbajtja e moralit tek ushtarët
18 edhe moslejimi i depërtimit të propagandës serbe për të
19 krijuar ndonjë pasiguri në punë, në veprim, e kështu me radhë.
20 Siç ata e bënin sepse e kishin të gjithë mekanizmin [e
21 padëgjueshme].

22 Py. A ka pasur ndonjë stërvitje ushtarake që është kryer nga
23 BIA?

24 Pë. Për aq sa di unë, jo, nuk ka pas. S'ka pas. S'kemi pas as
25 kapacitet, as kemi pas mundësinë ndoshta me ba kësisoj

1 shpenzime për trajnime. Ka pas njerëz të cilët e kanë
2 përfunduar ushtrinë e ish-Jugosllavisë dhe ata i kanë pas disa
3 përvoja të vetat që atyre i kanë shërbyer. Por ndonjë trajnim
4 specifik të veçantë që është ba në gueriljen BIA, për aq sa di
5 unë, nuk ka pas.

6 Py. Po njerëzit e BIA-s, a ishin të armatosur?

7 Pë. Pjesërisht kanë qenë të armatosur. Për shkak të natyrës
8 specifike dhe nevojës, një numër i madh i anëtarëve të BIA-s
9 kanë qëndruar në qytet dhe të gjithë ata që kanë qëndruar në
10 qytet mund të kenë pas ndonjë armë, revole ose diçka për
11 siguri të vet personale. Por jo për të kryer ndonjë punë
12 tjetër. Pjesa tjetër, të cilët kanë lëvizur prej qytetit në
13 zonën rreth Prishtinës, ata kanë pas, kanë qenë të armatosur.
14 Unë vetë kam qenë i armatosur.

15 Py. Kush jua ka dhënë armën, për shembull si e more ti armën
16 tënde?

17 Pë. Mbasi është pyetja kështu direkt, armën time e kam blerë.
18 E kam blerë vetë. Pastaj, për të tjerët i kemi blerë. Realisht
19 ka qenë shumë e vështirë për me i sjell prej Shqipërisë, sepse
20 distanca shumë e largët dhe pasiguria ka qenë e madhe. Por, ka
21 ndodhur edhe diçka që ka mbërrit prej andej. Por, kryesisht
22 armët janë, njerëz që i kanë pasur nëpër shtëpia, i kanë
23 nxjerrë për luftë, dikush i ka sjell. Ata që s'kanë dash me
24 luftu i kanë sjell armët i kanë dorëzuar tek ne. Ata që kanë
25 luftu e kanë pas armën e vet. Edhe ana tjetër, ka qenë dhe një

1 vijë furnizimi prej Serbisë, që disa njerëz i kanë blerë armët
2 dhe i kanë sjellë tek ne. Prej Novi Pazarit, nëse s'gaboje.
3 Py. Në qoftë se do të shohim të gjithë panoramën e BIA-s, a
4 do të thonim që kjo ishte një formacion i armatosur, apo
5 përbëhej kryesisht nga civilë, të cilët nuk ishin të
6 armatosur?

7 Pë. Kjo pyetje e ka një përgjigje. Veç organizimi i BIA-s,
8 por dhe gjithë organizimi i UÇK-së e ka pas një emër. Ushtarë
9 lirie. Të gjithë kanë qenë ushtarë. Tash, disa për shkak të
10 specifikave kanë pas armë, disa nuk kanë pas armë. Por të
11 gjithë kanë qenë ushtarë lirie të angazhuar për lirimin e
12 vendit nga një okupator shumë i keq.

13 Kështu që organizimi i UÇK-së i cili quhej BIA, ka qenë
14 organizim i UÇK-së i përbërë me natyrë në këtë formë që po
15 them unë.

16 Py. Ju thatë se BIA operonte kryesisht ose në shumë lagje të
17 Prishtinës. Pyetja ime është kjo: a ndryshoi kjo situatë mbas
18 bombardimeve të NATO-s në Prishtinë?

19 Pë. Realisht, po. Me rastin e bombardimeve të NATO-s, tek ne
20 ndryshoi gjendja në aspektin organizativ, për shkak se u
21 krijua pak një situatë që disa prej njësive që i kishim në
22 Prishtinë, me rastin e bombardimeve të NATO-s, ata u detyruan
23 me u tërheq në periferi të Prishtinës, në vende më të sigurta.
24 Një pjese tjetër qëndroi në Prishtinë, por jo për gjatë, për
25 shkak se forcat serbe filluan pastaj bastisjet dhe ofensivat

1 nëpër lagjet te Prishtinës dhe ata u detyruan me u fut nëpër
2 kolona dhe me dalë për Maqedoni apo për Shqipëri, nga kanë
3 mundur me dalë. Sepse i kanë deportuar ashtu ata.

4 Dhe kryesisht pastaj ne funksionuam pak më ndryshe, se u
5 imponuan rrethanat.

6 Py. Ti vetë, jetoje me familjen tënde në kohën e
7 bombardimeve?

8 Pë. Unë e kam takuar familjen time. Nuk kam jetuar me ta, por
9 e kam takuar familjen time. Ka pas kohë, sepse ata kanë
10 qëndruar në Prishtinë dhe në periferi të Prishtinës, nuk kanë
11 dalë jashtë Prishtinës. Por i kam taku, ka pas kohë.

12 Py. Po vetë, ku jetoje në atë kohë?

13 Pë. Në mal. Ku kam mundur.

14 Py. Kjo ishte në kohën e bombardimeve?

15 Pë. Pas bombardimeve, po.

16 Py. Në rregull. A mund të na përshkruani - ose, a ka pasur
17 një pikë të caktuar kur ju jeni larguar nga Prishtina?

18 Pë. Unë kryesisht kam lëvizur në Prishtinë dhe në periferi të
19 Prishtinës. Pika kryesore ku më së shumti kam frekuentuar, ka
20 qenë Butovaci. Edhe Sofalia, por Sofalia është lagje brenda
21 Prishtinës. Ndërsa Butovaci është një fshat, ose si me e
22 quajt, një vend afër Prishtinës. Edhe kam lëvizur në këto 2
23 drejtime, më së shumti.

24 Nëse më vjen pyetja e radhës pse kam shkuar, e shpjegoj.

25 Py. Do t'i kthehem më pas edhe kësaj.

1 Në periudhën kohore midis datës 24 mars deri në fund të
2 marsit, a mund të na e përshkruani këtë periudhe, javën e
3 fundit të marsit në Prishtinë? Çfarë po ndodhte?

4 Pë. Kur kanë filluar bombardimet në 24 mars kam qenë në
5 Prishtinë, në lagjen time.

6 Realisht ka qenë një emocion i përzier, sepse qytetarët e
7 kanë përjetuar shumë mirë fillimin e bombardimeve, por
8 njëkohësisht edhe i ka mbretëruar frikë e madhe se çka do të
9 ndodhë.

10 Në atë kohë më kujtohet mirë që në Prishtinë me disa
11 anëtarë të njësitit që e kemi pas aty afër, jemi kujdes që me
12 i qëndru pranë popullatës në rast se fillon ndonjë masakër ose
13 ndonjë dhunë që ka qenë e mundshme me ndodh prej serbëve.
14 Atëherë ne i kemi dalë në ballë asaj pune dhe kemi qëndruar në
15 lagje deri dikur në datën, me sa më kujtohet, afërsisht besoj
16 deri në 31 mars. Kur më 31 mars kanë filluar veç me hy forcat
17 serbe, por jo me ba ndonjë masakër. Kanë filluar veç me i heq
18 njerëzit prej shtëpive dhe me i zhvendos. Ne atëherë kemi ecur
19 së bashku me popullatën dhe jemi nisur drejt fshatit Matiçan
20 dhe kemi vazhduar e kemi çuar popullatën në Butovac. Edhe disa
21 kanë shkuar në një fshat tjetër që është aty, në Mramor. Shumë
22 njerëz kanë ikur në atë drejtim për shkak të terrenit që është
23 atje pak malor dhe fshatrat që janë aty. Pastaj unë jam kthyer
24 në Prishtinë, e kam një -- me qëllim jam kthyer në Prishtinë.
25 Nëse mundet me vazhu, vazhdoj.

1 Py. Po. Ju thatë që njerëzit ishin të detyruar të largoheshin
2 nga shtëpitë. Pse, kush ua bëri këtë?

3 Pë. Ka qenë tmerr ajo se, me sa unë -- nëse s'gabo, festa
4 myslimane Bajrami ka qenë atë ditë. Dhe forcat serbe ushtarë,
5 paramilitarë, policë në të tria anët e asaj pjese, kanë
6 filluar me numër të madh forcash me lëviz drejt shtëpive dhe
7 njerëzit nga paniku kanë lëvizur, kanë ik, kanë lëshuar
8 shtëpitë. Ata janë futur nëpër shtëpi, 3 shtëpi i kanë djeg,
9 kanë plaçkitur pothuajse të gjitha shtëpitë e kështu me radhë.
10 Por, nuk kanë arritur përveç një plagosje ose dy prej
11 qytetarëve, nuk ka pas ndonjë dëm tjetër tek njerëzit atë
12 ditë.

13 Dhe kanë ikur njerëzit prej frikës e presionit të dhunës.
14 Por dhe ideja ka qenë e okupatorit që t'i shpërngulë të gjithë
15 shqiptarët prej aty. Prej krejt Kosovës, por specifikisht atë
16 ditë prej Prishtinës.

17 Py. A po bëhej më e vështirë asokohe hyrje-daljet nga
18 Prishtina?

19 Pë. Sigurisht që po. Sepse edhe numri i banorëve në Prishtinë
20 ka qenë i vogël dhe lëvizjet lexoheshin lehtë prej armikut.
21 Sepse ne më herët e kishim më lehtë, se kombinohehim me
22 banorët në lëvizje dhe nuk vëreheshim shumë, por ashtu u
23 vështirësua mjaft shumë hyrja-dalja në Prishtinë. Por,
24 megjithatë ne kemi hyrë dhe kemi dalë.

25 Py. Folët për fundin e marsit. S'jam i sigurt tashti për

1 datën, data 31 apo ndonjë datë tjetër. Çfarë ndodhi atë ditë,
2 atë ditë në veçanti?

3 Pë. Atë ditë thashë, filluan forcat serbe me i përzënë, ose
4 me i heq njerëzit prej shtëpive dhe njerëzit ashtu në panik
5 filluan me ik. Ne i drejtuam drejt zonave që janë malore në
6 Butovac, aty u vendosën në disa shtëpi. Aty kanë qenë nja 4-5
7 shtëpi. Janë vendosur edhe civilë por edhe disa anëtarë të
8 njësiteve tona. Edhe në Mramor kanë shkuar shumë civilë atje,
9 sepse atje ka pas njerëz që kanë jetuar aty dhe kanë vazhdu me
10 jetu deri në një kohë të caktuar.

11 Në momentin kur unë e kam parë që të gjithë këto
12 qytetarët shkuan dhe u strehuan, janë në rregull, jam kthyer
13 në Prishtinë me një ushtar timin. Më kujtohet jam kthyer në
14 shtëpinë time, për shkak se ju thashë edhe ma herët që shtëpia
15 ime ka qenë një vendqëndrim për organizim të gueriljes BIA dhe
16 kam pas kompjuterin në atë kohë me të cilin kemi punuar
17 materiale të ndryshme. Dhe jam kthyer me marrë *hard disku*-un
18 se kam pas frikë që janë futur policët aty dhe e marrin *hard*
19 *disk*-un. Dhe në *hard disk* ka pas emra të anëtarëve tonë,
20 kështu që rrezikoheshin familjet tona që ishin atëherë në
21 Prishtinë.

22 Jam kthyer, pavarësisht se kam menduar se shtëpia ime ka
23 me qenë e djegur, nuk ka qenë djegur. Nuk ishin futur as
24 brenda. E kanë kaluar. Nuk e di, jam çuditur, pse. Jam futur
25 brenda dhe e kam marrë atë, e kam nxjerrë *hard disk*-un prej

1 laptopit, prej kompjuterit të asaj kohe dhe pastaj kam
2 vazhduar te një shtëpi tjetër aty ku e kam udhëhequr, tek
3 shtëpia e këshillit komunal për ndihma emergjente. Edhe ajo
4 kishte qenë e paprekur. Aty qëllimi ishte, se ajo është në
5 lagje në një pikë më të lartë dhe prej aty shihen lëvizjet
6 rreth rrugës kryesore, shiheshin lëvizjet e armikut. Jam futur
7 aty. Kur jam futur brenda e kam parë që material ka aty,
8 ushqime dhe gjëra të tjera çfarë ishin me interes për ne, nuk
9 i kishin prekur serbët as ato. Kam qëndruar një kohë aty,
10 pastaj kam vazhduar, deri vonë kam qëndruar, kam shku me fjet
11 në një shtëpi tjetër. Jam kthyer përsëri në mëngjes me pa
12 realisht çfarë ka prej ushqimeve që neve na hyjnë në punë. I
13 kam marrë ato gjëra dhe jam kthyer për në Butovac. I kam
14 njoftuar njësitet e furnizimit që në këtë lokacion këtu ka
15 miell, ka sheqer, ka vaj, ka batanije dhe është mirë me
16 organizuar tash në formën qysh me i tërheq ato.

17 Kryesisht kjo ka qenë.

18 Py. Asokohe po qëndronit në Butovac dhe shkonit në Prishtinë,
19 ju kuptova mirë? Kjo që sapo thatë. Folët për kompjuter dhe
20 materiale të tjera që siguroat. Asokohe ju qëndronit në
21 Butovac, kështu?

22 Pë. Në fillimin e bombardimeve atëherë, qëndrimi i përhershëm
23 dhe i sigurt në Prishtinë ka qenë i pamundur. Mbas fillimit të
24 bombardimeve kemi qëndruar, unë personalisht edhe disa të
25 tjerë, në Butovac, si vend më në periferi të Prishtinës dhe jo

1 i kontrolluar prej forcave të armikut edhe afër Prishtinës për
2 me i siguru gjërat që na nevojiten. Po, është e vërtetë që kam
3 qëndruar edhe në Butovac në atë kohë. Por definitivisht në 31
4 mars kur janë shpërngulur dhe qytetarët e Prishtinës,
5 konkretisht të asaj lagje aty përreth, unë jam kthyer në
6 Prishtinë, kam marrë ato siç e shpjegova më herët. Pastaj kam
7 vazhduar në Butovac. Për një kohë kam ardh përsëri në
8 Prishtinë e kështu me radhë.

9 Py. Kur u kthyet në Butovac, a ishte e mundshme që të
10 vendosej kjo linjë furnizimi e materialit që ju morët apo
11 zbuluat, më saktë? Ishte e mundshme që të -- për ju apo mbase
12 edhe për të tjerë, që të cilët do të provonin t'i merrnin këto
13 materiale?

14 Pë. Jo vetëm ai vend që unë e kam ditë dhe e pashë që nuk e
15 kanë marrë serbët, materialet ushqimet e gjërat e tjera, por
16 aty në lagje pak më lart ka qenë edhe organizata Nënë Tereza.
17 Edhe ajo ka pasur një depo të vetën, ku ka shpërndarë miell e
18 gjëra të tjera për qytetarët. Dhe të dyja ato, edhe kjo pjesa
19 këndeje tek këshilli komunal për ndihma emergjence, ku e
20 shpjegova më herët, edhe kjo depoja e Nënë Terezës, janë marrë
21 të gjitha gjërat që kanë qenë aty, prej njësiteve tona të
22 furnizimit dhe janë sjellë përmes Matiçanit në Butovacit. Prej
23 Butovacit janë çuar edhe në Mramor, ku janë shpërndarë tek
24 qytetarët, mielli dhe gjëra të tjera. Sepse ne nuk kishim
25 nevojë për ato sasi aq të mëdha që ishin aty dhe i ndihmonin

1 edhe civilët që ishin të vendosur në atë kohë si refugjatë në
2 atë pjesë.

3 Py. Të shkuarit në Prishtinë për t'i marrë këto materiale, si
4 e bënit këtë gjë, shkuat në këmbë, me automjet? Si?

5 Pë. Anëtarët e njësiteve që kanë qenë për këtë punë, kanë
6 shkuar në Prishtinë në këmbë dhe janë futur në lagje. Në lagje
7 kanë marrë automjetin që e kanë gjetur aty, realisht dikush e
8 ka marrë automjetin e vet. Më kujtohet njëri prej ushtarëve
9 tanë ka marrë traktorin e vet dhe kanë rrezikuar, e kanë
10 mbushur me gjëra dhe janë nis rrugës deri në Butovac. Fati ka
11 dashur që nuk janë takuar me serbët askund dhe kanë ardh mirë
12 e kanë sjellë të gjitha gjërat mirë.

13 Py. Për të marrë, për shembull, materialet kompjuterike siç
14 thatë, e bëtë gjatë ditës, gjatë mbrëmjes? Nuk e di a ishte i
15 lehtë qarkullimi?

16 Pë. Atë ditë kur jam futur në Prishtinë ka qenë me rrezik
17 shumë të madh, sepse po atë ditë ishin deportuar njerëzit,
18 ishin zhvendosur njerëzit dhe realisht nuk kisha asnjë
19 informacion ku janë të vendosura forcat serbe. Dhe jemi futur
20 bashkë me një ushtar, një truproje që e kam pas timin, jemi
21 futur duke i kaluar muret një pas një dhe kemi mbërrit deri
22 tek shtëpia, që ka qenë më rrezik. Mbrëmje ka qenë, por jemi
23 fut deri tek shtëpia, nuk patëm ndonjë problem.

24 Py. Ju kuptova. Sa kohë, pak a shumë, qëndruat në Butovac?

25 Pë. Në Butovac kam qëndruar shumë kohë. Nuk e di, po më

1 pyesni për cilën periudhë kohore. S'e kuptova për cilën
2 periudhë, se kam qëndruar jashtëzakonisht shumë kohë në
3 Butovac.

4 Py. Për cilën periudhë po flisni, kur thoni që po qëndronit
5 në Butovac? Nga cili moment filluat të qëndroni në Butovac? Jo
6 në mënyrë të përhershme, por për të bërë këto vajtje ardhjet
7 në Prishtinë?

8 Pë. Qëndrimi im në Butovac ka qenë më i gjatë shumë mbas
9 ofensivës, ku ne e kemi organizuar sepse jemi detyruar që një
10 prej bazave, një prej vendqëndrimeve që e kemi pas në
11 Prishtinë, për organizimin e BIA-s ku ka qëndruar shtabi i
12 gueriljes BIA, ka qenë në Sofali. Dhe prej Sofalisë, mbas
13 bombardimeve ne aty e kemi pas të pamundur me qëndru dhe kemi
14 ba menjëherë vendqëndrimin tjetër në Butovac. Unë në Butovac
15 kam qëndruar gjatë gjithë kohës aty ose në Prishtinë, kemi
16 lëviz. Por kjo është edhe një arsye tjetër me qëndru në
17 Butovac sepse e kemi krijuar vendqëndrimin tonë pasi që e kemi
18 pas të pamundur me vepru në Sofali.

19 Py. Po Calin e takuat asokohe, për këtë kohë të cilën po
20 thoni?

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
22 Avokat, ju kërkoj ndjesë. E bëtë pyetjen lidhur me periudhën
23 kur dëshmitari ndodhej në Butovac, por unë përgjigjen nuk e
24 mora dhe unë do të doja që t'ju kërkoja juve që t'ia kërkonit
25 këtë përgjigje.

1 Z. VON BONE: [Përkthim] Mirë.

2 Py. Duke filluar nga sulmi ajror që ishte 24 marsi, siç e
3 thatë, ju thatë data 30, 31 mars...

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
5 Avokat, do ta bëj unë pyetjen.

6 [Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

7 Ishit ngritur në këmbë?

8 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po, e nderuar Gjykatëse. Për të
9 thënë se dëshmitari e ka thënë dy herë që ka qenë në Butovac
10 mbas bombardimit të NATO-s dhe thjesht edhe për të vërejtur se
11 është e rëndësishme të shmangen pyetjet orientuese, për sa i
12 takon momentit specifik.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Unë
14 desha ta pyes deri kur. Deri kur keni qëndruar në Butovac?

15 DËSHMITARI: Shkëlqesia e juaj, e nderuara Gjykatëse, unë
16 në Butovac kam qëndruar deri në përfundimin e luftës. Ose me
17 fillimin e -- kur kanë hyrë trupat e NATO-s në Kosovë, që
18 është në 12 qershor 1999. Po jo qëndrim të përhershëm. Kam
19 lëvizur kohë pas kohë, por Butovac ka qenë vendqëndrimi im
20 kryesor.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
22 Faleminderit.

23 Z. Avokat keni fjalën.

24 Z. VON BONE: [Përkthim]

25 Py. Dëshiroj të flas tani për periudhën mbas 31 mars. Supozoj

1 se asokohe ishit në Butovac.

2 Të flasim tani për javën e parë të prillit të vitit 1999.

3 Me kë po qëndronit atje?

4 Pë. Siç e përshkrova më herët, në momentin kur jam kthyer në
5 Butovac prej Prishtinës, besoj se ka qenë fillimi ose 2-3
6 ditët e para të muajit prill. Dhe kam shkuar te vendi ku kemi
7 pas ne të organizuar qëndrimin tonë me ushtarë të BIA-s, me
8 gueriljen BIA dhe aty kam takuar ushtarë, njerëz të cilët kanë
9 qenë aty prezent. Kam biseduar për atë idenë e tërheqjes së
10 atij materiali nga Prishtina. Por kemi biseduar edhe më gjatë
11 me Calin edhe për punë të tjera që i takojnë asaj kohe me i
12 ba.

13 Py. Për çfarë biseduat me Calin që duhej bërë në asokohe?

14 Pë. Realisht ajo nevojë e kohës ka qenë. Mua më kujtohet
15 shumë mirë për shkak të gjendjes së rëndë që ka qenë në atë
16 kohë, për shkak të deportimit të qytetarëve dhe dhunës që e
17 kanë përjetuar disa të tjerë. Situata në Prishtinë ishte mjaft
18 e rëndë. Një numër i madh i pjesëtarëve tanë kishin dhe
19 familjet në Prishtinë, për të cilat nuk dinin as ku janë. Dhe
20 Cali ka kërkuar nga unë që në një farë forme me mbajt moralin
21 të ushtarëve në atë kohë dhe me mund me siguru sa më shumë
22 informacion se çka ka ndodhur me familjet e tyre dhe pjesën
23 tjetër. Por njëkohësisht edhe çështjen e lëvizjeve të armikut,
24 rrezikun që neve na kanosej aty ku ishim, për shkak se
25 vendqëndrimi jonë ka qenë shumë afër disa antenave ose bazës

1 kryesore të komunikimit të ushtrisë serbe, e cila ka qenë e
2 vendosur mu në Butovac. Ne kemi qenë shumë afër. Pastaj ne
3 kemi diskutuar me e mbajt nën kontroll atë pjesë, mos po kemi
4 ndonjë sulm, e kështu me radhë.

5 Kryesisht këto kanë qenë temat që i kemi ba. Tema të
6 zakonta për atë kohë.

7 Py. Në Butovac flinit?

8 Pë. Po, kam fjet në Butovac. Unë kam pas edhe një situatë që
9 familja ime ka qëndruar aty në një shtëpi tjetër. Më kujtohet
10 që një prej atyre ditëve kam shkuar edhe në familjen time, i
11 kam pa kam qëndruar me ta. Por kryesisht kam fjetur në
12 Butovac, në atë vendin ku kemi ndenjtur ne si guerilje BIA.

13 Py. Ky takim për të cilën po flisnit, me Calin për të ditur
14 se çfarë duhej bërë, pak a shumë në çfarë momenti ka ndodhur
15 pas datës 31 mars, ose pas ndonjë pike tjetër kohore, ju
16 kujtohet?

17 Pë. Me sa më kujtohet mua, më 31 mars jam kthyer në
18 Prishtinë, atje kam qëndruar 2-3 ditë. Besoj më datën, mund të
19 ketë qenë 3, 4, 5 deri nga data 7, kam qëndruar në Butovac. Në
20 këtë periudhë kam qëndruar shpesh herë me Calin. Kemi
21 biseduar, por jo vetëm me Calin, por edhe me njerëz të tjerë
22 të cilët kanë qenë aty. Pika Butovac, por edhe disa pika të
23 tjera nëpër zonën e periferisë së Prishtinës kanë qenë vende
24 ku shumë civilë kanë lëvizur. Dhe realisht edhe në Butovac
25 kanë ardh e kanë kërkuar ndihmë prej nesh, atëherë. I kujtoj

1 disa raste që kanë kërkuar ndihmë, nga me shku, nga me lëviz,
2 çka me ba, qysh me ia ba, për ushqime e për gjëra të tjera.
3 Sepse ne ishim e vetmja shpresë në atë kohë për popullin që
4 jetonte në Kosovë.

5 Py. Edhe Cali flinte në Butovac, aty ku po qëndronit?

6 Pë. Po, normal. Po, ka fjetur edhe Cali në Butovac. Bile ka
7 ndodhur që, e di saktë, nja dy netë i kemi ba bashkë aty.

8 Py. Me sa ju kujtohet, a ju kujtohet sa shpesh i keni parë
9 gjatë kësaj periudhe kohore?

10 Pë. Kë? Më fal, s'e kuptova pyetjen.

11 Py. Me aq sa ju kujtohet, sa shpesh e keni parë atë gjatë
12 kësaj periudhe kohore?

13 Pë. Nuk më kujtohet me numër me thanë kaq e aq, por e kam
14 parë shpesh. Gjatë atyre ditëve e kam parë shpesh. Tash nuk më
15 kujtohet me numër me thanë kaq herë.

16 Py. Vendi ku keni qëndruar në Butovac, çfarë lloj vendi ishte
17 ky?

18 Pë. Aty ishin dy lagje, realisht krejt organizimi -- po e
19 them kështu, krejt organizimi i jetesës i banimit në Gollak,
20 është një organizim ku bazohet në mbiemra familjarë. Për
21 shembull, një familje me një mbiemër jetonte në një vend të
22 caktuar, ku kishte gjithmonë kushërinjtë, vëllazëritë me 5-6
23 shtëpi ose 10 shtëpi, në një lagje. Kështu që në Butovac kemi
24 ndejt në familjen e Sopit, që i ka pas nja tri shtëpi aty, me
25 mbiemër Sopi. Kemi ndejt në familjen Reshica, ku i ka pas edhe

1 aty nja 4 shtëpi. Këto kanë qenë kryesisht, këto dy familje me
2 largësi njëra prej tjetrës, besoj nja 150-200m vijë ajrore.

3 Py. Butovac, a ishte një vend ku qëndronin bashkë shumë
4 anëtarë të BIA-s?

5 Pë. Butovaci ishte vend i afërt me Prishtinën dhe aty
6 qëndronin ushtarë. Por, nuk e di me numër, i madh apo i vogël,
7 por qëndronin një numër i caktuar i ushtarëve. Por nuk
8 qëndronin gjithmonë, ata lëviznin futeshin në Prishtinë.
9 Sikurse me atë rastin e furnizimit, futeshin edhe për gjëra të
10 tjera e ktheheshin. E kështu me radhë.

11 Py. Asaj kohe që keni qëndruar në Butovac, e gjithë familja
12 juaj qëndronte aty, apo kishte që qëndronin edhe në vend
13 tjetër?

14 Pë. Familja ime, në momentin kur janë deportur janë hequr
15 prej Prishtinës, komplet familja ime që unë i kam pas 5 fëmijë
16 në atë kohë, babën, gruan e kështu me radhë. Familja në
17 përgjithësi ka qëndruar në Butovac. Por krahas tyre, kam pas
18 edhe një familje tjetër që ka ndejt tek ne, në shtëpinë time.
19 Të cilit ia kanë vrarë babën në luftë, një nipi im Dëshmor i
20 Kombit. Edhe ai ka qenë atje.

21 Kanë qenë shumë qytetarë dhe besoj me numër që, mbi 30
22 mijë ose 40 mijë njerëz janë vendosur në Butovac dhe në
23 Mramor, ato ditë që kanë ikur prej Prishtinës.

24 Py. Këta njerëz, ku e gjenin vendin për të qëndruar, si e
25 gjenin këtë vend? E kam fjalën për këtë numër të madh

1 njerëzish që po thoni, si e gjenin, ku qëndronin?

2 Pë. Ndjenja e solidaritetit dhe mikpritja ka qenë shumë e
3 madhe dhe vazhdon të jetë tek ne si traditë. Por, në rrethana
4 lufte atëherë ajo nuk diskutohet, të gjitha shtëpitë që kanë
5 qenë të gjithë shqiptarëve që kanë jetuar në atë zonën në
6 periferi të Prishtinës kanë qenë të hapura, nuk kanë qenë të
7 mbyllura. Edhe nëse nuk ka pas banorë, ato kanë qenë të
8 hapura. Edhe nëse ka pas banorë, ata i kanë marrë dhe i kanë
9 futur brenda dhe kanë jetuar bashkë me to. Janë ushqyer bashkë
10 me to e kështu me radhë. Ama, të gjitha shtëpitë pa dallim.

11 Py. Lëvizja juaj ka qenë kryesisht Butovac, Prishtinë. Po
12 gjetkë, vende të tjera, bënit lëvizje gjatë asaj periudhe
13 kohore? E kam fjalën menjëherë mbas datës 31 mars 1999.

14 Pë. Nuk e kam shumë mirë në kujtesë, por edhe mund të kem
15 lëviz në ndonjë fshat aty përreth. E di që një herë kam shkuar
16 në Mramor e kam takuar babën tim. Babai im ka qenë aty në
17 takim me disa miq, nuk e di a kanë qenë refugjatë ato. Kam
18 lëviz pastaj në -- kemi pas edhe vendqëndrime të tjera, për
19 shembull ka pas në Zllash, ka pas në Sharban. Dhe kam lëviz
20 edhe andej.

21 Py. Sa herë keni qenë në Zllash?

22 Pë. Me sa unë e kam në kujtesën time, edhe besoj që është e
23 saktë, kam lëviz 2 herë.

24 Py. Për çfarë arsye shkonit në Zllash?

25 Pë. Herën e parë më kujtohet, kam shkuar me Flora Brovinën

1 dhe kemi çuar disa materiale, dyshekë, batanije, ushqime. Kemi
2 mbush një kombi të madh ose një bus si me thënë edhe i kemi
3 çuar në Zllash për shkak të nevojave që kanë pas atje.

4 Herën dytë kam shku me pa Isa Kastratin, një shok timin
5 që e kam pas në aktivitet gjithmonë. Tash është Dëshmor i
6 Kombit. Ka qenë i burgosur politik. Dhe kjo ka qenë arsyeja me
7 shku me taku atë. Kaq sa më kujtohet mua besoj.

8 Py. A mund të na e përshkruani si shkonit në Zllash, nga i
9 binit?

10 Pë. Herën e parë kam shkuar prej rrugës Prishtinë-Grashticë,
11 rrugë jo bash e mirë por kemi dalë, kemi shkuar deri në
12 Zllash. Kjo rruga e asfaltuar është tash, rruga që çon drejt
13 Kamenica andej. Kjo ana nga Gollaku këtu.

14 Ndërsa herën e dytë, me sa mbaj mend unë, kam shkuar deri
15 duku në këmbë, pastaj kam taku dikë me traktor, nuk e di dhe
16 kam hipur në traktor dhe kam shkuar.

17 Py. Herën e parë që shkuat ne Zllash, sa kohë qëndruar aty?

18 Pë. Vetëm për aq kohë sa i kemi lënë ato materialet dhe
19 s'besoj se kam qëndruar shumë kohë. Jam kthyer në Prishtinë
20 pastaj përsëri me Flora Brovinën.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] .

22 Avokat, një moment ju lutem.

23 [Anëtarët e Trupit Gjykes këshillohen]

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,

25 mund të vazhdoni.

1 Z. VON BONE: [Përkthim] Ka shkuar ora 11.00.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
3 ora është 11.00, por nuk desha t'jua ndërpres këtë varg
4 pyetjesh. Nëse ju e gjeni momentin që ju mendoni për sa më
5 shpejt, mund të na thoni që të bëjmë dhe pauzën.

6 Z. VON BONE: [Përkthim] Po.

7 Py. Ju thatë që, aq kohë sa ishte e nevojshme për t'i çuar
8 ato furnizimet në Zllash dhe pastaj u kthyet me Flora
9 Brovinën. Kështu e kuptova, apo jo?

10 Pë. Për rrethana sigurie ne nuk qëndruam më gjatë, për shkak
11 se filloi me ra terri. Dhe ishte me rrezik me u kthye në terr
12 dhe për rrethana sigurie u kthyem ma herët. Shkuam, i lamë ato
13 gjërat dhe u kthyem këndeje.

14 Py. Në atë moment gjatë asaj kohe që ndodheshit aty me Flora
15 Brovinën, Salih Mustafa, a ishte dhe ai aty?

16 Pë. Jo, jo. Ato ndihma kanë qenë të dedikuara për Shtabin e
17 Brigadës 153. Edhe ato ndihma, realisht ka dalë na ka prit ky
18 Rahman Dini në atë kohë, edhe na ka prit Fatmir Sopi. Atyre ua
19 kemi dhënë ato ndihma.

20 Py. A ju kujtohet se ku i dorëzuat ato materiale?

21 Pë. Ka qenë, me sa e di unë nëse s'gaboj, një shtëpi ka qenë,
22 një shtëpi dykatëshe. Shtëpinë e Fatmir Sopit e kemi kaluar,
23 edhe pak më lart ka qenë.

24 Py. Mirë. Herën e dytë...

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

1 Avokat, atëherë do ndërhyj unë. Besoj që ky është momenti i
2 natyrshëm për të bërë ndërprerjen e seancës.

3 Z. VON BONE: [Përkthim] Po, në rregull.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
5 mirë. Do të bëjmë një pushim disi më të gjatë se zakonisht.
6 Duam të bëjmë pauzën deri në orën 12 pa një çerek. Dhe për të
7 ruajtur kohën e parashikuar për sot, për drekë do ta bëjmë
8 pushimin disi më të shkurtër.

9 Tani bëjmë ndërprerjen për këtë pushim.

10 --- Pauza fillon në orën 11.03

11 --- Seanca rifillon në orën 11.46

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
13 mirë. Shoh që jemi me të njëjtën përbërje siç kemi qenë edhe
14 në fillim të seancës sot. Për procesverbal mund ta shënojmë
15 këtë.

16 Znj. Sekretare, a mund ta sillni dëshmitarin në sallën e
17 gjyqit ju lutem.

18 [Dëshmitari vijon dëshminë]

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: Mirë se u kthyet
20 z. Mehmetaj.

21 DËSHMITARI: Faleminderit.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: Avokat Mbrojtës,
23 e keni radhën ju për të vazhduar me pyetjet.

24 Z. VON BONE: [Përkthim] Shumë faleminderit, e nderuara
25 Gjykatëse.

1 Py. Kujdes me ujin.

2 Z. Dëshmitar, neve e përfunduar intervistën përpara sesa
3 të shkonit për pushim me Zllashin, me herën e parë kur keni
4 shkuar në Zllash. A e mbani mend herën e dytë kur keni shkuar
5 në Zllash?

6 Pë. Kur, nuk e kam shumë të sigurt, kur kam shku, por e mbaj
7 mend që kam shku për aty.

8 Pë. E kur flas për kohën e kam fjalën për periudhën, në një
9 periudhë të caktuar kohe për shembull ke shkuar atje? Mund të
10 na e thoni këtë?

11 Pë. Po, kam shku.

12 Py. Për shembull le të themi nga data 31 mars e në vijim.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [mikrofoni
14 çaktivizuar].

15 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Nuk duhet që të bëhet një
16 pyetje orientuese për periudhën përkatëse sepse dëshmitari e
17 tha që nuk e mban mend kohën konkrete.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
19 Faleminderit znj. Prokurore.

20 Avokat, ju mund të bëni një pyetje me fund të hapur, pa
21 dhënë referenca të tjera. Dhe mund ta bëni dhe njëherë
22 pyetjen, por duke mos dhënë data.

23 Z. VON BONE: [Përkthim] Pra, po mundohem të shpjegoj që e
24 kam fjalën për periudhën në pyetje, jo për kohën konkrete.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në

1 rregull, nuk ka problem, por nuk keni pse e konfrontoni atë me
2 deklaratë të mëparshme, në qoftë se ai tha që nuk e mban mend
3 kohën.

4 Z. VON BONE: [Përkthim]

5 Py. A e mbani mend se në çfarë periudhe kohe keni shkuar për
6 herë të dytë në Zllash?

7 Pë. Po ka qenë besoj, kështu në saktësisht me data e me këto
8 nuk e mbaj mend, sepse është kohë shumë e gjatë edhe realisht
9 s'e kam ditur ç'a duhet me mbajt mend. Po ka qenë dikund muaji
10 mars-prill besoj.

11 Py. Në atë kohë besoj se ju thatë që jeni takuar me Isa
12 Kastratin atje, a është e saktë kjo?

13 Pë. Po, e saktë, po. Ai ka qenë qëllimi pse kam shku.

14 Py. Në rregull. Kush është Isa Kastrati?

15 Pë. Isa Kastrati tash është Dëshmor i Kombit. Ka qenë i
16 burgosur politik. Njohjen me të e kam pasë në kohën kur kam
17 qenë i organizim në LDK. Ai ka qenë kryetar dege. Unë kam qenë
18 kryetari i degës të rinjve, ai ka qenë kryetari i degës në
19 përgjithësi. Kemi punu bashkë, kemi bo aktivitet bashkë. E kam
20 organizu unë në strukturat e UÇK-së, e kam bo pjesëtar të
21 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Njëkohësisht ai ka udhëheq
22 edhe atë këshillin komunal për ndihma emergjente derisa nuk ka
23 kalu në organizim të Ushtrisë Çlirimtare, që ka marrë një
24 përgjegjësi, e ka pasë një përgjegjësi.

25 Pastaj pas tij unë kam vazhdu me udhëheqjen e atij,

1 organizimi humanitar që ka qenë në atë kohë. Kështu që Isa
2 Kastratin e njoh mirë, kam bashkëvepru me të një kohë të
3 gjatë. Kemi pasë një lidhje shumë të afërt mes nesh. Kështu që
4 ndoshta krijoj emocion nga pak kur flas për të se më vjen keq
5 që nuk është.

6 Py. Ka vdekur ai?

7 Pë. Po, ka ndërruar jetë në luftime me forcat armike. Ka qenë
8 luftëtar i lirisë, ka qenë tamam atdhetar ashtu siç i ka hije
9 dhe ka bo një betejë aty ku edhe është vra, në fshatin Bullaj
10 të Marecit.

11 Py. A e mban mend se kur ka ndodhur kjo?

12 Pë. Unë nuk kam qenë aty, po e di kur ka ndodhur. Për shkak
13 të rrëfimeve ka ndodhë më 21 prill të vitit 1999.

14 Py. A është e saktë që ka një statujë të këtij personi, një
15 monument të tij në Prishtinë?

16 Pë. Po, i ka disa. Ka dhe emërtime rrugësh, ka dhe
17 përmendore, ka dhe institucione që kanë marrë emrin e tij.

18 Py. A ka luajtur ndonjë rol ai në BIA?

19 Pë. Po, ka pasë rol, po. Ai ka qenë fillimisht i organizuar
20 në strukturat tona, në një njësit gueril. Pastaj është emëru
21 në detyrë në zonën operative të Llapit. Pastaj nga aty ka kalu
22 prapë me detyrën në një brigadë, me sa e di unë 151, ka marrë
23 detyrë prapë edhe aty. Edhe ka ardhë, e ka përfundu aty
24 misionin, ka ardhë te na edhe është emëru. Ka qenë për një
25 kohë të caktume zëvendëskomandanti ose ndihmësi i komandantit

1 deri në momentin kur ka ndërru jetë në luftime.

2 Py. E kuptoj. Pse shkuat ju në Zllash për ta takuar atë?

3 Çfarë qëllimi kishit për të shkuar në Zllash për të takuar

4 Isan?

5 Pë. Po ndjenja për ta taku një shok është ndjenjë e madhe,

6 një bashkëveprimtar. Edhe unë vetëm me kaq. Kam pasë dëshirë

7 me e pa, me bisedu, me e pa si është me shëndet edhe ashtu. Po

8 ka qenë shumë i vjetër. Po ka vujt shumë se ka pasë një kohë

9 shumë të gjatë e kanë mbajt në burg. Prapë nuk është ndal

10 asnjëherë si ka dalë prej burgu ju ka -- me çështjet, me temat

11 kombëtare. Pastaj i është bashku UÇK-së pa asnjë hezitim. Ka

12 vazhdu luftën dhe me respekt të madh e kam taku. Veç për

13 ndjenjë e kam pa, ndjenjën e afërsisë me të.

14 Py. Ku e takuat atë? E mbani mend vendin ku jeni takuar me

15 të?

16 Pë. Po.

17 Py. Po flisni për Zllashin, po ku në Zllash?

18 Pë. Isa Kastratin e kam taku në atë vendstrehimin që e ka

19 pasë guerila BIA në Zllash, në atë shtëpinë ku ka qëndru në

20 Zllash aty e kam taku.

21 Py. Thua vendstrehim. Pse e quan vendstrehim?

22 Pë. Po realisht edhe atë karakter e ka pasë për shkak se

23 Zllashi prej Prishtinës është disa kilometra edhe në naltësi

24 mbidetare dikund 1.000 metra ashtu. Ka qenë një zonë e lirë

25 për atë kohë, domethënë nuk ka pasë forca ushtarake, as

1 militare, as paramilitare në atë vend. Edhe për shkak të
2 sigurisë, për shkak të idesë që është vend ku mund me pushu
3 ushtarët pak më të qetë. Pasi që kanë kry punë nëpër vende të
4 tjera, kanë ardhë kanë pushu, kanë shku, janë kthy edhe për
5 atë arsye është vendstrehim ose vendqëndrim si me e qujt
6 ndryshe s'po di.

7 Py. Ky vendstrehimi, a e mban mend se çfarë pamje kishte?

8 Pë. Po, e mbaj mend, po. Po, e mbaj mend. Ka qenë një oborr i
9 madh me disa shtëpia kështu përreth.

10 Py. Në rregull. A kishte njerëz të tjerë aty?

11 Pë. Po, kur kam shku unë, po, ka pasë edhe njerëz të tjerë.
12 Ka pasë edhe njerëz të tjerë.

13 Py. Çfarë lloj njerëzish ishin atje?

14 Pë. Po, unë kam pa ushtarë, kam pa ushtarë të uniformum, kam
15 pa civilë, kam pa civilë që kanë ikë prej Prishtinës, për
16 shembull dy familje e di që kanë qenë aty. Në atë kohë, ka
17 pasë edhe fshatarë aty nga fshati që kanë ardhë në atë kohë sa
18 kam qëndru unë aty.

19 Py. Pra ju thoni që kishte ushtarë. Çfarë ushtarësh? Nga ku
20 ishin këta ushtarë? Kujt i përkisnin këta ushtarë?

21 Pë. Po fillimisht janë ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të
22 Kosovës. E dyta në aspektin organizativ kam pa ushtarë që kanë
23 qenë, bile kam taku njerëz që kam njoft aty prej Brigadës 153,
24 por edhe të zonës operative të Karadakut që kanë qenë aty.

25 Py. "Që kanë qenë aty" e keni fjalën për aty në oborr, në

1 këtë oborrin që përshkruat?

2 Pë. Unë i kam taku aty, po.

3 Py. Në rregull. Sa civilë ishin aty? A mund të na japësh një
4 shifër të përafërt, sa civilë keni parë kur keni qenë aty?

5 Pë. Po me numër saktë unë muj me gabu po kanë qenë dy
6 familje. Një familje besoj ka qenë katër-pesë anëtarëshe, që
7 kanë ikë prej Prishtinës. Është familja e Mehdi Asllanit.
8 Bashkë me familje ka qenë nëse e doni me emën. Ai ka pasë një
9 incident në Prishtinë me policët dhe i është dashtë me ikë
10 prej shtëpisë. Kanë qëndru aty. Edhe një familje nëse s'gabo
11 unë, ka qenë e asaj shpisë aty, dikushi i vendit aty. Kanë
12 ardhë një ose dy fshatarë nuk e di, kanë pru me ngrënë diçka e
13 mbaj mend - ata që kanë pru diçka me ngrënë në atë kohë,
14 banorë të fshatit aty. Kaq janë këtu, po aq sa di unë.

15 Py. Vendstrehimi siç e quajtet ju, njerëzit e BIA-s ishin të
16 vetmit njerëz që qëndronin në këtë vendstrehim apo kishte dhe
17 persona të tjerë që mund ta përdornin atë?

18 Pë. Njerëzit e BIA-s aty, aq sa unë e kam kuptu edhe e di që
19 është ashtu, domethënë i kanë pasë në shfrytëzim vetëm nja dy
20 dhoma prej atyne shpiave që kanë qenë aty, të atij kompleksi
21 të shpiave. Se ai ka qenë një kompleks i një familjeje të
22 madhe që e kanë përdorur, sigurisht ka qenë numër më i madh i
23 familjarëve dhe ka pasë shumë vende për me ndejt aty realisht,
24 që aq sa e di. Po aty kanë ndejt, kanë qëndru edhe të tjerë
25 njerëz. Aty kanë qëndru edhe njerëz jo kur unë kam qenë po e

1 di sipas njohurive që kam. Kanë qëndru njerëz që kanë ikë prej
2 zonave të ndryshme, janë ardhë kanë ndejt një ditë, dy ditë
3 derisa kanë siguru vend tjetër dikund edhe kanë lëvizë. Kanë
4 qëndru ushtarë që kanë ardhë ushtarë prej Zonës Operative të
5 Llapit ose zonave të tjera, janë ushqy, kanë ndejt sa kanë
6 ndejt, një ditë, dy, tri edhe kanë lëvizë. Domethënë ka qenë
7 realisht një vend i hapun ku ka mujt me u fut çdokush edhe me
8 qëndru aty sa kanë pasë nevojë njerëzit.

9 Py. Kush e kontrollonte këtë? Këto shtëpi kush i
10 kontrollonte?

11 Pë. Në aspektin natyror, po them Zoti e ka kontrollu. Në
12 aspektin njerëzor nuk ka pasë ndonjë kontroll të veçantë aty.

13 Py. Pra nuk kishte ndonjë kontroll nga ndonjë person, pra BIA
14 nuk e kontrollonte këtë grup shtëpish?

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
16 shikoj që znj. Prokurore është ngritur në këmbë. Do të marrë
17 fjalën.

18 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po. Avokati po sugjeron
19 përgjigjet.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Cila
21 është pyetja juaj?

22 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Pyetja është që ju lutem a mund
23 ta formuloni ndryshe pyetjen sepse mënyra sesi është formuluar
24 pyetja duket sikur po e sugjeroni, po i sugjeroni përgjigjen
25 dëshmitarin.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jam
2 dakord me komentin e Prokurores.

3 Z. VON BONE: [Përkthim]

4 Py. A kishte ndonjë brigadë, ndonjë njësi apo ndonjë gjë
5 tjetër që kontrollonte këtë grupi shtëpish, me aq sa dini ju?

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
7 Avokat, ju lutem a mund ta bëni më të qartë se çfarë doni të
8 thoni me "kontrollonin" se nuk është e qartë për mua. Sepse
9 përgjigjja e dëshmitarit ishte që në mënyrë të natyrshme e
10 kontrollonte Zoti. Sepse është pyetje jo-specifike, jo-
11 konkrete. Të lutem a mund të na e sqarosh pak?

12 Z. VON BONE: [Përkthim]

13 Py. BIA a kishte ndonjë kompetencë lidhur me këtë grup
14 ndërtesash?

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
16 Prokurore, e keni fjalën sërish.

17 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Sërish dëshmitari iu përgjigj
18 pyetjes kështu që nuk ka bazë, nuk ka themelshmëri pyetja që u
19 bë.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
21 qoftë se doni të konsultoheni, ju lutem konsultohuni përpara
22 sesa të jap unë vendimin tim.

23 Z. WHITING: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, në qoftë se
24 mund të sugjeroj, ndoshta mund t'i japim pak leje dëshmitarit,
25 domethënë që të shkëputet pak në mënyrë që të kemi një

1 diskutim bashkërisht.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
3 Sekretare, ju lutem nxirreni dëshmitarin nga salla e gjyqit.

4 Z. Dëshmitar, do të nxjerrim nga salla e gjyqit dhe duam
5 që të kemi një diskutim ndërmjet nesh dhe pastaj do t'ju fusim
6 sërish në sallë.

7 DËSHMITARI: Okej.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: Faleminderit.

9 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

10 Z. WHITING: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, vështirësia
11 këtu është që nuk është përcaktuar themeli për këto lloj
12 pyetjesh. Ne nuk kemi asnjë informacion në qoftë se dëshmitari
13 ka ndonjë njeri apo jo lidhur me kontrollin e BIA-s mbi këtë
14 kompleks, mbi faktin se kush ka qenë atje apo jo.

15 Dëshmia deri tani ishte që ai ka qenë i pranishëm atje dy
16 herë. Nuk është përcaktuar periudha kohore për këto vizita.
17 Nuk e dimë se për sa kohë ka qenë atje, nuk e dimë sesa bazë
18 ka njohuria e tij, ndërkohë që avokati tani i bën pyetje
19 lidhur me kontrollin, kush ishte atje, çfarë ka bërë ai atje.
20 Ndërkohë që nuk ka themel, pra nuk është se e dimë se cila
21 është baza e njohurisë. Nuk e dimë në qoftë se ky dëshmitar ka
22 ndonjë mënyrë që mund të dijë përgjigjet e këtyre pyetje ose
23 po spekulon.

24 Ai në fakt tha në përgjigjet e veta që na ka dhënë
25 informacion për gjëra që ka dëgjuar, për situata kur nuk ka

1 qenë i pranishëm aty. Pra unë do sugjeroja që mënyra sesi
2 duhet të vijojmë është që pikësëpari të mund të përcaktojmë
3 një bazë të duhur. Pra të vërtetojmë se kur ka qenë aty, se
4 cila ka qenë baza e këtij informacioni përpara sesa t'i bëhen
5 këto pyetje. Sepse unë personalisht nuk jam i sigurt në qoftë
6 se ai e ka bazën për të ditur përgjigjet e këtyre pyetjeve.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

8 Avokat.

9 Z. VON BONE: [Përkthim] Nuk jam dakord, e nderuar
10 Gjykatëse. Së pari, baza, themeli është që BIA po përdor një
11 vendstrehim në këtë kompleks. Këtë na tha dëshmitari. Dhe me
12 këtë e bën lidhjen e përgjigjes së tij.

13 Gjithashtu edhe periudha u tregua prej tij. Sepse në
14 mënyrë të padiskutueshme që në qoftë se ti je takuar me Isa
15 Kastratin, sigurisht që do e kesh takuar Isa Kastratin para se
16 të kishte vdekur, se nuk mund të ishte e mundur ta kishte
17 takuar ndryshe.

18 Në qoftë se ka një vendstrehim, pavarësisht sesi quhet
19 vendi, pra ne duam të dimë se kush kishte kompetenca mbi këtë
20 dhomë të caktuar apo mbi këtë vendstrehim.

21 Kështu që baza ekziston, themeli ekziston, periudha u tha
22 dhe në qoftë se dëshmitari nuk e di, përgjigjja do të jetë e
23 tillë. Do thotë nuk e di.

24 Z. WHITING: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, nuk e di në
25 qoftë se mund të më jepni fjalën.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
2 reflektoja. Do jua jap fjalën patjetër z. Zëvendësprokuror.

3 E keni fjalën ju tani.

4 Z. WHITING: [Përkthim] Faleminderit.

5 Jo nuk mendoj që kjo është e saktë. Sepse, po, ne mund të
6 deduktojmë nga data e vdekjes që ai është takuar më përpara me
7 të, por pyetja nuk është bërë për dëshmitarin në qoftë se e
8 mban mend se kur ka qenë konkretisht, specifikisht ai atje.
9 Dhe ajo çfarë është më e rëndësishme është që nuk ka themel,
10 nuk ka bazë për pyetjet që ai bën. Se cila është baza pra, ne
11 nuk e dimë se cila është baza që ai do ta dinte se kush ka
12 kontroll mbi kompleksin. Domethënë kush ishin civilët aty, për
13 sa kohë qëndruan aty, kush ishin ushtarët aty.

14 Pra mënyra sesi po jep dëshminë dëshmitari, ne nuk e
15 dimë, nuk e dimë në qoftë se ka qenë aty për pesë minuta apo
16 për më gjatë. Pra duket sikur ai nuk ka qenë aty as edhe për
17 një natë. Pra është e rëndësishme që të vërtetohet, të
18 përcaktohet pikësëpari që ai e di këtë informacion.

19 Sepse në të kundërtën nuk ka pikë vlere dëshmia.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ajo
21 çfarë do të bëjmë ne me dëshminë në fund na takon neve për
22 tuaj vlerësuar. Nuk ju takon juve që të vlerësoni. Megjithatë,
23 faleminderit për konstatimet tuaja.

24 Avokat, do jua jap edhe njëherë fjalën.

25 Z. VON BONE: [Përkthim] Mund t'jua përsëris atë çfarë

1 thashë. Por në qoftë se do ta përsërisja nuk bëhet më i fortë
2 argumenti. Pra koha është përcaktuar, kishte një vendstrehim,
3 kështu që BIA për aq kohë sa kishte përdorur ndoshta dhomën
4 ose vendstrehimin, dikush duhet të kishte qenë në kontroll.
5 Ose ndoshta edhe familjet që ishin të pranishme atje. Dhe siç
6 e thashë në qoftë se ai nuk e di, do thotë thjesht edhe troç,
7 "Nuk e di."

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
9 Sugjeroj që ne të vijojmë si më poshtë. Për mua - dhe në fakt
10 kjo ishte një pyetje që kisha rezervuar që ta bëja kur të na
11 vinte ne radha si Trup Gjykes dhe siç u vu në pah edhe nga
12 Zyra e Prokurorisë, domethënë pyetja që ne kishim ishte që kur
13 saktësisht ka ndodhur që ai ka qenë i pranishëm herën e dytë
14 që ka shkuar atje. Në deklaratën fillestare nuk ka detaje për
15 kohën, kështu që kjo është një pyetje që do t'i bëj vetë pak
16 më vonë dëshmitarit. Për tani, ai ka dhënë dëshminë që mesa
17 duket ka qenë atje përpara datës 23. Por unë dua t'ju kërkoj
18 juve që t'i bëni pyetje atij se kur përpara 23 prillit --

19 Z. VON BONE: [Përkthim] Jo, ka qenë 21 prill.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë.
21 Kur përpara 21 prillit atëherë.

22 Z. VON BONE: [Përkthim] Okej.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe
24 pika e dytë është që ta pyesni atë nëse ka informacion lidhur
25 me faktin se kush ishte përgjegjës për vendstrehimin. Lidhur

1 me peshimin e dëshmisë kjo i takon një faze tjetër të
2 mëvonshme. Kështu që mund të vazhdoni.

3 Znj. Sekretare, ju lutem a mund ta sillni dëshmitarin në
4 sallë.

5 [Dëshmitari vijon dëshminë]

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
7 se erdhët përsëri z. Mehmetaj.

8 Avokat, mund të vazhdoni.

9 Z. VON BONE: [Përkthim]

10 Py. Z. Dëshmitar, ju na thatë se jeni takuar me Isa Kastratin
11 dhe se Isa Kastrati ka vdekur më 21 prill. Duke marrë si pikë
12 reference datën e vdekjes së tij, a e mbani mend sa përpara
13 kësaj kohe, kësaj date jeni takuar me Isa Kastratin në Zllash?
14 Domethënë sa kohë përpara vdekjes së tij jeni takuar me Isa
15 Kastratin?

16 Pë. Nuk jam shumë i sigurt, po ndoshta mund të ketë qenë afër
17 dy javë. Nuk e di saktë. Po muj me gabu, po aty dikund.

18 Py. E kuptoj. A keni njohuri - t'ju bëj një tjetër pyetje -
19 sa zgjati ky takim? A e mbani mend për sa kohë u takuat me Isa
20 Kastratin? Sa i gjatë ishte takimi?

21 Pë. Besoj nja tri-katër orë. Po jo veç me Isën po krejt
22 qëndrimi jem ka qenë aty tri-katër orë se kam taku edhe njerëz
23 të tjerë, edhe ushtarë të tjerë.

24 Py. A i mbani mend ndonjë nga këta ushtarët e tjerë?

25 Pë. Po, po i mbaj mend. Po. Ka qenë një prej Zonës Operative

1 të Karadakut, një djalë që edhe ai është dëshmor. Besnik,
2 Besnik Maroca [fon] si duket, mbiemrin nuk jam shumë i sigurt,
3 por besoj se ky është. Kam qëndru me të. Dhe më ka bërë
4 përshtypje shumë entuziazmi i tij për me luftu. Sepse një
5 djalë i qytetit të Gjilanit kishte ardhë në fshat pa i dashtë
6 me i ditë as rreziqet. Po pse po e mbaj mend është sepse ai
7 edhe vdekjen e ka bërë shumë heroike domethënë. Edhe ai aty
8 dikund afër ku është vra Isa Kastrati, edhe ai aty është vra
9 dikund. Edhe personi tjetër ka qenë Rrahman Dini, të cilin e
10 kam njoft edhe më herët. E kam taku aty.

11 Z. VON BONE: [Përkthim] Dua t'i kërkoj Zyrës së
12 Administrimit Gjyqësor të tregojë një fotografi.

13 [Avokati i Mbrojtjes këshillohet]

14 Z. VON BONE: [Përkthim] Po, është DSM-00334 [sipas
15 përkthimit]. Nuk po shikoj gjë ende.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Duhet
17 që ta vendosim në kanalën e provave.

18 Z. VON BONE: [Përkthim] Tani ju lutem nëse mundet - të
19 shkojmë në faqen e fundit me numër 00437. Po kjo është. Nëse
20 mund ta zmadhojmë ju lutem. Po faleminderit.

21 Py. Z. Dëshmitar, e shihni fotografinë përpara jush?

22 Pë. Po.

23 Py. E njihni këtë vend?

24 Pë. Edhe pse vend i shkatërrim, po ky ka qenë ai vendi ku ka
25 qëndru, ku kanë qëndru disa ushtarë të guerilës BIA.

1 Py. Po. Ky ka qenë vendi ku shkuat për herë të parë në

2 Zllash?

3 Pë. Për herë të parë në Zllash kam shku te shtabi ose i

4 Brigadës 153.

5 Py. Ku ndodhej ajo?

6 Pë. Nuk e di si me ta përshkru, mbi shpi të Fatmir Sopit, pak

7 më lart. Edhe këtë e di për shkak se Fatmir Sopi ka dalë në

8 rrugë, na ka marrë dhe e kemi çu materialin te shtabi i tyne,

9 vendqëndrimi i tyne ku ka qenë.

10 Py. Në këtë vend këtu jeni takuar me Isa Kastratin?

11 Pë. Po, po.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

13 Avokat, për mua pyetja nuk është e qartë, kur thoni "A ishte

14 ky?" Çfarë është "ky, ky"? Kjo fotografia apo shtëpia e Fatmir

15 Sopit?

16 Z. VON BONE: [Përkthim] A është kjo fotografi e zmadhuar

17 vendndodhja se ku jeni takuar me Isa Kastratin?

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

19 Pyetja që i bëtë përpara kësaj na çoi tek shtëpia e Fatmir

20 Sopit me sa duket.

21 Z. VON BONE: [Përkthim] Ju kuptova.

22 Py. Edhe njëherë, a është ky vendi se ku jeni takuar me Isa

23 Kastratin?

24 Pë. Po.

25 Py. A është ky vendi se ku ndodhej baza e sigurt, pra

1 vendstrehimi i BIA-s?

2 Pë. Po.

3 Py. Asokohe kur keni mbërritur aty, a ju është dashur me
4 kaluar ndonjë barrierë, pengesë me hy në atë vend?

5 Pë. Në çfarë kuptimi, s'po kuptoj, çfarë pengese?

6 Py. Portë, një portë për të hyrë.

7 Pë. Jo, s'ka pasë portë. Nuk ka pasë nonji - s'po di - jam
8 fut si zakonisht. Bile këtu kam thënë kjo po duket qysh është.
9 Dhe kjo pjesa këtu rruga, kjo rruga këtu përpara, porta ka
10 qenë këtu në rregull. Domethënë s'ka pasë ndonjë farë pengese
11 këtu për me u fut brenda.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më
13 falni, kam një pyetje që dua t'ia drejtoj dëshmitarit.

14 Thatë se nuk kishte një portë "si zakonisht". Çfarë doni
15 të thoni "si zakonisht"?

16 DËSHMITARI: Po, shkëlqesia juaj, e nderuar Gjykatëse, "si
17 zakonisht" po thom sepse vendqëndrimi në këto zona apo banimi
18 në këto zona ka qenë me gardhe, gardhe s'di si me i qujt.
19 Ndoshta po e kuptoni çka është fjala gardh. Ka qenë me gardhe
20 edhe normal që e ka pasë një derë për me u fut brenda. Edhe
21 kjo këtu kur kam shku unë, këtu kanë qenë të hapura dyert. A
22 po më kupton - nuk ka pasë pengesë siç më pyeti Avokati "a ka
23 pasë pengesë"? Këtu s'ka pasë pengesë, kanë qenë të hapura
24 dyert.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Faleminderit për këtë sqarim, z. Mehmetaj.

2 Z. Avokat, vazhdoni.

3 Z. VON BONE: [Përkthim]

4 Py. Kishte ndonjë rojë të armatosur kur ju hytë aty, që mund
5 t'ju ketë pyetur se kush jeni, të identifikoheni? A ju
6 kontrolloi kush?

7 Pë. Kur unë jam fut aty nuk ka pasë roje. Edhe nuk e di që ka
8 pasë roje. Edhe domethënë nuk kam pa asnjë roje. Ushtarë që
9 bënin roje nuk kam pa nëse po më pyet kështu. Nuk më ka ndal
10 askush, s'ka lyp identifikim për mu askush.

11 Py. Atë kohë kur jeni takuar këtu me Isa Kastratin, Salih
12 Mustafa ishte aty?

13 Pë. Jo, s'ka qenë.

14 Py. Vetëm këto dy herë ke qenë në Zllash? Pra gjatë kësaj
15 periudhës kohore për të cilën po flasim.

16 Pë. Po, po, gjatë kësaj periudhe kohore po me sa më kujtohet.

17 Py. Faleminderit shumë.

18 Z. VON BONE: Mund ta heqim fotografinë nga ekrani.

19 Py. Z. Dëshmitar, z. Mustafa a të ka dhënë ndonjë urdhër të
20 marrësh dikë, të arrestosh dikë, t'ia çosh atij a diçka të
21 ngjashme me këtë?

22 Pë. I nderuar Avokat, shkëlqesia juaj znj. Gjykatëse, unë e
23 thashë edhe më herët që as nuk ka qenë në kompetencën e Salih
24 Mustafës po as të strukturës që ne e kemi udhëheqë në atë
25 kohë, e cila është quajtur Guerilja BIA që të ketë mekanizëm

1 për arrestim, hetim, apo ndonjë ndalje ose ndonjë veprim
2 tjetër me bo. Kështu që asnjëherë, në asnjë rast, në asnjë
3 rrethanë nuk kam marrë unë edhe nuk kam dëgju që është dhënë
4 ai urdhën tek dikënd tjetër që me bo ksi veprimesh, ato që ju
5 thatë.

6 Py. Po dikush tjetër, a të ka urdhëru ndonjëherë të marrësh
7 dikënd, të arrestosh dikënd, të shoqërosh dikënd diku?

8 Pë. Jo, asnjëherë.

9 Py. U ndave me Isa Kastratin - pas kësaj ku shkove?

10 Pë. U ktheva në Butovc.

11 Py. A e di nëse BIA kishte ndonjë punë me kry në Zllash apo
12 rreth Zllashit?

13 Pë. Jo, asnjë punë nuk ka pasë me e kry në Zllash, as rreth
14 Zllashit. BIA e ka përdor atë vendqëndrim kryesisht për të
15 pushu edhe për t'u kthy. Pastaj ushtarët aty janë ndërru, janë
16 ardhë ushtarë të ndryshëm. Disa kanë qëndru dy-tri ditë, kanë
17 lëviz, kanë ardhë të tjerët. Janë shku në detyra të tjera që i
18 kanë pasë. Kjo ka qenë krejt funksionimi i BIA-s në atë vend.

19 Py. Ke dëgjuar ndonjëherë për një person me emrin Dardan?

20 Pë. Po, persona me emrin Dardan kam dëgju jashtëzakonisht. Ka
21 emna shumë Dardan.

22 Py. Ndonjëri prej këtyre Dardanëve, a kishte të bënte me BIA-
23 në, ishte i përfshirë në BIA?

24 Pë. Ka pasë, po, ka qenë një që ka qenë i përfshirë në BIA.

25 Py. Ky personi, ku ndodhej në lidhje me operacionet e BIA-s?

1 Pë. Të gjithë të tjerët, ushtarët e BIA-s që kanë qenë nëpër
2 njësitate në Prishtinë kanë lëvizë në vende të tjera. Po unë nuk
3 di shumë rreth veprimtarisë që e ka bo ai saktë me ditë çdo
4 ditë ku ka qëndru ose ku ka qëndru zakonisht, po në të
5 përgjithshmen ka lëvizë sikur të gjithë të tjerët që kanë qenë
6 në BIA.

7 Py. Njeh ndonjë me emrin Afrim?

8 Pë. Me emnin Afrim?

9 Py. Unë vetë nuk e di nëse është emër apo nofkë. Thjesht
10 Afrim.

11 Pë. Atje kryesisht kur është bo organizimi i luftës ose për
12 luftën, shumica e njerëzve që kanë marrë pjesë kanë përdorur
13 pseudonime edhe realisht a din është pak e vështirë edhe me i
14 njoftë edhe me i identifiku veç me pseudonim ose veç me emën e
15 mbiemën. Po emnin Afrim nuk më kujtohet që - nuk e di saktë
16 kush është. Edhe mund të jetë ndonjë anëtar i BIA-s, por nuk e
17 di e saktë. Nëse ke ndonjë fotografi ose ndonjë gjë tjetër e
18 kisha vërtetu.

19 Py. T'i kthehemi tani vendndodhjes ku jeni takuar me Isa
20 Kastratin. Në atë vend a vure re a pe se mos kishte ndonjë
21 ndërtesë në veçanti - në atë vend flasim - e cila ruhej
22 posaçërisht nga ndonjë rojë, nga kushdo? Pra ndonjë ndërtesë
23 të veçantë aty a ndonjë objekt të veçantë në atë vendndodhje.

24 Pë. Ju e patë atë fotografinë edhe aty objekte të veçanta
25 s'ka pasë. Mirëpo edhe diçka që ruhej kështu në formë

1 ushtarake nuk kam pa aty që ka pasë ndonjë kujdes të tillë.
2 Py. Në atë vend ku jeni takuar me Isa Kastratin, përmende
3 disa familje. A mund të thuash se me ç'qëllim përdoreshin këto
4 godinat, përse përdoreshin?
5 Pë. Po logjikisht me shku domethënë ata civilët -- janë
6 tërheqë prej vendeve ku s'kanë mund me qëndru edhe aty kanë
7 qëndru, kanë pasë hapësinë me qëndru aty. Edhe qëllimi i tyre
8 ka qenë strehimi sikurse që ka qenë edhe qëllimi i anëtarëve
9 të BIA-s po edhe ushtarëve të tjerë që kanë lëvizë, që kanë
10 ardhë aty. Prapë ka qenë ai qëllim, strehimi.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
12 Avokat, dua ta bëj një pyetje.

13 Nga e dinit këtë?

14 DËSHMITARI: Shkëlqesia juaj, e nderuar Gjykatëse, e di
15 për shkak të përvojave, për shkak të situatës dhe rrethanave
16 të asaj kohe, sepse strehimi ka qenë domethënë gjëja kryesore,
17 të cilin e kanë synu civilët. Edhe aty ku ka pasë edhe ushtarë
18 gjithashtu, ato shtëpia nuk kanë qenë kazerma, as baza
19 ushtarake, por kanë qenë shtëpia të personave civilë, të cilat
20 janë përdorur për strehim edhe kaq organizim pune, kaq, të
21 kushteve, rrethanave qysh atëherë kanë ekzistuar në Kosovë.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
23 patë vetë? I patë këta njerëz që jetonin në ato shtëpi?

24 DËSHMITARI: Po, i pashë, po. Atë ditë kur kam qenë aty i
25 kam pa. Po unë i njoh ata edhe personalisht për shembull

1 atëherë familjen e Mehdi Asllanit e njoh personalisht. Edhe ai
2 ka dhënë eksperiencë, tërë përvojat e veta kur ka shku aty, si
3 ka qëndru edhe të gjitha gjonat.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: Faleminderit për
5 sqarimin.

6 Z. VON BONE: [Përkthim]

7 Py. Isa Kastrati, a të tha ndonjëherë në momentin kur u
8 takuat apo edhe në ndonjë rast tjetër - përpara këtij momenti
9 - pra a të tha nëse ka pasur njerëz të ndaluar në atë vend? Në
10 vendin ku je takuar me të.

11 Pë. Jo.

12 Py. A të tha ai? Kjo është pyetja.

13 Pë. Jo, s'kam bisedu për këto punë, jo. S'më ka thonë asgjë.
14 S'më ka tregu asgjo.

15 Py. Po ti vetë vure re se mos kishte të tillë njerëz aty kur
16 ishe aty?

17 Pë. Nuk pashë asnjë gjë të jashtëzakonshme. Gjithçka ishte
18 ashtu siç e thashë ma herët. Ishte një vend i hapun me njerëz,
19 ushtarë, civilë, të thashë që edhe fshatarët e prunën edhe
20 ushqimin aty që e mbaj mend unë. Domethënë ka qenë gjithçka e
21 zakonshme.

22 Z. VON BONE: [Përkthim] Një moment ju lutem.

23 [Avokati i Mbrojtjes këshillohet]

24 Z. VON BONE: [Përkthim]

25 Py. Z. Dëshmitar, folët pak më parë që ishit në Butovc gjatë

1 dëshmisë - që u kthyet në Prishtinë me i marrë materialet aty.

2 Në atë kohë, besoj se në një moment punonit për Zonën

3 Operative të Llapit apo jo?

4 Pë. Po, organizimi ka qenë i tillë domethënë se: Guerilja BIA

5 ka funksionu në kuadër të Zonës Operative të Llapit dhe të

6 vetmes i ka raportu ose e vetmja ka marrë detyra.

7 Py. Ju kuptoj. Cilat detyra i kishit - jo, më falni. Ta them

8 ndryshe pyetjen. Kur ka ndodhur që u caktuat nëse mund ta them

9 kështu apo u emëruat nga Zona Operative e Llapit?

10 Pë. Në Zonën Operative të Llapit jam emëruar në muajin shkurt

11 të vitit 1999 dhe këto për arsye se atje ndodhën disa lëvizje.

12 Në pozicionin, në të cilin unë u emërova është pozicioni i

13 komandantit ose përgjegjësit për moral e politikë në nivel

14 zone, ku para meje ishte z. Valon Murati, i cili në atë kohë

15 është marrë një përgjegjësi tjetër, përgjegjësinë e Kryetarit

16 të Lëvizjes Kombëtare për Çlirimin e Kosovës. Si pasojë e

17 kësaj, ai dha dorëheqje prej detyrës së Përgjegjësit për Moral

18 e Politikë. Dhe u propozova unë edhe u emërova unë me e bo atë

19 punë.

20 Py. Në rregull. Qëndruat...

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A ka

22 mundësi të bëni pyetje pa fjali pohore?

23 Z. VON BONE: [Përkthim]

24 Py. Në shkurt 1999, më herët folët për faktin se ndodheshit

25 në Butovc duke qëndruar aty pas bombardimeve të NATO-s. Puna

1 juaj apo zona operative e juaj, a ndryshoi, ose ishte ndryshe
2 më saktë. A ndryshonte kur bënit detyra për BIA-në dhe atëherë
3 kur bënit detyra për zonën operative të Llapit? Kishte ndonjë
4 dallim të madh midis këtyre?

5 Pë. Në momentin kur unë e mora lajmin gojor që jam i emëruar
6 në këtë përgjegjësi në Zonën Operative të Llapit, ai normal që
7 filloi që të krijohet ideja edhe të bëhet punë që të gjejë
8 rreth bashkëpunëtor edhe sesi me funksionu kjo punë. Ishte për
9 shkaqe rrethanore të asaj kohe, domethënë nuk ishte e mundur.
10 Unë nuk kam qenë as në shtab. Kur jam emëru aty nuk kam pasë
11 mundësi as me shku pas emërimit te shtabi për arsye të
12 rrethanave të asaj kohe. Edhe kam fillu realisht me mendu qysh
13 me e shtri rrjetin për me i mbulu brigadat që kanë qenë aty,
14 Brigada 153, 152 dhe 151 me njerëz përgjegjës që kanë me
15 udhëheqë këtë sektor. Sepse ishte mjaft i rëndësishëm për atë
16 kohë. Pastaj e këndeje në strukturën e BIA-s veç e kisha
17 organizimin. E kisha strukturën e bame sepse edhe ashtu isha
18 përgjegjës për moralin politik. Dhe vazhdova prapë ta bëj
19 punën njëjtë edhe në BIA në sektorin për moralin politik për
20 me e udhëheqë edhe në BIA. Kështu që dy punë i bëjsha, edhe në
21 zonë të Llapit, por pa qenë fizikisht atje te shtabi, ndërsa
22 këndeje tu qenë fizikisht bëjsha përgatitjet qysh me shtri
23 ndikimin edhe te brigadat e tjera.

24 Z. VON BONE: [Përkthim] Besoj se i mbaruam pyetjet që i
25 kishim znj. Gjykatëse.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk
2 ju dëgjova z. Avokat.

3 Z. VON BONE: [Përkthim] I mbaruam pyetjet.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
5 mirë. Faleminderit.

6 Atëherë do ta ndryshoj pakëz planin. Do t'i drejtohem
7 znj. Prokurore, ta pyes. Jeni gati që të filloni menjëherë apo
8 meqenëse është ora 1 pa një çerek mund të bëjmë pushimin? Dhe
9 unë propozoj që të bëjmë pushim një orë e 15 minuta sepse e
10 bëmë pushimin më të gjatë në orën 11.00. Jua lë juve në dorë.

11 Unë fillimisht po mendoja që të vazhdonim deri në orën 1
12 e një çerek edhe pastaj të bënim pushimin një orë e një çerek
13 dhe të rifillonim në 2.30.

14 Si parapëlqeni? Mos keni nevojë të përgatiteni për
15 kundërpyetjet?

16 Keni fjalën.

17 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po, e nderuara Gjykatëse,
18 mendoj se është më mirë të fillojmë pas drekës.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Mikrofoni
20 çaktivizuar].

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të
22 rifillojmë në orën 2.00.

23 Znj. Asistente e Sallës, ju lutem shoqërohëni Dëshmitarin
24 të dalë nga salla.

25 Z. Dëshmitar, z. Mehmetaj, do të vijojmë në orën 2.00 me

1 pyetjet që do t'jua bëjë Mbrojtësja e Viktimave dhe Zyra e
2 Prokurorit të Specializuar.

3 DËSHMITARI: Faleminderit.

4 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Mbrojtësja e Viktimave, sigurisht ju do filloni, jo
7 Prokuroria. Por besoj se është edhe e pranueshme dhe për ju që
8 ta bëjmë pushimin tani se unë pyeta vetëm znj. Prokurore.

9 ZNJ. PUES: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nëse mund të
10 sugjeroj - mbase do të ishte më mirë që unë pyetjet që mund
11 t'i kem t'i bëj pasi të bëhen kundrapyetjet nga pala
12 kundërshtare. E di se kjo është disi ndryshe nga mënyra sesi
13 kemi ecur deri tani. Por nëse do të kem pyetje dhe cilat
14 pyetje do t'i kem, për shembull, për të konstatuar disa
15 elementë për procesin e konstatimit të së vërtetës ku mund të
16 ketë ndonjë boshllëk, unë këtë mund ta përcaktoj më mirë pasi
17 të kem dëgjuar edhe kundrapyetjet e Prokurorisë.

18 Por sigurisht nëse të nderuar Gjykatës preferojnë që të
19 vazhdojmë me renditjen siç e kemi pasur deri tani, pa problem,
20 unë mund t'i bëj këto pyetje. Por thjesht për qëllime
21 efikasiteti e bëj këtë propozim.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

23 Faleminderit znj. Mbrojtëse e Viktimave.

24 Znj. Prokurore, ç'mendim keni për këtë?

25 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Jemi në dispozicion të të

1 nderuarve Gjykatës, nuk kemi asnjë kundërshtim.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

3 Avokat i Mbrojtjes, dëshironi të thoni gjë për këtë?

4 Z. VON BONE: [Përkthim] Unë do të thosha mund të ndjekim
5 rendin siç e kemi ndjekur deri tani.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

7 Faleminderit.

8 Mendoj që sugjerimi i Mbrojtëses së Viktimave ka kuptim.
9 Mund të bëjmë edhe raundin e dytë, sigurisht. Dhe në raundin e
10 dytë do të doja që të ndiqnim rendin fillestar.

11 Në rregull atëherë. Do të rifillojmë në orën 2.00.

12 --- Pauza e drekës fillon në orën 12.44

13 --- Seanca rifillon në orën 14.00

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju

15 lutem, uluni. Shohim që kemi të njëjtën përbërje siç ishim
16 edhe sot paradite, për procesverbalin e mbajmë shënim këtë.

17 Kam dy çështje të tjera që do të doja t'i komunikoj
18 palëve, përpara se sa të vazhdojmë më tej,

19 Së pari, Trupi Gjykues dëshiron t'i informojë palët, dhe
20 Avokatin e Mbrojtjes dhe Zyrën Administrative që ne preferojmë
21 që të vazhdojmë me planin me tre dëshmitarë në javë. Sigurisht
22 që ky plan mund të rishikohet çdo javë, në varësi të
23 vijimësisë së dëshmimeve të dëshmitarëve. Dhe sigurisht palët do
24 të na informojnë menjëherë në qoftë se ka rrethana të caktuara
25 të cilat do të na bëjmë që të ndryshojmë planin tonë.

1 Kam edhe një pikë të dytë. Në përputhje me paragrafin 27
2 të Vendimit për Zhvillimin e Procesit, që është i protokolluar
3 170 dhe në pajtim me paragrafin 41 të vendimit për të drejtat
4 procedurale të viktimave, që është dokumenti 152, dëshmitari
5 si pari merret në pyetje nga Mbrojtja dhe pastaj merret në
6 pyetje nga Avokati i Viktimave.

7 Kjo është në përputhje me kërkesën që është parashtruar
8 nga Mbrojtja e Viktimave.

9 E njëjta gjë do të ndodhë edhe në seancën e dytë të
10 pyetjeve, kështu që le të vazhdojmë me dëshmitarin sipas këtij
11 rendi.

12 Znj. Sekretare, ju lutem silleni dëshmitarin në sallë.

13 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ndërkohë
14 që vjen dëshmitari, dua të informoj Trupin Gjykses që
15 dokumentet që kemi përmendur, kemi listuar për marrjen në
16 pyetje nga ana jonë, janë nxjerrë në paketën e *Legal Workflow*,
17 që është paketa 126.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
19 faleminderit për informimin.

20 [Dëshmitari vijon dëshminë]

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
22 së erdhët z. Mehmetaj.

23 Përpara se sa të vazhdojmë me marrjen në pyetje nga Zyra
24 e Prokurorit të Specializuar, një pikë për planifikimin, për
25 të cilën ende po pres një përgjigje nga Njësia e Administrimit

1 Gjyqësor për të ditur në qoftë se mund ta zgjasim seancën deri
2 në orën 16.00 apo deri në orën 15.30, të bëjmë një çerek ore
3 pushim dhe pastaj të bëjmë një seancë tjetër. Pra sapo të më
4 thotë Njësia e Administrimit Gjyqësor, do t'ju informoj të
5 gjithëve se si do të vijojmë më tej.

6 Shumë mirë, znj. Prokurore, fjala për juve.

7 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Shumë faleminderit, të nderuar
8 Gjykatës.

9 Pyetje të palës tjetër nga Znj. D'Ascoli:

10 Py. Mirëdita, z. Mehmetaj. Unë jam Prokuroria, që do të
11 drejtoj marrjen tuaj në pyetje në seancën e pasdites.

12 Përpara se sa të fillojmë më pyetjet e mia, më lejoni
13 t'ju kujtoj që ne kemi kohë të kufizuar në dispozicion, kështu
14 që do ta vlerësoja shumë në qoftë se do të përpiqeshit te
15 pyetjet që do t'ju bëj dhe të më jepni përgjigjet që unë do ju
16 kërkoj përmes pyetjeve. Pra në mënyrë koncize, pa u zgjeruar
17 dhe pa shtuar gjëra të tjera. Në qoftë se do të jetë e
18 nevojshme që të shtohen gjëra të tjera, atëherë unë do ta
19 trajtoj këtë gjë.

20 Z. Mehmetaj, a keni përdorur nofkën Bimi gjatë luftës? E
21 kam konkretisht fjalën për periudhën mars-prill të vitit 1999.

22 Pë. Nuk e kam përdorur vetëm në muajt që ju po i potencioni,
23 por që nga lindja. Ashtu më thërrasin për shkak të emrit, e
24 shkurtesa e emrit tim. Familja më ka thirr ashtu, të afërmit,
25 të gjithë njerëzit. Bimi, dhe vazhdojnë të më thërrasin Bimi.

1 Py. A njihnit ndonjë ushtar tjetër të UÇK-së që kishte të
2 njëjtin nofkë?

3 Pë. Po ka, ka të tillë nëpër organizime të tjera, por në BIA
4 kam qenë veç unë.

5 Py. Ju na thatë gjithashtu që nuk jeni në dijeni të ushtarëve
6 të tjerë të UÇK-së që kishte nofkën Bimi. Këtë na e keni thënë
7 gjatë intervistës me ZPS-në në janar të vitit 2020. Nuk e di,
8 e mbani mend këtë? Dhe do ju jap edhe referencën për pak, të
9 nderuar Gjykatës.

10 Pë. Besoj që është në rregull kjo. Unë nuk kam gabuar as
11 atëherë, as tash, që po them, sepse Ushtria Çlirimtare e
12 Kosovës ka pasur numër të madh të njerëzve, e nëpër njësite.
13 Edhe mund të ketë pasur njerëz që kanë [e pakuptueshme] BIA,
14 po çka është e rëndësishme është që brenda organizimit të
15 gueriles nuk ka pasur emër tjerët Bimi, me pseudonim përveç
16 meje.

17 Py. Në rregull, faleminderit.

18 Të nderuar Gjykatës, referenca për pjesën e intervistës
19 së ZPS-së ku dëshmitari ka thënë që nuk ishte në dijeni që
20 kishte anëtarë të BIA-s apo ushtarë të tjerë të UÇK-së që
21 kishin nofkën Bimi. Ai është dokumenti 072957-TR-ET. Bëhet
22 fjalë për pjesën 4, faqe 11 dhe rreshtat nga 19 deri në 25.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

24 Faleminderit.

25 Py. Z. Mehmetaj, unë e kuptoj nga deklarata që keni dhënë më

1 parë dhe nga dëshmia që keni dhënë sot që ju keni punuar
2 bashkë me Salih Mustafën, në mënyrë që të krijonit një njësi
3 të UÇK-së në zonën e Prishtinës. Këtë gjë na e thatë sot në
4 faqen 15 të transkriptimit në kohë reale. E saktë kjo?

5 Pë. Po, e vërtetë.

6 Py. Dhe në fakt puna juaj çoi në krijimin e njësitit gueril
7 në Prishtinë, që është krijuar formalisht dhe që është
8 emërtuar BIA, është krijuar në maj të vitit 1998. E saktë kjo?
9 Sërish këtë thatë sot në transkriptimin e ditës së sotme, në
10 faqen 19.

11 Pë. Po, e saktë, po jo puna e ime, por nevoja për liri ka
12 qenë që ne të bashkohemi dhe të formojmë njësitet për t'i bërë
13 rezistencë sulmeve të armikut që ka qenë.

14 Py. Në rregull. Kur keni kontribuar për krijimin e njësisë
15 guerile, të BIA-s, nga kush i merrnit urdhrat?

16 Pë. Në atë kohë, unë e tregova, kur ka dalë Salih Mustafa
17 prej burgut, unë jam takuar me të dhe kemi bërë bashkë punën
18 për me bo njësitet, domethënë. Pak më vonë urdhrat normal që
19 janë marrë prej komandës së Zonës Operative të Llapit.

20 Py. Dhe përmes cilit ose cilëve, i merrnit ju urdhrat që
21 vinin nga zona operative e Llapit.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.

23 Prokurore, ju kërkoj ndjesë që ju ndërpres, por besoj që do të
24 ndihmonte në qoftë se mund t'i sqaronit dëshmitarit se ajo
25 çfarë tha ai në deklaratën e ditëve të mëparshme, pra kur

1 është marrë në deklaratë që ai duhet ta përsërisë këtë gjë.
2 Pra në qoftë se e ka thënë sot paradite në transkriptim, ne
3 nuk duam që ai të përmendi gjëra që ai i ka thënë sot, por në
4 qoftë se ke gjëra që i ka thënë në deklaratën tuaj, thjesht
5 ndoshta do të ishte mirë që ta kujtonit për këtë gjë.

6 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit, që më kujtuat.
7 Py. Në fakt dua t'i kthehem sërish deklaratës që i keni dhënë
8 Zyrës së Prokurorit të Specializuar, z. Mehmetaj. Ndoshta nuk
9 është e nevojshme që ta shfaqim në ekran, por mund ta lexojmë.

10 Pra ju keni thënë këtë në Pjesën 1 në të njëjtin
11 transkriptim që unë citova pak në përpara. Është faqe 13,
12 rreshti 3 dhe do citoj këtë për procesverbal dhe do ju kërkoj
13 që të konfirmoni nëse e keni thënë këtë.

14 Juve ju bëhet pyetje se nga kush i merrnit udhëzimet dhe
15 nga i merrnit urdhrat. Dhe kjo sërish kishte të bënte me
16 krijimin e njësiteve guerile në Prishtinë.

17 Përgjigja jote ishte: "Gjithmonë përmes Salih Mustafës".

18 A e mbani mend ta keni thënë këtë gjë?

19 Pë. Po e mbaj mend. Po, është e saktë.

20 Py. Në rregull, faleminderit. Po Salih Mustafa, nga i merrte
21 urdhrat për të krijuar njësitin gueril?

22 Pë. Ky është dallim që unë e bëra më herët, domethënë.

23 Urdhrat -- realisht ne kemi bërë një punë të përbashkët me
24 Salih Meustafën në një periudhë të caktuar. Pastaj urdhrat
25 direkt Salih Mustafa i ka marrë prej Zonës Operative të

1 Llapit, prej Shtabit të Zonës Operative të Llapit.

2 Py. Në rregull. Pra Salih Mustafa i merrte urdhrat nga zona
3 operative e Llapit, kështu?

4 Pë. [përgjigja nuk u dëgjua].

5 Py. Kush e miratoi zyrtarisht BIA-n, ekzistencën e BIA-s?

6 Py. Zona Operative e Llapit, sigurisht Komandanti i Shtabit
7 të Zonës.

8 Py. Në rregull. Sot na thatë në faqen 19 të transkriptimit në
9 kohë reale, që ju fillimisht ishit ndihmësi apo
10 zëvendëskomandanti i Salih Mustafës deri në një pikë të
11 caktuar, deri më vonë, dhe ju sqaruat që deri në shkurt të
12 vitit 1999. Është e saktë kjo?

13 Pë. Po, e saktë.

14 Py. A mund të na e sqaroni se si është bërë caktimi juaj.
15 Domethënë kush jua ka dhënë këtë pozitë juve, kush ju ka
16 caktuar në atë pozicion?

17 Pë. Të nderuar Gjykatës, nuk e kam të qartë pyetjen.

18 Py. Sigurisht, mund t'jua përsëris sërish. Kush ju ka caktuar
19 si, së pari, ndihmës dhe pastaj si zëvendës komandant. Kush ua
20 ka dhënë këtë pozicion?

21 Pë. Salih Mustafa.

22 Py. Pra, ju merrnit urdhra prej tij, siç na thatë sot. Këtë e
23 thatë në faqen 22 të transkriptimit në kohë reale. E saktë
24 është kjo?

25 Pë. Po është e saktë, po jo në atë kuptimin ekstrem, urdhra,

1 sikur të jetë aty ndonjë urdhër, ndonjë komandë që --
2 detyrimisht ne kemi punuar në baza vullnetare. E kemi bërë
3 organizimin bashkë dhe e kemi qenë në bashkërenditje për
4 veprimet që janë bërë në atë kohë, para sesa me u themel
5 zyrtarisht BIA, që ka ndodhur në 10 maj të vitit 1999. Pas
6 asaj pune është formuar shtabi dhe është formuar ajo struktura
7 që folëm më herët.

8 Py. Në rregull, më lejoni t'ju ndërpres këtu. Pas majit të
9 vitit 1998, pra pas krijimit formalisht të njësisë BIA dhe
10 pasi ishin bërë emërimet në komandën e BIA-s, ju thatë që
11 pozicionin tuaj ua dha Salih Mustafa dhe ju po merrnit urdhra
12 apo detyra prej tij. Në fakt këtë gjë na e thatë edhe sot në
13 faqen 19, sërish për procesverbal e thatë këtë.

14 Pë. I koordinonim veprimet në atë kohë, bashkë.

15 Py. Në rregull. Pra merrnit detyra dhe urdhra. E saktë?

16 Pë. Po, krejt në rregull. Po.

17 Py. Ju sot na thatë, na treguat për katër sektorët, sipas të
18 cilëve ishte organizuar BIA. Referenca e kësaj është në faqen
19 16 dhe pastaj përsëritet sërish në faqen 19 të transkriptimit
20 të ditës së sotme. Nuk do ta kaloj edhe një herë këtë
21 informacion, por kam disa pyetje lidhur me sektorin për
22 mbledhjen e informacionit. E kuptoj që ky ishte sektori që
23 drejtohej vetë nga Salih Mustafa, përveç faktit që ai ishte
24 edhe komandanti i BIA-s. A është kështu?

25 Pë. Po.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
2 Prokurore, dua t'i kthehem pas diçka që përmendet në faqen 66
3 të transkriptimit, rreshti 6. Dëshmitari tha që: "Ne i
4 koordinonim veprimet me njëri-tjetrin" dhe ju e bëtë
5 përmbledhjen si më poshtë: "Ju keni marrë detyra dhe urdhra,
6 apo jo?" dhe dëshmitari u përgjigj: "Po, po", por ishte pak si
7 e dyshimtë, kështu që dua të pyes se çfarë nënkupton ai me
8 "koordinimi", në mënyrë që të mos i vendosim në gojë fjalë që
9 ndoshta nuk do t'i thotë.

10 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Absolutisht, do ta bëj këtë
11 gjë.

12 Py. Z. Mehmetaj, le t'i kthehem sërish kësaj pyetje. Do të
13 marr citimin që ju përmendet në transkriptimin e ditës së
14 sotme që është në faqen 19. Në këtë faqe thoni që:

15 "...Unë e di që kur i merrnim detyrat nga komandant Cali,
16 i merrnim dhe shkonim në vende në Prishtinë, në garnizonin në
17 Prishtinë. Dhe kishte regjistrime, incizime, skica,
18 përshkrime, e të tjerë. Pra ishin raporte që kërkoheshin nga
19 Zona Operative e Llapit".

20 A e mbani mend ta keni thënë sot këtë, z. Dëshmitar?
21 Pë. Shkëlqesia juaj, të nderuar Gjykatës, a ta bëj sqarimin
22 që ju bëtë pyetjen, apo të vazhdoj me përgjigjen ndaj
23 Prokurores për pyetjen që tash sapo e shtroi?

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Të
25 dyja, z. Mehmetaj, për të dyja. Ideja është që ajo çfarë tha

1 znj. Prokurore është një rifrazim e asaj çfarë doja të dija
2 unë. Ju lutemi përgjigjuni nëse mundeni pyetjes së Prokurorisë
3 dhe nëse më duhet të bëj një pyetje tjetër, do ta bëj këtë
4 gjë.

5 DËSHMITARI: OK. E para e punës, sistemi apo funksionimi i
6 UÇK-së në atë kohë ka qenë funksionim vullnetar. Dhe ne askënd
7 s'kemi mujt me detyru që me i marr në luftë. Edhe vetë kemi
8 shkuar si vullnetarë dhe ajo forma e koordinimit të veprimeve
9 që e thashë, domethënë e thash në këtë drejtim. Dhe nuk ka
10 pasur urdhra absolutë aty që të -- kështu edhe nuk -- sikur
11 the -- sikur qysh funksionojnë ushtritë moderne, botërore. Ne
12 nuk kemi qenë ushtri moderne, kemi funksionuar në rrethana dhe
13 kushte jashtëzakonisht të rënda dhe për atë po e them, kemi
14 pasur bashkërendim në punë, në detyra e në obligime. A është e
15 vërtetë që raporti i Salih Mustafa dhe raporti im ka qenë një
16 raport ku unë kam qenë zëvendës i tij. Detyrat, punët që i
17 merrte nga Zona Operative e Llapit i binte te ne, dhe ne
18 vazhdonim pastaj t'i bënim këto detyra.

19 Në kuadër të përgjigjes që tash po e bëj për pyetjen
20 direkt, është e vërtetë që Salih Mustafa ka marrë detyrë prej
21 komandës së Zonës Operative të Llapit, që me i monitoru, me i
22 vëzhgu dhe me i bë raport për të gjitha bazat që kanë qenë në
23 Prishtinë. E ka shpërnda detyrë te ne dhe ne pastaj e kemi
24 bërë punën në terren. Jemi kthyer me ato raporte, me incizime,
25 me skica, shkrime, e gjëra të tjera, i kemi dorëzuar te Salih

1 Mustafa. Ky i ka përcjellë në Zonën Operative të Llapit, në
2 komandë të Zonës.

3 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Pra, në qoftë se është e qartë
4 për ju, të nderuar Gjykatës, mund të vazhdojmë më tej.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
6 lutem vazhdoni më tej, znj. Prokurore.

7 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

8 Py. Faleminderit që na e sqaruat këtë. Do t'i kthehem
9 sektorit për mbledhjen e informacionit. Ju thatë që ky sektor
10 drejtohej nga vetë Salih Mustafa. E saktë?

11 Pë. E saktë.

12 Py. Ju na thatë në deklaratat e mëparshme, por gjithashtu
13 edhe sot në qoftë se do të përmblihdhja atë çfarë thatë në
14 faqen 19 e më poshtë, funksionet e ndryshme që kishin këto
15 sektorë. Ju thatë që ky funksion, domethënë funksioni i
16 mbledhjes së informacionit, përfshinte monitorimin e lëvizjeve
17 të forcave armike, incizimeve, regjistrimeve të vendndodhjeve
18 të tyre në Prishtinë dhe përreth Prishtinës. Kështu?

19 Pë. E saktë.

20 Py. Dua të qartësoj se si punonit brenda këtij sektori. Besoj
21 që na e keni dhënë një përgjigje, por do të doja që të jepnit
22 më shumë sqarime, më tej. Ajo çfarë dua të di është se si
23 dërgohej informacioni në zonën operative të Llapit. Pra,
24 anëtarët e BIA-s e mblihdhnin informacioni. Dhe çfarë bënit me
25 këtë informacion pastaj?

1 Pë. Po, po.

2 Py. Ja raportoni Salih Mustafës, të paktën kështu e kuptoj
3 nga dëshmia e sotme?

4 Pë. Kështu ka qenë. Po, kështu është.

5 Py. Dhe ai pastaj bënte raportimin e këtij informacioni në
6 instancat më lartë të zonës operative të Llapit. Kështu?

7 Pë. [E padëgjueshme].

8 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Kam gjithashtu edhe referencat
9 e deklaratave të mëparshme konsistente që ka dhënë për ZPS-në.
10 mund t'i përmend për procesverbal. Pra bëhet fjalë për faqen
11 [sipas përkthimit] 1 të të njëjtit transkriptim, faqja 24,
12 rreshti nga 1 deri në 6.

13 Py. Përsëri për ta sqaruar më tej. Salih Mustafa merrte
14 urdhra nga Zona Operative e Llapit, nga komanda e Zonës
15 Operative të Llapit. Kështu?

16 Pë. Po, vërtetë.

17 Py. Ai informacionin e mbledhur ja raportonte komandës së
18 Zonës Operative të Llapit. Kështu?

19 Pë. Po, e saktë.

20 Py. Një parantezë të vogël sa i takon përbërjes së njësitit
21 BIA. A mund të na thoni se sa anëtarë, sa pjesëtarë kishte BIA
22 në momentin kur kishte maksimumin e anëtarëve?

23 Pë. Po, specifikisht prej kohëve në të cilat kemi vepruar --
24 maksimumi i anëtarëve -- po nuk kam pasur ndonjë saktësi në
25 numër, po nëse po pyetni direkt veç për maksimumin e anëtarëve

1 në kohën më të mirë të mundshme të organizimit, ka mund të
2 jetë 400-500 njerëz.

3 Py. Në rregull, faleminderit. Komandanti, Salih Mustafa, a i
4 dinte këto specifika. Domethënë këto shifra në pika të
5 caktuara kohe?

6 Pë. Po sigurisht, edhe mund t'i ketë -- po besoj që i ka
7 ditë. Tash është pyetje që duhet t'i bëhet Salih Mustafës, unë
8 nuk kam aq dije që --

9 Pë. Është e mjaftueshme, faleminderit. Në rregull,
10 faleminderit.

11 Dëshiroj t'i kthehem sërish diçkaje që ju thatë sot në
12 fund të dëshmisë në mëngjes. Të nderuar Gjykatës, i referohem
13 faqes 57 të transkriptimit në kohë reale, në rreshtat nga 5
14 deri në 7. Kur po diskutoni për emërimin tuaj si personin
15 përgjegjës për moralin dhe politikën në nivelin e Zonës
16 Operative të Llapit. Ju thatë që në këtë rol, ju diskutoni
17 mënyrën se si të punohej, apo se si të gjendeshin
18 bashkëpunëtorë në mënyrë që të përmirësohej puna, e kështu me
19 radhë. Çështja e bashkëpunëtorëve ishte një çështje e
20 rëndësishme për UÇK-në, kështu?

21 Pë. Nuk e kuptoj pyetjen. Çështja - për çfarë bashkëpunëtorë
22 po mendoni?

23 Py. Do ta formuloj ndryshe.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Deri
25 tani kam pranuar pyetjet e mbyllura sepse i jeni referuar

1 transkriptimit, por kjo është një pyetje të cilën mund ta bëni
2 ndryshe, ta formuloni ndryshe.

3 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Absolutisht, të nderuar
4 Gjykatës. Do ta bëj këtë gjë.

5 Py. Pra lidhur me atë çfarë ju thatë më përpara që ju
6 diskutoni lidhur me mënyrën e gjetjes së bashkëpunëtorëve.
7 Pyetja ime e parë është: çfarë donit të thoshit me këtë?

8 Z. VON BONE: [Përkthim] [Nuk ka përkthim].

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
10 qoftë se ka diçka që doni të thoni lidhur me dëshminë, do të
11 ishte mirë që dëshmitari të mos dëgjonte, kështu që do
12 preferoja që ta nxirrnim nga salla e gjyqit aktualisht.
13 Domethënë, në qoftë se kemi diskutim për përmbajtjen, dua që
14 ai të mos jetë i pranishëm këtu.

15 Nuk është problem, është thjesht pyetje për juve.

16 Z. VON BONE: [Përkthim] Unë po mundohem --

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
18 atëherë, unë në këtë pikë do t'i kërkoj dëshmitarit që të dalë
19 nga salla.

20 Z. Dëshmitar, do t'i kërkoj Sekretares që t'ju shoqërojë
21 për pak minuta jashtë sallës së gjyqit dhe pastaj do të
22 ktheheni sërish mbrapsht.

23 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

24 [Avokati i Mbrojtjes këshillohet]

25 Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar

1 Gjykatës.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

3 Mustafa, ju lutem. Sepse i dini rregullat këtu.

4 Avokat, mund të vazhdoni

5 Z.VON BONE: [Përkthim] Pyetja shtrohet me fjalën

6 "bashkëpunëtorë" dhe lidhet gjithashtu me atë çfarë tha -- me

7 komentin që bëri dëshmitari, që çfarë doni të thoni me

8 bashkëpunëtorë? Në pyetje është e paqartë se çfarë nënkuptohet

9 me këtë. Nënkuptohen anëtarët e BIA-s, personat që ishin me

10 BIA-n, apo ka ndonjë konotacion tjetër të kësaj fjale.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Unë e

12 kuptova shumë ndryshe nga çfarë thatë ju, megjithatë do t'i

13 jap fjalën znj. Prokurore që të përgjigjet lidhur me atë çfarë

14 thatë.

15 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, unë mendoj

16 që fjala është e kuptueshme. Do t'i bëj pyetje dëshmitarit

17 lidhur me të dhe nuk jam e sigurt në qoftë se e kuptoj

18 argumentin e Mbrojtjes lidhur me kuptimin e fjalës. Fjala në

19 vetvete është e qartë në transkriptim.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Është

21 një fjalë e cila është përdorur në transkriptim.

22 Z. VON BONE: [Përkthim] Po, po. U përdor edhe nga

23 dëshmitari. Dëshmitari tha që nuk e di për çfarë e keni fjalën

24 kur thoni "bashkëpunëtorë".

25 [Avokati i Mbrojtjes këshillohet]

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
2 lutem për një moment mund të me lejoni të flas.

3 Ju lutem fikni mikrofonin se përndryshe do ju dëgjojnë të
4 gjithë. Është për juve.

5 Z. VON BONE: [Përkthim] Shqipja ime nuk është shumë e
6 mirë, por fjala e përdorur në shqip do të thotë
7 "bashkëpunëtorë". Kjo është mënyra se si u përkthye. Thjesht
8 dua që të sigurohemi që nuk do i japim tjetër kuptim kësaj
9 fjale nga kuptimi që ka në gjuhën shqipe.

10 Për këtë arsye, mendoj që t'i bëhet e qartë dëshmitarit,
11 sepse dëshmitari vetë tha që nuk e kishte të qartë se çfarë
12 nënkuptohej me përdorimin e kësaj fjale, çfarë donte të
13 thoshte kjo fjalë.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ajo
15 çfarë propozoj unë, znj. Prokurore, është që juve të ktheheni
16 mbrapsht te burimi fillestar ku e mbështetët pyetjen. Ju lutem
17 citoni atë, në mënyrë që të mund të sqarojmë se në çfarë
18 konteksti është përdorur dhe pastaj të vijoni me pyetjen tuaj.

19 Është e pranueshme kjo mënyrë për të vijuar?

20 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës, po nuk
21 doja që të përsërisja dhe prandaj nuk e lexova pjesën e
22 transkriptimit në kohë reale, por nëse juve thonin këtë gjë,
23 patjetër do ta lexoj transkriptimin dhe pastaj do të bëj
24 pyetjen.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra

1 dukshëm, dallueshëm, nuk ishte e qartë kjo për dëshmitarin se
2 prandaj e bëri pyetjen, kështu që ju lutem vijojmë në këtë
3 mënyrë.

4 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Patjetër.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
6 Sekretare, ju lutem silleni sërish dëshmitarin në sallë.

7 [Dëshmitari vijon dëshminë]

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
9 se u rikthyet. Do të vazhdojmë tani.

10 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

11 Py. Z. Mehmetaj, për ta bërë më të qartë pyetjen e mëparshme,
12 po kështu edhe përgjigjen, unë do të citoj nga transkriptimi i
13 seancës sot nga faqja 56 deri në faqen 57, dhe do ta lexoj
14 pyetjen siç e bëri avokati, së bashku me përgjigjen tuaj, në
15 mënyrë që të jetë e qartë se për çfarë e kemi fjalën.

16 Faleminderit, do të vazhdojmë kështu.

17 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Do të filloj të lexoj, të
18 nderuar Gjykatës, nga faqja 56, rreshti 24 i transkriptimit
19 sot, ku ka filluar edhe pyetja e avokatit të Mbrojtjes.

20 Py. "Pra, shkurt 1999" - kjo është pyetja - "më herët folët
21 për faktin se ndodheshit në Butovc, duke qëndruar aty pas
22 bombardimit të NATO-s. A pati ndonjë ndryshim, a ndryshoi puna
23 apo zona e veprimit, a bëtë diçka ndryshe nga ato që bënit për
24 BIA-n, apo që bënit për zonën operative të Llapit? Pati ndonjë
25 dallim nga kjo gjë?".

1 Kësaj pyetje, z. Mehmetaj, ju iu përgjigjët kështu --
2 tani kemi kaluar në faqen 57, rreshti 5:

3 "Kur unë mora lajmin gojarisht se isha caktuar në këtë
4 pozitë, në nivel të Zonës Operative të Llapit, sigurisht ne i
5 diskutonim idetë se si të punonim, se si të gjenim
6 kolaboracionistët, pra që janë bashkëpunëtorët, si ta
7 përmirësoni punën".

8 Në qoftë se ju kujtohet kjo tani?

9 Py. A me vazhdu?

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

11 Pyetja është: a ju kujtohet apo jo?

12 DËSHMITARI: Po, më kujtohet shumë mirë, dhe muj me vazhdu
13 me përgjigjen që bëri më herët e nderuara Prokurore.

14 A të vazhdoj, e nderuara Gjykatëse?

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,

16 jo, jo. Prokurorja do t'ju bëjë tani pyetje dhe mund t'i
17 përgjigjeni pyetjes së Prokurores, që të mbajmë gjërat e
18 organizuara.

19 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

20 Py. Pikë së pari, a ishte e rëndësishme për UÇK-në që të
21 gjente, të identifikonte kolaboracionistët. Mjafton një
22 përgjigje, po ose jo.

23 Pë. Po kjo mund të diskutohet ose -- përgjigja po dhe jo,
24 këtu nuk ka peshë. Për ato që thashë unë më herët. Unë ju
25 kisha lutur, e nderuara Prokurore, mos u udhëhiqni prej

1 paragjykimeve. Unë nuk përmenda kolaboracionistë, por përmenda
2 bashkëpunëtorët të mitë, që kanë qenë ushtarë të Ushtrisë
3 Çlirimtare të Kosovës me të cilët do ta bëja, funksionalizoj
4 sektorin për moralin politik në nivel të Zonës Operative të
5 Llapit. Jo, kolaboracionistë nuk kam përmendur, por
6 bashkëpunëtorë, ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare, të cilët do të
7 merrnin përgjegjësi për funksionim të sektorit nëpër brigada
8 dhe pjesë të tjera, e nderuara Gjykatëse. Kjo ishte ajo që kam
9 thënë është herët. Nuk ka të bëjë me atë çka tha Prokurorja.
10 Py. Në rregull, pra e keni fjalën që kur keni thënë
11 bashkëpunëtorë, me fjalën "bashkëpunëtorë" e kishit fjalën për
12 persona të cilët bashkëpunonin me UÇK-në.

13 Pë. Personalisht, më falni, me mua personalisht, unë që kam
14 qenë udhëheqës i sektorit për moralin politik, ka pasur nevojë
15 që me gjetë disa njerëz të tjerë që e përfaqësojnë këtë sektor
16 nëpër brigadat e Zonës Operative të Llapit. Kaq. Ushtarë janë
17 ata.

18 Py. Faleminderit që e sqarua këtë.

19 T'i kthehemi tani pyetjes që unë bëra më përpara dhe ju
20 kërkoi një përgjigje për të. Do ta përsëris pyetjen.

21 Pyetja ishte kjo: a ishte e rëndësishme që UÇK-ja të
22 gjente dhe të identifikonte kolaboracionistët, pra nuk e kam
23 fjalën për njerëzit që punonin me ju, por njerëzit që punonin
24 kundër jush?

25 Pë. Për UÇK-në ka qenë e rëndësishme dhe e domosdoshme liria

- 1 dhe arritja e lirisë. Lufta kundër okupatorit dhe kjo ka qenë
2 më e rëndësishmja për UÇK-në. Për aq sa di unë.
3 Py. Mirë. A mund t'i përgjigjeni pyetjes sime? E kuptoj bazën
4 e kësaj, por mund t'i përgjigjeni pyetjes?
5 Pë. Pyetje që e kam të vështirë me ju përgjigj, sepse s'kemi
6 pasur ndonjëherë punë me kolaboracionistë.
7 Py. Pra po thoni se kjo -- ky problem nuk është ngritur nga
8 askush, nuk është përmendur, pra nuk ishit në dijeni që kishte
9 njerëz që punonin kundër UÇK-së? Pra që punonin me armikun?
10 Këtë po dëshmoni këtu sot?
11 Pë. Për -- unë aq sa unë kam njohuri dhe as me prezencën time
12 ku kam qenë unë, nuk është diskutuar asnjëherë kjo
13 problematikë. Është diskutuar vetëm problemi që e kemi
14 okupatorin pushtues, që ka qenë në Kosovë.
15 Py. Mirë, z. Mehmetaj, do t'i kthehem tani një pjese të
16 deklaratës që ja keni dhënë Zyrës së Prokurorit të
17 Specializuar në janar to vitit 2020. Përpara kësaj dua t'ju
18 bëj këtë pyetje: a ishit në dijeni të ndalimeve në Zllash?
19 Pë. Jo, asnjëherë.
20 Py. Nuk ishit në dijeni?
21 Pë. [E padëgjueshme] -- ndalimeve në Zllash.
22 Py. Në rregull, kjo është mjaft e qartë.
23 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, a më
24 lejoni që t'ja rifreskoj kujtesën dëshmitarit duke lexuar disa
25 pjesë nga intervista me ZPS-në.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
2 Prokurore, unë do të thosha që për këtë pjesë të nxjerrim në
3 ekran dokumentin, sepse është -- ka shumë gjëra të deklaruara
4 aty.

5 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Pikërisht edhe unë këtë do të
6 kërkoja.

7 Ju lutem atëherë, dokumentin me numër 072957-TR-ET, më
8 duhet Pjesa 4, faqja 5. Do ta filloj me rreshtin 12.
9 Py. Përpara se të flasim për këtë, z. Mehmetaj, dua të sqaroj
10 diçka. Pra ju thatë që nuk keni dëgjuar kurrë për diskutime
11 për kolaboracionistë gjatë kohës që keni kaluar në UÇK? Këtë
12 po thoni?

13 Pë. E nderuara Prokurore, shkëlqesia juaj, e nderuar
14 Gjykatëse, unë sot këtu jam nën betim, për të thënë të
15 vërtetën dhe vetëm të vërtetën. Dhe për ta thënë të vërtetën
16 dhe vetëm të vërtetën, bazohem vetëm në ato që kam parë, e kam
17 prekur fizikisht, e kam parë, si me thënë ose ma ka thënë
18 dikush që ka qenë atëherë aty. Në këto drejtime unë nuk dal --
19 sot jam këtu në betim dhe nuk flas me fjalë të rrugëve ose
20 gjëra të tjera. Me respektin për Gjykatën, po unë këtë po bëj.
21 Sot e them vetëm të vërtetën dhe të vërtetën. Tash jam në
22 betim kur po flas.

23 Py. Faleminderit për këtë z. Mehmetaj. Ju lutem t'i
24 përgjigjeni pyetjes. Pyetja ishte e thjeshtë. Dua të di nëse
25 nuk keni dëgjuar kurrë, asnjë diskutim, asgjë në lidhje me

1 kolaboracionistë gjatë kohës që keni kaluar në UÇK. Mund të
2 përgjigjeni me po ose me jo.

3 Pë. Unë nuk kam parë, nuk kam pasur njohuri, nuk kam dëgjuar
4 për kolaboracionistë në UÇK. Ashtu po më pyet Prokurorja, po
5 më duket.

6 Py. Pra, përgjigja juaj është "jo".

7 Shikoj që e kemi tani në ekran transkriptimin e
8 intervistës suaj me ZPS-në. Unë do të lexoj pyetjen që
9 Prokurori ju ka bërë atëherë në janar të vitit 2020.

10 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, po lexoj
11 nga rreshti 12.

12 Py. Z. Mehmetaj, do ta dëgjoni përkthimin në dëgjuese.

13 Kjo është pyetja:

14 "Pra, kolaboracionistët shqiptarë mbaheshin të ndaluar në
15 vendndodhje të tilla si Llapishtica, Bajgora, por a kishte të
16 ndaluar në Zllash, kolaboracionistë, persona që dyshoheshin si
17 kolaboracionistë, pra që ishin shqiptarë?

18 Kjo ishte pyetja e Prokurorit.

19 Tani do të lexoj përgjigjen tuaj, që është rreshti 15 në
20 të njëjtën faqe. Faqja 5.

21 Përgjigja juaj:

22 "Kam informacion. E kam marrë këtë informacion pas lufte.
23 Atëherë në Zllash kishte një dhomë ku ndaloheshin njerëz."

24 Pyetja e Prokurorit:

25 "Ç'lloj njerëzish ndaloheshin?"

1 Dhe ju i jeni përgjigjur:

2 "Nuk kam informacion të mëtejshëm. Nuk kam informacion
3 nëse ishin kolaboracionistë, nëse ishin ushtarë, nëse ishin
4 njerëz që shkaktonin dëm, nëse kishte hajdutë, apo çfarë
5 njerëzish ishin".

6 Lexova deri në fund të përgjigje suaj ndaj kësaj
7 pyetjeje.

8 T'ju pyes edhe një herë. Sot na thatë që nuk kishit
9 dëgjuar kurrë për ndalimet në Zllash, por nuk është se na keni
10 thënë kështu në këtë deklaratë të mëparshme që ja keni dhënë
11 ZPS-së.

12 Tani që ua lexova këtë pjesë, a ua rifreskon kujtesën që
13 në fakt keni dëgjuar për ndalime në Zllash dhe në veçanti të
14 personave që dyshoheshin si kolaboracionistë, të cilët
15 ndaloheshin, mbaheshin të ndaluar në Zllash.

16 Pë. E nderuar Prokurore, ju e lexuat këtë pjesë por sikur ta
17 lexoni pjesën më poshtë të deklaratës time sigurisht që e
18 gjeni edhe përgjigjen që unë tash ua them. Unë këto çka i kam
19 deklaruar aty para jush, se edhe ju keni marrë pjesë në seancë
20 atëherë, bashkë me Prokurorin Andrew, unë e kam thënë vetëm me
21 të ndime, të dëgjuara pas lufte, që nuk janë të konfirmuara
22 dhe nuk janë të vërteta. Unë këtu para Gjykatës së nderuar jam
23 nën betim, para Gjykatës. Dhe tash nuk mund të flas me gjëra
24 që janë folur rrugëve, pa ndonjë adresë.

25 Py. Po, z. Mehmetaj. Ta nxjerrim edhe atë pjesë në ekran,

1 sepse më thatë, kur ju pyeta nëse kishit dijeni për ndalimet
2 në Zllash, ju thatë - dhe po lexoj nga faqja 76, rreshti 22 i
3 transkriptimit sot, që "Nuk isha në dijeni për ndalimet në
4 Zllash". Kjo është përgjigja juaj.

5 Po, më falni, nuk kam mbaruar.

6 E nxora këtë transkriptim dhe pastaj ju pyeta, "A jua
7 rifreskon kjo kujtesën, nëse kishit dijeni për ndalimet në
8 Zllash, po apo jo?".

9 Pë. Unë e shpjegova shumë mirë çfarë informata kam pasur ose
10 çfarë dijenie kam pasur. Në pasuesin më poshtë del ajo që e
11 kam thënë edhe para jush, që këto informata kanë qenë
12 informata jo të sakta, jo të sigurta, janë informata që janë
13 marrë pej rrugës, e është fol. E kush ka fol, nuk e di, por
14 është fol. Për ato nuk është që kjo -- që unë e përfaqësoj.
15 Sepse sot e përfaqësoj vetëm ato që unë i di, që i kam të
16 konfirmuara dhe që është e vërtetë.

17 Py. Po, z. Mehmetaj, dhe në fakt po ju pyes se çfarë dini,
18 çfarë keni dëgjuar. Por fillimisht thatë që nuk kishit dijeni
19 nëse kishte ndalime. Tani thoni që keni dijeni që kishte
20 ndalime. Pra a ju kujtohet që keni thënë që kishit dijeni për
21 ndalimet, në janar të vitit 2020?

22 Pë. E nderuara Prokurore, ju kisha lut të bëni dallimin e
23 asaj që unë po e them. Dallimi është ky: çka është dëgjuar dhe
24 dijenia dallojnë shumë. Unë dijeni nuk kam pasur dhe çka është
25 dëgjuar, fjalë që kanë folur nëpër rrugë e kularë të caktuar,

1 unë -- atë sot këtu nuk e përfaqësoj. Sot e përfaqësoj të
2 vërtetën, sepse jam në betim.

3 Py. Z. Mehmetaj, sapo u keni thënë këtu Prokurorëve në janar
4 të vitit 2020, se kishit dëgjuar për ndalime në Zllash. A
5 është e vërtetë? Të paktën për këtë të pajtohemi dhe pastaj të
6 kalojmë te pyetja tjetër, pyetje të tjera.

7 Pë. Është folur, domethënë, OK, është në rregull për këtë që
8 është folur. Por e vërtetë nuk është, nuk -- dijeni, nuk e kam
9 parë. Kaq. unë edhe një herë po ju tregoj që sot këtu jam nën
10 betim dhe do të them vetëm të vërtetën. Kjo është në interes
11 timin, në interes të drejtësisë, të Gjykatës.

12 Py. Në rregull, pra --

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
14 Prokurore, dua të bëj një ndërprerje të shkurtër.

15 z. Mehmetaj, ju kemi thënë që duam që të thoni të
16 vërtetën, e thamë këtë në mëngjes, lidhur me atë që ndër të
17 tjera edhe keni dëgjuar. Nëse keni dëgjuar, këtë duam të dimë.
18 A është e konfirmuar apo jo, s'ka rëndësi. E keni dëgjuar dhe
19 mund të na e thoni, mund të na e tregoni. Ju siguroj që nuk e
20 prishni betimin nëse u tregoni Gjykatësve që e keni dëgjuar,
21 pra atë që keni dëgjuar.

22 Nëse ka për shembull të thëna, të dëgjuara kështu nga
23 persona të tjerë, edhe këto mund të t'ja thoni Gjykatësve, pa
24 e prishur betimin.

25 Z. Prokurore, mund të vazhdoni.

1 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar

2 Gjykatës.

3 Py. Z. Mehmetaj, keni dëgjuar se kishte një dhomë ku

4 ndaloheshin njerëzit në Zllash. Kështu?

5 Pë. Po, pas asaj që e nderuara Gjykatëse në një farë forme më

6 sqaroi, po mandej nuk e di a është shumë me rëndësi për

7 drejtësinë ajo çka flitet dhe nëse është e pavërtetë,

8 domethënë. Nëse prapë ju e vlerësoni që unë muj me u fut në

9 këtë temë, po mendoj që nuk jam i obligim me të thënë gjena që
10 nuk janë të vërteta, tash këtu.

11 Py. Z. Mehmetaj, thjesht po ju bëj pyetje se çfarë keni

12 dëgjuar se më përpara na keni thënë që kishit dëgjuar që

13 kishte një dhomë në Zllash, ku ndaloheshin njerëz. Ju kujtohet

14 kjo? Pastaj të vazhdojmë me pyetjet e tjera. Sepse ju

15 qëndrimin tuaj e bëtë të qartë, e tani po ju pyes vetëm çfarë

16 keni dëgjuar.

17 A e konfirmoni që e keni dëgjuar këtë gjë apo jo? Po ose

18 jo.

19 Pë. Po, nëse Gjykatësja thotë që është në shërbim të

20 drejtësisë, unë po vazhdoj po i përgjigjem pyetjes që bën

21 Prokurori.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ajo

23 se ç'është në shërbim të drejtësisë, do ta shohim, por këtu

24 jeni që të jepni përgjigje se çfarë keni parë, çfarë keni

25 dëgjuar, çfarë keni ndjerë, përjetuar, Nëse është diçka që e

1 keni dëgjuar, mund t'ja tregoni Trupit Gjykues.

2 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

3 Py. Ta bëj edhe një herë pyetjen.

4 A është e vërtetë se keni dëgjuar për ekzistencën e një
5 dhome në Zllash ku mbaheshin të ndaluar njerëz? Po apo jo.

6 Pë. Me sa më kujtohet. Ashtu siç e kam thënë këtu në dëshmi,
7 po, kam dëgjuar. Po.

8 Py. Mirë, faleminderit. Ku në Zllash mbaheshin këta njerëz,
9 në bazë të atyre që keni dëgjuar?

10 Pë. Në bazë të asaj që unë kam dëgjuar, aty ku ka qenë ai
11 kompleksi që, i shtëpive që i pamë këtu në --

12 Py. Pra, e keni fjalën për atë vendndodhje, atë vendin në
13 Zllash, atë që e quajtet si vendstrehimi i përdorur nga BIA,
14 në kodër, të cilën e pamë më herët në foton ajrore që e
15 paraqiti Avokati i Mbrojtjes?

16 Pë. Nuk është strehim i përdorur nga BIA, por i përdorur nga
17 të gjithë. Edhe të tjerët e kanë përdorur, jo vetëm BIA dhe
18 qytetarët civilë edhe ushtarët, siç e thashë edhe më herët.

19 Py. Do ta bëj edhe një herë pyetjen. Ka më shumë për dhomat
20 që përdorte BIA, sepse kjo është deklarata që thatë më
21 përpara. Pra edhe një herë, e keni fjalën për godinën lartë në
22 kodër, që e pamë në foton ajrore, ku BIA kishte dhoma, të
23 cilat i përdorte, të cilat i quajtet edhe si strehim. Jemi
24 dakord për këtë?

25 Pë. Po.

1 Py. Mirë. A ju kujtohet se kush ua dha këtë informacion për
2 këto ndalimet? Nga e dëgjuat këtë informacion?

3 Pë. Po siç e kam thënë më herët, ky ka qenë një informacion
4 që është folur. Nuk e kam të qartë, absolut, as në njohur, as
5 në memorien ime kush dhe ku është folur, por është folur diku.
6 Kështu besoj që s'është e vërtetë.

7 Py. Përtej një vlerësimi të kësaj, t'i kthehem pyetjes: a ju
8 kujtohet se kush ua tha këtë informacion? A ju kujtohet se
9 prej kujt e dëgjuat këtë informacion? Ju lutem përgjigjuni
10 kësaj pyetjeje.

11 Pë. E nderume Gjykatëse, në këtë pyetje që ma bën e nderuara
12 Prokurore.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Cila
14 ishte përgjigja juaj?

15 DËSHMITARI: Përgjigja ime ka qenë që ka një informatë,
16 një diçka që është folur. Unë nuk kam njohuri, nuk e di, s'më
17 kujtohet kush e ka thënë këtë punë.

18 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

19 Py. Në rregull. Është e qartë tani. Faleminderit.

20 Salih Mustafa, komandanti i BIA-s, a do të kishte dijeni
21 për ekzistencën e një vendi të tillë.

22 Z. VON BONE: [Përkthim] E nderuara Gjykatëse, nuk mendoj
23 se dëshmitari --

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Fjalën e keni, por gjithmonë për hir të përkthyesve, jo se më

1 pëlqen mua, por që të jetë e qartë se kush flet.

2 z. Avokat i Mbrojtjes, keni fjalën.

3 Z. VON BONE: [Përkthim] Dëshmitari nuk mund ta dijë se
4 çfarë di apo nuk di z. Salih Mustafa. Kur bëhet një pyetje,
5 nëse ka dijeni dikush tjetër, unë nuk besoj se kjo është diçka
6 për të cilën mund të dëshmojë dëshmitari.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Unë
8 nuk pajtohem me këtë.

9 Z. Prokurore, mund të vazhdoni.

10 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, baza e
11 pyetjes time është deklarata e mëparshme që ka dhënë
12 dëshmitari. Por do të vijoj dhe mund ta shohim edhe atë po të
13 jetë e nevojshme.

14 Py. Z. Mehmetaj, z. Salih Mustafa a do të ishte në gjendje që
15 të kishte dijeni për këto çështje, për ekzistencën e një vendi
16 të tillë në Zllash?

17 Pë. Në bazë të kompetencës që ka pasur Salih Mustafa dhe në
18 bazë të organizimit të gueriles BIA, nuk e ka pasur atë
19 kompetencë as me ditë, po as me bo atë punë, as me e ndërmarre
20 ato veprime. Edhe unë me tej ju them me siguri të plotë se
21 asnjëherë s'e kemi diskutuar me Calin këtë temë dhe nuk e di
22 personalisht a ka pasur njohuri ai, unë nuk mund ta them, por
23 jam i sigurt që jo. Nuk ka pasur njohuri, nuk besoj. As Salih
24 Mustafa. S'ka pasur kompetencë me u marr me këto tema. S'janë
25 kanë temat tona këto.

1 Py. Pikë si pari, edhe një herë, nuk ju përgjigjët pyetjes
2 sime por kuptoj se i keni diskutuar këto çështje me atë,
3 përderisa jeni në gjendje të thoni që nuk kishte dijeni për
4 këtë. Thjesht po citoj transkriptimin që: "Unë personalisht e
5 di që ai nuk kishte dijeni për këtë..."

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
7 Prokurore, unë e lexoj kështu: "Nuk e kam diskutuar kurrë këtë
8 gjë me Calin. Kështu tha, dhe pastaj thotë: "Unë e di
9 personalisht që nuk kishte dijeni për këtë" por pak më përpara
10 thotë që nuk e kishte diskutuar. Nuk mund të thoni që e kanë
11 diskutuar.

12 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po pyetja ime është kjo, se mos
13 e ka diskutuar për sa kohë që ka dijeni, pra duke cituar atë:
14 "Unë personalisht e di që ai nuk kishte dijeni për këtë".

15 Py. Prandaj, z. Mehmetaj, dua që të sqaroj me ju: a keni
16 diskutuar apo jo me z. Salih Mustafa për këto çështje. Sepse
17 shikoj një kontradiktë, një kundërthënie në përgjigjen tuaj
18 dhe dua që ta sqaroj këtë.

19 Pë. E nderuara Prokurore, me gjithë respektin, por ju prapë
20 po niseni nga paragjykimi për ta zbuluar të pavërtetën, jo të
21 vërtetën. Unë e thashë që nuk e kemi diskutuar asnjëherë këtë
22 punë, por në bazë të kompetencës, nuk e di a jam i qartë, në
23 bazë të kompetencës unë e di Salih Mustafa --

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
25 Mehmetaj, ju lutemi përgjigjuni pyetjes. Pa komente, nuk jeni

1 këtu për të dhënë komente. Jeni këtu për t'ju përgjigjur
2 pyetjeve. Ju lë hapësirë, por ju lutem mos flisni nga këto.

3 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

4 Py. Keni nevojë tua përsëris pyetjen?

5 Pë. Jo, se fillimisht kërkoj falje, shkëlqesia juaj, e
6 nderuara Gjykatëse, po unë e konstatova që fjalët e mia po
7 transmetohen ndryshe, për atë e bëra reagimin, dhe më vjen keq
8 për këtë.

9 Nuk e kemi diskutuar, e nderuar Prokurore. Me kompetencë
10 Salih Mustafa nuk i ka pasur këto funksione me i kry ato që po
11 i thoni ju.

12 Py. Atëherë a mund të sqaroj një pjesë të dëshmisë suaj të
13 mëparshme që ja keni dhënë ZPS-së.

14 Të nderuar Gjykatës, e kam fjalën për të njëjtin
15 transkriptim, Pjesa 4, faqe 8, rreshtat 8 deri në 22.

16 Py. Këtu ju është bërë pyetje se çfarë keni dëgjuar për këto
17 ndalime dhe prej kujt i kishit dëgjuar, dhe desha t'ju pyes
18 për këtë pjesë specifike.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
20 Prokurore, dua t'i kërkoj znj. Sekretare nëse mund ta
21 zvogëlojë paksa transkriptimin në ekran se ju thoni nga
22 rreshti 8 deri në 22, siç e thatë edhe ju.

23 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Jo unë thjesht po jepja
24 kontekstin.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,

1 po e kam fjalën që e kam fjalën që ta shohim të tërë pjesën,
2 vetëm për këtë. Por mund të vazhdoni tani.

3 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Unë po ja shpjegoja një herë
4 dëshmitarit se po bëheshin pyetjet dhe përgjigjet për atë që
5 ai kishte dëgjuar.

6 Py. Desha t'ju pyes, z. Mehmetaj, për atë pjesën kur keni
7 thënë në rreshtin 18 deri në rreshtin 20: "Nuk e di.." -- po
8 lexoj përgjigjen tuaj: "Nuk e di, nuk kam informacion lidhur
9 me këtë. Besoj se për këtë mirë është t'ja bëni pyetjen
10 komandantit të gueriles, komandat Calit".

11 Ju kujtohet që keni thënë kështu?

12 Pë. Unë po e shoh që kam thënë kështu po nuk po më kujtohet
13 cila ka qenë para këtyre, pse ka ardhur ky moment, cila ka
14 qenë juaj, e Prokurorit në atë kohë, ose nëse më lejoni, po e
15 lexoj këtu pak, që ta di pak më mirë.

16 Py. A mund të lexoni në anglisht, z. Mehmetaj?

17 Pë. Po e lexoj vetëm për vete, po?

18 Py. Pra në mënyrë që t'ju udhëzojë në leximin tuaj, pyetja
19 ishte për faktin që po mundohesha të kuptoja nëse informacioni
20 për ndalimin ishte informacion për të cilin z. Cali, komandant
21 Cali, do të kishte dëgjuar më përpara. Domethënë këtë dua të
22 kuptoj nga pyetja.

23 Pë. Po, në rregull. Po. Unë e kam dhënë këtë përgjigje këtu
24 që ju thatë po përgjigjen e kam dhënë pas asaj që ju keni
25 insistuar që a e ka ditur komandant Cali, gjëraa të tjera,

1 domethënë. Janë pyetje unë kam kërkuar që ato që unë po i
2 them, mos me i orientu diku tjetër, që komandant Cali, e
3 shpjegova shumë mirë, nuk e ka pasur përgjegjësi të vetën këtë
4 punë. Nuk e kemi diskutu asnjëherë mes vetit. E ideja që me
5 pyet komandant Calin, jo vetë për këtë punë, por të gjitha
6 punët, ju e keni pasur në dorë dhe keni mundur të pyesni.
7 Py. Po, z. Mehmetaj, po ju e keni dhënë vullnetarisht këtë
8 informacion. Pyetja që ju bëj juve nuk ishte në qoftë se
9 komandant Cali e dinte apo jo, po ju keni thënë që kjo është
10 diçka që në fakt ju thatë: "Mendoj që për këtë është mirë që
11 t'i bëni pyetjen komandantit të gueriles, komandant Calit".
12 Pra e keni dhënë vetë vullnetarisht këtë informacion.

13 Dhe pyetja ime është kjo: komandant Cali a ishte në një
14 pozitë, apo në gjendje që të kishte dëgjuar që të kishte
15 dëgjuar për ndalimet në Zllash?

16 Pë. Përgjigja ime është jo.

17 Py. Në rregull. A do habiteshit, z. Mehmetaj, që ne t'ju
18 thoshim që kemi dëshmi nga z. Mustafa që edhe ai ishte i
19 informuar apo kishte dëgjuar zëra lidhur me civilët që ishin
20 mbajtur të ndaluar në vendstrehimin në Zllash? E kuptoj që ju
21 nuk jeni në dijeni të saj, domethënë të faktit që z. Cali e
22 dinte këtë, apo jo?

23 Pë. Po sigurisht që habitem, ndoshta. Nuk e di.

24 Py. Në rregull.

25 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Do jap referencat për

1 procesverbal, të nderuar Gjykatës. Kjo i është bërë e ditur
2 ZPS-së në intervistë që ka pasur me z. Mustafa me datë 19
3 nëntor të vitit 2019. Transkriptimi është në faqen 069404-TR-
4 ET, Pjesa 7, faqja 17, rreshtat nga 7 deri në 15.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
6 Prokurore, faleminderit. Më fal që po ju ndërpres. Thjesht
7 doja t'ju bëja të ditur që ne do të vazhdojmë edhe për 25
8 minuta të tjera, pastaj do të bëjmë 15 pushim, e pastaj do të
9 vazhdojmë për gjysmë ore më pas. Domethënë ky është plani që
10 kemi për ditën e sotme.

11 Në rregull?

12 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
13 Gjykatës.

14 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]
15 Py. Pra ju thatë që ju nuk e dinit për këtë gjë.

16 Në qoftë se nuk e mendonit që komandant Cali kishte
17 njohuri për këtë, pse i keni kërkuar Prokurorëve që ta pyesin
18 komandant Calin lidhur me këtë gjë, pra lidhur me ndalimet. Po
19 i kthehem edhe një herë pjesës së dëshmisë që i keni dhënë
20 Prokurorisë, për ta kuptuar më mirë. Pra, pse e keni thënë
21 këtë gjë? Dhe ndërkohë tani thoni që nuk dinit që kishte
22 njohuri?

23 Pë. Unë po e them të vërtetën, sepse nuk di që ka pasur
24 njohuri edhe nuk e besoj këtë. Ana tjetër, pse unë kam thënë
25 me pyet komandant Calin, unë mendoj që gjatë intervistës --

1 Py. Ju kërkoj ndjesë që ju ndërpres përsëri. Pra pyetja ime
2 është kjo: pse i kërkuat Prokurorëve që të pyesnin atë lidhur
3 me këtë çështje. A mund të na e shpjegoni pak këtë?

4 Pë. Po unë besoj nuk është i vetmi rast në një intervistë
5 këtu që kam thënë që me pyet Calin kur ju keni insistuar në
6 diçka që ndoshta për mua ka qenë interesant insistimi i juaj.
7 dhe unë e kam -- edhe më herët në këtë intervistë kam thënë
8 disa herë që urdhno, pyesni Calin dhe ai ju tregon të
9 vërtetën. Po jo me specifikisht që me këto, që me tendencë që
10 me pyet Calin se ai e di. Nuk e kam bërë këtë punë. Ju e
11 mundoni me e prodhu, por unë nuk e kam bërë këtë punë. Nuk kam
12 pasur tendencë, si me thënë "pyesni Salih Mustafën, sepse ai
13 ju tregon qysh e tek, çfarë ka ndodhur atje". Sepse s'e kam
14 ditur as vetë.

15 Py. Në rregull, e qartë. Ndalojmë këtu.

16 Dua t'ju them, informacioni që ka dhënë z. Mustafa në
17 këtë intervistë, pra bëhet fjalë për transkriptimin me
18 referencën që e përmenda pak më përpara, por bëhet fjalë për
19 Pjesën 8, faqe 6, rreshtat nga 11 deri në 14 e 15.

20 Z. Mustafa ka thënë si më poshtë, pra duke folur lidhur
21 me këtë dhomën e ndalimit, ka thënë që:

22 "Çdo kush që ishte përreth aty, e quanin atë dhoma e
23 ndalimit".

24 A të kujton ndonjë gjë kjo, se edhe ti ke qenë përreth
25 aty në atë kohë? A ke dëgjuar për këtë dhomë ndalimi, siç e

1 quan z. Mustafa në dëshminë e tij?

2 Pë. Për atë çka kam dëgjuar prej burimeve jo të sigurta, prej
3 rrugëve, kulloreve, për atë punë, ua thashë. Tjetër nuk kam
4 asnjë gjë, nuk kam dëgjuar asnjë gjë.

5 Py. Pra, në përgjigje të pyetjes time, a mund të na thoni në
6 qoftë se keni dëgjuar për një dhomë ndalimi në Zllash, po apo
7 jo?

8 Pë. Po u përgjigja më herët, e nderuara Prokurore, për atë që
9 kam dëgjuar.

10 Py. Në rregull. Përsëri, a keni dëgjuar konkretisht
11 shprehjen, dhomë ndalimi. Po apo jo? Në qoftë se thua po,
12 atëherë mund të mundohemi ta sqarojmë.

13 Pë. E shpjegova më herët çka kam dëgjuar prej burimeve jo të
14 sigurta, prej -- dhe e thashë aty, atë çka unë e kam dëgjuar,
15 unë e thashë. Komplet. Qysh e kam thënë edhe këtu në këtë faqe
16 interviste me Prokurorin.

17 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Vetëm një çast, të nderuar
18 Gjykatës, më duhet të shikoj sferën tjetër të pyetjeve.

19 Py. Në rregull, z. Mehmetaj, faleminderit për durimin.

20 Dëshiroj të diskutoj me ju disa çështje të cilat kanë të
21 bëjnë me deklaratat që keni dhënë.

22 Së pari, për ta përmbledhur ose për të dhënë një hyrje,
23 juve jeni thirrur nga ZPS-ja me datë 17 dhjetor të vitit 2019.
24 E mbani mend këtë?

25 Pë. Po, besoj, po. Në rregull.

1 Py. A e keni bërë publike këtë gjë? Domethënë faktin që jeni
2 marrë në thirrje nga ZPS-ja për intervistë?

3 Pë. Në momentin kur e kam marr ftesën në zyrën time, s'më
4 kujtohet atë natë në mbrëmje apo të nesërmen, e kam publiku në
5 rrjetin social Facebook, dhe ua kam bërë me dije njerëzve. I
6 kam pasur arsyet e mia përse, atë që e kam marrë ftesën --

7 Py. Në rregull. Atëherë ta shikojmë pak postimin në Facebook.

8 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] A mund t'i kërkoj ju lutem që
9 të nxjerrim të dy versionin në origjinal dhe gjithashtu edhe
10 përkthimin. Bëhet fjalë për dokumentin e numër identifikimi
11 ERN SPOE00325284, dhe nëse mund t'ju kërkoj që përbri të mund
12 të shfaqni edhe përkthimin përkues në anglisht. Dokumenti
13 identifikohet si SPOE00325248-ET.

14 Py. Versionet në origjinal i kemi në ekran, z. Mehmetaj. Për
15 këtë e keni fjalën, për këtë postim, apo jo?

16 Pë. Po, ky është postimi im.

17 Py. Pra është një postim me datë 18 nëntor me datë 2019, që
18 është një ditë pasi e keni marrë ftesën nga ZPS-ja.

19 Tani do të lexoj një pjesë të saj, të postimit. Versionin
20 në origjinal e keni përpara.

21 Ju thoni këtu: "Dje pasdite, një prej hetuesve të
22 Gjykatës Speciale na solli ftesën për në Hagë". Pra nuk do ta
23 lexoj të gjithën, por thjesht ca pjesë të këtij postimi për
24 t'ju bërë disa pyetje më pas.

25 Në pjesën e dytë, ose në paragrafin e dytë, ti thua që:

1 "Do t'i përgjigjem kësaj thirrjeje me krenari edhe pse
2 vazhdoj me mendu që kjo është një Gjykatë e padrejtë dhe e
3 njëanshme".

4 Pra, ju e keni quajtur këtë Gjykatë të pa drejtë dhe të
5 pa njëanshme [sipas përkthimit]. E drejtë?

6 Pë. Po, kështu. Kështu e kam quajtur dhe kam mendimin tim
7 edhe sot, që muj me e sqaru, këtë çka kam dasht me thanë aty.
8 Unë -- Gjykata...

9 Py. Më lejoni që ta përfundoj këtë pjesë.

10 Pra, ju e keni shprehur vullnetarisht opinionin tuaj edhe
11 gjatë intervistimit. Pra, gjatë intervistës me ZPS-në. E mbani
12 mend?

13 Pë. OK.

14 Py. Kjo jepet në Pjesën 1 të intervistës që i keni dhënë ZPS-
15 së në faqen 7, në rreshtat nga 17 deri në 23, me 223 janar të
16 vitit 2020. Dhe ju thoni që:

17 "Kjo është një Gjykatë e njëanshme, sepse kjo është një
18 gjykatë që duhet të ishte krijuar shumë vite më përpara, në
19 mënyrë që të kishte trajtuar krimet e luftës të kryera kundër
20 komunitetit".

21 Pra, sërish në intervistë juve na e përsëritët mendimin
22 tuaj lidhur me këtë gjykatë dhe këtë informacion e keni dhënë
23 vullnetarisht. Nuk është se ju bë pyetje për të marrë këtë
24 përgjigje. A e mban mend këtë?

25 Pë. Po.

1 Py. A keni folur me z. Mustafa përpara ose dhe pas
2 intervistës që është realizuar nga ZPS-ja me ju më datë 23
3 janar të vitit 2020. A e mbani mend nëse keni folur me të
4 atëherë?

5 Pë. E nderuar Prokurore, unë që nga mosha 18 vjeçare
6 asnjëherë nuk jam ndarë me Salih Mustafën, kam folur më herët,
7 gjithmonë, mirëpo nëse ju po më pyesni specifikisht për
8 ftesën, kurse më shumë se sa --

9 Py. Ju kërkoh ndjesë që ju ndërpres, z. Mehmetaj, pyetja ime
10 kishte të bënte konkretisht me kohën përpara dhe pas
11 intervistës, domethënë një ditë përpara dhe një ditë mbrapa
12 intervistës. Nuk e bëj pyetjen në mënyrë të përgjithshme.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
14 Mehmetaj, ju lutemi përgjigjuni pyetjes.

15 DËSHMITARI: Normal që jam takuar, se ne kemi përditshmëri
16 bashkë me Calin. Jam takuar, kam folur vetëm që më ka ardhur
17 ftesa. Dhe nuk kam folur më shumë. S'kemi pasur diskutim më
18 shumë për këtë temë.

19 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

20 Py. Pra, ju konfirmoni se jeni takuar me të personalisht apo
21 që keni folur me të. Mund të na e sqarosh pak?

22 Pë. Unë e sqarova, me Salih Mustafën jam takuar. Unë uroj që
23 edhe këtu të triumfojë drejtësia, del dhe takohemi prapë me të
24 dhe gjithmonë -- krejt normale është kjo puna e takimit.

25 Py. Dhe në takimin me të, takimi u bë menjëherë pas apo para

1 intervistës? Dhe ju nuk keni folur fare rreth objektit të
2 intervistës?

3 Pë. ...qëllim për me diskutu për intervistën nuk kemi pasur
4 ne, sepse unë e kam marrë prej Prokurorit kallëzimin që nuk
5 bën me diskutu me kurrkënd asgjë çka është folur këtu dhe unë
6 e kam respektuar atë. Takim me Calin kam pasur, por e kam
7 marrë edhe ky kur ka dalë prej intervistës, nuk e ka diskutu
8 sepse ka marrë urdhnesë dhe e respekton. Ky, dhe unë dhe të
9 gjithë e respektojmë drejtësinë.

10 Py. Mirë atëherë, përgjigja juaj është jo.

11 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] A mund të shfaqni në ekran
12 dokumentin SPOE00325449-00325450.

13 E di që nuk është praktikë që t'i tregohet publikut dhe
14 dëshiroja të pyesja që të mos tregohet për publikun.

15 Py. Do të jap një përshkrim për publikun, megjithëse ata nuk
16 do ta shohin dokumentin. Ky është një dokument i cili tregon
17 telefonatat e bëra nga Salih Mustafa dhe përdoruesit e tjerë
18 në periudhën dhjetor dhe më pas në periudhën nga dhjetori i
19 2019, deri në shkurt 2020.

20 Z. Mehmetaj, ju lutem a mund të shikoni pak numrin 1, ju
21 lutem. Shihni numrin mbi emrin Bimi dhe pa e përmendur emrin,
22 ju lutem a mund të na konfirmoni që ky është numri juaj i
23 telefonit apo jo?

24 Pë. [E padëgjueshme] ...ja kështu, këta janë këta dy numrat
25 ja këtu. I njoh shumë, i di përmendësh.

1 Py. Në rregull, shumë mirë.

2 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Tani a mund të kalojmë te faqja
3 e dytë e këtij dokumenti, ju lutem?

4 Py. Z. Mehmetaj, ju lutem shikoni pikën 8. Këtu tregohet se
5 është bërë një telefonatë midis jush dhe z. Mustafaj me datë
6 22 janar, që është një ditë përpara intervistës, e saktë?

7 Pë. Unë po e shoh këtu, por po shoh "not answered". Kjo po
8 shkrua që nuk është hapur telefoni. Nëse nuk jam gabim.

9 Py. E kam fjalën për pikën 8.

10 Pë. Në rregull është, po.

11 Py. Tani mund të kthehemi në faqen e parë të këtij dokumenti.

12 Z. Mehmetaj, do t'ju kërkoja që të shikonit pikën 6 dhe 7.

13 Data është 23 janar 2020, që është dita e intervistimit tuaj
14 nga ZPS-ja. Dhe në qoftë se do të shikojmë kohën, do të

15 kujtoheni nga fakti që e keni marrë në telefon z. Mustafaj në
16 orën 17.19 dhe pastaj në 17.20 në pasditen e datës 23 janar,

17 që është vetëm 5 minuta pas përfundimit të intervistimit nga
18 ZPS-ja. Këtë e dimë nga Pjesa 4, faqe 28 e transkriptimit që

19 na tregon se cila ka qenë koha e përfundimit të intervistës.

20 Mund ta shohim, është ora 17.12. Jeni dakord?

21 Pë. Unë jam dakord sa po shoh këtu, po nuk jam dakord atë që
22 po e mendoni ju që këtu thirrje telefonike -- po më vjen mirë

23 ju që e keni nxjerrë --

24 Py. Unë nuk thashë që mendoj ndonjë gjë, thjesht po ju pyesja
25 në qoftë se jeni dakord apo jo?

1 Pë. Okej.

2 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Mund ta heqim nga ekrani këtë
3 dokument.

4 Py. Z. Mehmetaj, po e bëj në mënyrë të hapur pyetjen. A e
5 konsideroni veten si mik të z. Mustafaj, i akuzuari në këtë
6 lëndë?

7 Pë. Po, patjetër që po. Jo vetëm mik, por ndoshta edhe më
8 shumë se mik.

9 Py. A keni postuar ndonjëherë ndonjë gjë në Facebook në
10 mbështetje të z. Mustafaj.

11 Pë. Shpesh herë, disa herë.

12 Py. Dëshiroj që t'i shikojmë së bashku disa prej këtyre
13 postimeve.

14 A ishit në dijeni që z. Mustafaj ishte thërritur nga ZPS-
15 ja për intervistë në nëntor të vitit 2019?

16 Pë. Nëse kishte pasur mundësi, edhe një herë me e sqaru
17 pyetjen se nuk e kuptova. A isha në dijeni për çfarë?

18 Py. Sigurisht. Pra, a e dinit ju që z. Salih Mustafa kishte
19 marrë ftesë për intervistë me Zyrën e Prokurorit të
20 Specializuar në nëntor të vitit 2019?

21 Pë. [E padëgjueshme].

22 Py. A keni postuar ndonjë gjë lidhur me këtë, domethënë
23 lidhur me faktin që ai do të intervistohet nga ZPS-ja?

24 Pë. Po besoj që po. Nuk e kam shumë -- se është kohë e gjatë.
25 Ndoshta edhe e kam harru, por sigurisht ju e keni atë

Dëshmitari: Brahim Mehmetaj (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. D'Ascoli

Faqe 114

1 dokument. Besoj që po. Kur është nis për Hagë, ndoshta, nuk më
2 kujtohet saktë.

3 Py. Në rregull.

4 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Ju lutem a mund të shfaqet
5 dokumenti me numër identifikimi ERN SPOE00325261 deri në
6 00325281. Më duhet vetëm faqja e parë e versionit në origjinal
7 në ekran. Znj. Sekretare, ju lutem do ju kërkoja që ta
8 shfaqnit përbri këtij dokumenti edhe përkthimin e ZPS-së, që
9 është dokumenti SPOE0032152. Ju faleminderit.

10 Py. A ju kujtohet ky postim, z. Mehmetaj, që mban datën 18
11 nëntor, 2019?

12 Pë. [E padëgjueshme].

13 Py. Z. Mustafa është intervistuar nga ZPS-ja me 19 nëntor,
14 për procesverbal.

15 Pra shohim foto tuajat me z. Mustafaj. E keni shoqëruar
16 atë në aeroportin e Prishtinës, përpara se të largohej nga
17 Kosova. Kështu?

18 Pë. Kjo foto është në aeroport. Unë kam shkuar me e shoqëruar
19 andej. Realisht nuk jam ndier mirë në atë kohë. Realisht nuk
20 ka qenë e drejtë, as ftesa, sikurse nuk është i drejtë as ky
21 proces, sepse është i bazum në deklaratat, në dëshmi të
22 rrejshme. Dhe me atë emocion -- se për një çlirimtar, një
23 luftëtar lirie, një luftëtar i cili ka luftuar për të drejtat
24 e veta për liri, të niset një proces, thashë, që e pengon me
25 jetu edhe në proces tjetër ose në liri. Kam qenë pak i

1 emocionuar. Kam shkruar -- këtu nuk i bie mbrapa kësaj që e
2 kam shkruar, por munem me e sqaru këto fjalë që i kam shkruar
3 këtu.

4 Py. Po. Doja t'ju pyesja në qoftë se i mbani mend deklaratat
5 që sërish bëni kundër kësaj Gjykate në këtë kontekst.

6 Megjithatë mund t'i lexoj edhe unë.

7 Do të lexoj vetëm njëherë. Po shoh këtu pjesën ku ju thoni
8 se:

9 "Gjykata është formuar kundër shqiptarëve të cilët kanë
10 luftuar për çlirim". Dhe pastaj thoni që:

11 "Ky është turp, është padrejtësi, është injorim dhe
12 denigrim që ju bëhet çlirimtarëve".

13 Dhe pastaj në fjalinë e fundit, sigurisht që do ta
14 transmetoj të gjithë tekstin e plotë në ekran, ju thoni:

15 "Paçin turp ata që e kanë ftuar atë dhe që e kanë gatuar
16 këtë".

17 Pra, këtu e keni fjalën për ZPS-në kur thoni "turp të
18 kenë" apo jo?

19 Pë. Po kushdo që e ka ftuar në bazë të deklaratave të
20 rrejshme, në bazë të dëshmive të rrejshme.

21 Py. Okej.

22 Pë. Thashë, kam pasur emocion atëherë, por mendoj edhe tash
23 është duke m'u kthyer emocionimi kur po e paramendoj atë
24 situatë, që i bëhet një padrejtësi një luftëtari të lirisë.

25 Nuk e di a kuptoni ju, po ne kemi pasur shumë nevojë për

1 luftëtarët e lirisë, sepse ata e kanë sjellë lirinë në Kosovë.
2 Megjithëse asnjëherë nuk e përjashtoj kontributin e shtetit
3 tuaj, Italisë, në këtë drejtim.
4 Py. Në rregull, faleminderit.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
6 Prokurore, sa për procesverbal, do të doja që t'i kërkoja
7 Sekretares që ta shfaqte pak më shumë pjesën në anglisht.

8 Ku është kjo shprehja që ju sapo na thatë?

9 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Është rreshti i parafundit.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
11 Faleminderit.

12 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Mund ta hiqni postimin nga
13 ekрани.

14 Py. Z. Mehmetaj, më pas z. Mustafaj u arrestua dhe u soll në
15 godinën e ndalimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës në
16 vitin 2020, në 24 shtator të vitit 2020. Në atë kohë, a e keni
17 lexuar ju aktakuzën me akuzat e ngritura kundër z. Mustafaj?
18 Pë. Jo në atë kohë. Pak më vonë, po.

19 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Ndërkohë, ju lutem a mund të
20 shfaqni në ekran dokumentin SPOE00325341.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
22 Prokurore, do të donim që të bënim një pushim rreth orës
23 15.30, se ora ka disa minuta për të shkuar deri në 15.30
24 kështu që do të doja ta merrnit parasysh këtë.

25 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës, do ta

1 kaloj shumë shpejt. Në qoftë se nuk e keni problem, mund ta
2 përmbledh për katër minuta.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk
4 ke nevojë ta përmbledhësh, vetëm thjesht për të thënë që do të
5 bëjmë një pushim rreth asaj kohe.

6 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

7 Py. Ky është një postim që mban datën 26 shtator to vitit
8 2020, që është dy ditë pas arrestimit të Salih Mustafës dhe
9 është një foto - foto e kohëve të fundit do të thosha, që nuk
10 është foto e kohëve të luftës, pra është një foto ndërmjet ju
11 dhe z. Mustafaj.

12 Unë ju bëra pyetje në qoftë se e kishit lexuar aktakuzën
13 deri në kohën e arrestimit të z. Mustafaj, dhe dua t'ju pyes
14 tani në qoftë se e kishit lexuar aktakuzën kur keni bërë këtë
15 postim në internet në faqen tuaj, pra në 26 shtator të vitit
16 2020?

17 Pë. Me 26 shtator të vitit 2020 unë e kam bërë këtë postim,
18 vetëm këtu jam vetëm me Calin. Nuk kam tekst më duket që kam
19 shkruar. Edhe aktakuzën e di që e kam lexuar pak më vonë.

20 Py. Ju kërkoj ndjesë, z. Mehmetaj, nuk ju kërkoja për komente
21 apo për një gjë tjetër por thjesht të pyeta në qoftë se deri
22 më datë 26 shtator e kishit lexuar aktakuzën. Po apo jo? Se
23 thatë që e keni lexuar më vonë. Thjesht po mundohem që të
24 kuptoj se e keni lexuar më përpara ose më vonë?

25 Pë. ...këtë ditë a kam lexuar apo jo. Por e kam lexuar më

1 vonë aktakuzën.

2 Py. Në rregull, kur thua "më vonë", për çfarë e ke fjalën.

3 Domethënë, ndoshta çështje javësh, muajsh? Sa për të na dhënë
4 një ide të përgjithshme.

5 Pë. [E padëgjueshme].

6 Py. Në rregull, mirë atëherë disa ditë më vonë. Domethënë pas
7 24 shtatorit e keni lexuar aktakuzën. Kur e lexuar aktakuzën,
8 a u vutë në dijeni për vendin ku pretendohet që të ishin kryer
9 krimet?

10 Pë. Nëse e kam të qartë, unë e kam lexuar aktakuzën ashtu siç
11 ka qenë e shkruar aty dhe për mua s'ka qenë e pranueshme dhe
12 as e drejtë. E po aty është shkruar --

13 Py. Po për datën e aktakuzës, pikët e aktakuzës, a i lexuat
14 aty apo jo?

15 Pë. Për data, për emra, për vende që për mua nuk janë reale.

16 Py. Në rregull, pra do ta marr këtë si po.

17 A mund të kalojmë në postimin e fundit dhe pastaj do të
18 bëjmë pushimin.

19 Dua t'ju tregoj një postim më të kohëve të fundit, me
20 datë 10 prill të vitit 2021, rreth një vit më përpara.

21 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Është dokumenti SPOE00325407
22 deri në SPOE00325428.

23 Do të doja që të shfaqnit dy faqet e para, ngjitur me
24 njëra-tjetrën nëse është e mundur.

25 Po mund ta shohim. Lidhur me faqen e dytë të postimit, ju

1 shohim që keni vendosur një bluzë. Jeni ju ky personi që keni
2 veshur këtë bluzën, z. Mehmetaj? Apo jo?

3 Pë. Po, unë jam aty. E kam vesh këtë send bluzën, është Salih
4 Mustafa këtu. Nëse s'gaboju, te zemra e kam qitë.

5 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Në rregull. Mund ta lemë faqen
6 1, me tekstin dhe përbri kësaj mund të tregojmë versionin e
7 përkthyer në anglisht që është dokumenti SPOE00325427.

8 Py. Sërish dua që t'ju pyes lidhur me deklaratat që keni bërë
9 në këtë kontekst, thuhej se një vit më përpara.

10 I kemi tekstet në të dyja versionet në të dyja gjuhët,
11 kështu që do të citoj disa rreshta për ju.

12 Në rreshtin e parë thoni:

13 "Gjithmonë e kemi luftu Serbinë bashkë, prej moshës 17
14 vjeç".

15 Pastaj në rreshtin e dytë keni thënë që:

16 "Ne nuk e kemi kthyer asnjëherë kokën prapa në raste
17 sfidash dhe rreziqesh".

18 Paragrafi i dytë në fund sërish duket sikur bëni thirrje
19 për turp, pra "Turpi i mbuloftë të gjithë, argatët e
20 hyzmeqarët, sahanlëpirës e servilë".

21 Ndërkohë që kemi një pjesë tjetër që është paragrafi i
22 tretë:

23 "Me urrejtjen ndaj vendorëve që votuan Specialen, duke
24 kryer një shërbim ndaj armikut dhe duke u bërë servilë të disa
25 ndërkombëtarëve".

1 Dhe pasta në fund thoni:

2 "Cali është Bimi e Bimi është Cal".

3 A e mbani mend që keni bërë këto postime.

4 Pë. Po, po. I kam bërë. Po në rregull është krejt.

5 Py. Pra, në këtë postim keni veshur një bluzë ku është

6 postuar fotografia e z. Salih Mustafa për të treguar

7 mbështetjen ndaj tij. E saktë kjo?

8 Pë. E saktë.

9 Py. Dhe ende e mbështesni atë edhe sot e kësaj dite, apo jo?

10 Pë. Faleminderit për pyetjen, e nderuar Prokurore. Unë normal

11 që këtu jam sot për ta mbështetur drejtësinë, sepse besoj

12 shumë që drejtësia do të shkojë në dobi të luftëtarit të

13 lirisë, Calit, shokut tim. Edhe unë e mbështes drejtësinë dhe

14 unë nuk jam në gabim në rast se e bëj këtë punë. Gjithmonë do

15 ta mbështes drejtësinë, jam i sigurt këto që i them. Jam i

16 sigurt në dëshmitë tona. Kjo Gjykatë ka pasur njerëz që kanë

17 thënë të pavërteta këtu. Kanë thënë gjëra të cilat nuk kanë të

18 bëjnë me të vërtetën, me realitetin. Unë e besoj që e nderuara

19 Gjykatëse këtë punë e çon deri në fund. Drejtësinë do ta qesë

20 në dritë, ashtu siç i ka hije. Unë kam respekt për Gjykatësen

21 dhe për Gjyqin. Mos të bëj ndonjë deklaratë, por --

22 Py. Në rregull, faleminderit. Juve në fakt keni thënë diçka

23 të ndryshme më përpara për gjykatën por le ta lemë këtu.

24 Faleminderit shumë, të nderuar Gjykatës, besoj që ka

25 ardhur koha për të bërë pushimin.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani
2 për tani do të bëjmë pushim.

3 Znj. Sekretare, ju lutem, mund ta shoqëroni dëshmitarin
4 jashtë sallës së gjyqit.

5 Do të bëjmë pushim të shkurtër vetëm për 15 minuta.

6 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
8 Seanca ndërpritet këtu.

9 --- Pauza filloi në orën 15:35

10 --- Seanca rifillon në orën 15:50

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
12 se u rikthyet.

13 Përpara se të vijojmë me kundra pyetjet që do t'i bëjë
14 znj. Prokurore, z. Mehmetaj, kam një koment për ju.

15 Në faqen 98, rreshti 2, 3, pasi po jepnit ju përgjigje,
16 bëtë -- thatë diçka për Italinë dhe kontributin kundrejt
17 vendit tuaj. Ju lutem të mos bëni komente personale apo sulme
18 kundër ndokujt këtu në sallë. Nuk e lejojmë.

19 DËSHMITARI: Por ju kërkoj ndjesë nëse ashtu është
20 kuptuar. Unë fjalë të mira fola për vendin që e përmenda, që
21 na kanë ndihmuar në çlirim.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
23 por nuk duhet të bëni komente personale.

24 Znj. Prokurore keni fjalën, nëse dëshironi të vazhdoni.

25 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës,

1 faleminderit shumë.

2 Py. Z. Mehmetaj, dua t'ju pyes sa i takon dijenisë tuaj
3 lidhur me disa anëtarë të UÇK-së. Kam një listë emrash që do
4 t'ua përmend.

5 Fillimisht, a e njihni dikë me emrin Ilmi Velaj?

6 Pë. Po.

7 Py. Mund të na e thoni si e ka emrin dhe mbiemrin?

8 Pë. Ky është emri që di unë.

9 Py. Mos e kishte Ilmi Rakovica?

10 Pë. Edhe mund ta ketë, po unë e di këtë -- nuk e di saktë
11 tash. Unë realisht ky është emri që unë di, unë e di kështu,
12 se s'kam pasur njohuri me të.

13 Py. E dini si e kishte nofkën, nëse e kishte të tillë?

14 Pë. Po, kam dëgjuar "Vdekja".

15 Py. Pse e thërrisnin me këtë nofkë atë?

16 Pë. Po unë nuk e di atë punë, nuk e besoj që e ka thirr
17 dikush, apo ai ja ka vu vetes besoj, se të gjithë ne ja kemi
18 vu -- domethënë të gjithë ata njerëz që kanë funksionuar në
19 atë kohë, unë e shpjegova shumë mirë, domethënë. Pseudonimi im
20 Bimi është që nga fëmijëria ndërsa njerëz të tjerë, disa e ka
21 pasur nevojë. Edhe Cali e ka që nga fëmijëria pseudonimin
22 Cali. Nuk ka pasur nevojë me u fsheh me atë punë. E disa të
23 tjerë kanë pasur nevojë me vendos pseudonim dhe kjo ka qenë e
24 lirë që secili e përzgjedh vetë se çfarë pseudonimi ja vendos
25 vetes.

1 Py. Po, dhe "Vdekja", kështu njihej ai, me këtë nofkë njihej
2 ai nga të tjerët. Kështu?

3 Pë. Po kështu e ka përdorur, kështu kam dëgjuar unë.

4 Py. Nofka siç e thërrisnin të tjerët, pyetja ime ishte
5 ndryshe.

6 Pë. Nuk e kam kuptu pyetjen.

7 Py. A e quanin "Vdekja" edhe të tjerët? Të tjerët a e
8 thërrisnin "Vdekja"?

9 Pë. Po, unë besoj po. Besoj po. Unë s'e kam thirrur
10 ndonjëherë se s'e kam takuar po besoj po.

11 Py. Mirë. A ishte anëtari i BIA-s ai?

12 Pë. Po, ka qenë, po.

13 Py. A ishte i pranishëm në Zllash?

14 Pë. Këtë nuk e di, se nuk e kam parë unë. Nuk e kam takuar
15 asnjëherë.

16 Py. Keni dijeni për ndonjë gjë tjetër në lidhje me të, në
17 lidhje me sjelljen e tij?

18 Pë. Po, e kam -- më kujtohet kështu që më ka treguar Cali që
19 është liruar prej organizimit që ka qenë në BIA për shkak të
20 disa sjelljeve që i ka pasur jo në rregull ai. E di që është
21 demobilizuar, i është marrë arma dhe është lënë i lirë, si
22 qytetar.

23 Py. A kishte nam të keq, reputacion të keq? A ke dijeni nëse
24 kishte ndonjë reputacion të keq? Ndonjë të shkuar penale?

25 Pë. Po unë këtë dijeni që po i them tash i kam kuptuar mbas

1 luftës, se s'e kam ditë. Atëherë për të shkume penale s'e kam
2 ditë, e as tash nuk e di çfarë të shkume penale ka, por është
3 liruar nga detyra për shkak të disa gabimeve ose gjërave që i
4 ka bërë ai.

5 Py. Çfarë veprimesh, a e di, kanë çuar te largimi i tij?

6 Pë. Nuk e di, më shumë nuk di për atë punë.

7 Py. Dua që të sqaroj diçka që thatë pak më parë në
8 intervistën me ZPS-në, keni thënë më parë në intervistën me
9 ZPS-në. Do të citoj nga Pjesa 3, faqja 32, 072957-TR-ET.

10 Këtu na keni thënë -- pra pyetja ishte që: "Atij i doli
11 nami i keq".

12 Atëherë ju jeni përgjigjur "po".

13 Pë. A ban një konsultë me dikë prej - kështu, prej
14 administratës ose avokatin ose me Gjykatësen ose --

15 Py. Dëshironi që të paraqesim në ekran transkriptimin? Po
16 këtë mund ta bëjmë.

17 Pë. ...te Gjykatësja direkt. Duhet me pas kujdes pak kur
18 flasim për njerëzinë, për epitetet ndaj tyre, për gjëra sepse
19 mund të prodhohet ndonjë konflikt, a ndonjë -- kah vijon nëse
20 s'kemi kujdes.

21 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, a mund të
22 sugjeroj që të kalojmë në seancë private?

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
24 Sekretare, ju lutem të kalojmë në seancë private.

25 [Seancë private]

Dëshmitari: Brahim Mehmetaj (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. D'Ascoli

Faqe 125

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Brahim Mehmetaj (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. D'Ascoli

Faqe 126

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Brahim Mehmetaj (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. D'Ascoli

Faqe 127

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Brahim Mehmetaj (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. D'Ascoli

Faqe 128

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16 [Seancë e hapur]

17 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
18 jemi në seancë publike.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Faleminderit.

21 Znj. Prokurore, mund të vazhdoni.

22 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar

23 Gjykatës.

24 Py. Z. Mehmetaj, pyetja tjetër është kjo: a keni dijeni për

25 dikë të quajtur me nofkë Tabuti?

- 1 Pë. Po.
- 2 Py. A mund të na thoni se çfarë do të thotë fjala "tabut"?
- 3 Pë. "Tabut" do të thotë ai vendi ku vendoset i vdekuri.
- 4 Py. A mund të na thoni emrin dhe mbiemrin e personit që
- 5 nofkën e kishte Tabuti?
- 6 Pë. Emri është Nazif, por mbiemri nuk jam shumë i sigurt. Nuk
- 7 e di, por Nazif është emri.
- 8 Py. Ne kemi informacion që emri e mbierin e ka Nazif Musliu,
- 9 nuk e di a të thotë diçka.
- 10 Pë. Jo, nuk jam i sigurt për këtë mbiemër.
- 11 Py. Ishte anëtar i BIA-s Tabuti që njihnit?
- 12 Pë. [E padëgjueshme].
- 13 Py. Në cilin sektor të BIA-s ishte?
- 14 Pë. Ka qenë në një prej njësive të gueriles BIA. Mund të
- 15 jetë edhe -- nuk e di saktë, për Zotin, muj me gabu për këtë
- 16 punë, nuk e di. Por në një prej njësive të qytetit BIA ka
- 17 qenë dhe sigurisht është edhe me furnizime është marrë, ka
- 18 qenë sektor logjistike ai, nuk e di saktë. Këtë veç po e them
- 19 kështu, po e supozoj, por nuk jam i sigurt.
- 20 Py. Mirë. Njihni dikë me emrin Bahria?
- 21 Pë. Për dikë që e ka emrin Bahri, besoj se po, nëse është
- 22 fjala për atë që unë njoh.
- 23 Py. Mund të na e thoni emrin e plotë si emër e mbiemër që të
- 24 kuptojmë në qoftë se flasim për të njëjtin person?
- 25 Pë. Nëse është fjala për Bahri Gashin, po. Nëse është ndonjë

- 1 Bahri tjetër, nuk e di, nuk e njoh.
- 2 Py. Çfarë nofke kishte Bahri Gashi, nëse kishte?
- 3 Pë. Bafta.
- 4 Py. Ka ndonjë kuptim kjo nofkë?
- 5 Pë. Jo. Është shkurtesa e emrit Bahri. Besoj.
- 6 Py. Ishte anëtar i BIA-s?
- 7 Pë. Po, ka qenë anëtar, po.
- 8 Py. Në cilin sektor të BIA-s apo çfarë roli kishte?
- 9 Pë. Bahri Gashi aktivitetin e vet e ka zhvilluar në një kohë
10 në Shqipëri, pastaj ka ardhur këtu në Prishtinë dhe ai i është
11 bashkuar BIA-s dhe në momentin kur Isa Kastrati, zëvendës
12 komandanti i BIA-s ka ndërruar jetë në luftime, Bahri Gashi
13 ka marrë përgjegjësinë e zëvendësit të parë të Calit,
14 zëvendëskomandanti ose ndihmësi i parë i Calit, është emëruar
15 Bahri Gashi.
- 16 Py. E kam kuptuar mirë që pasi ju vetë morët rolin në nivel
17 të komandës së Zonës së Llapit në shkurt të vitit 1999, Isa
18 Kastrati u bë zëvendëskomandant apo asistenti i parë i z.
19 Mustafaj?
- 20 Pë. Kështu është, po.
- 21 Py. Po, dhe kjo ka ndodhur deri sa ai vdiq, më 21 ose 23
22 prill të vitit 1999?
- 23 Pë. [E padëgjueshme].
- 24 Py. Dhe pas tij, asistenti i parë apo zëvendëskomandant u bë
25 Bahri Gashi?

1 Pë. Po.

2 Py. Sot ju bë një pyetje për dikë që duhej Afrim. Thatë që
3 nuk ja dinit edhe mbiemrin. Kështu?

4 Pë. Jo, nuk kam shumë njohuri për këtë punë. Nuk ja di
5 mbiemrin. Një Afrim ka qenë aty te BIA por nuk e njoh me të
6 thënë të drejtën. S'kam as kontakt, as kam pasur kontakt edhe
7 gjatë kohës së luftës. Jo as thash, nuk e di saktë për
8 mbiemrat, sende të tjera.

9 Py. A kishte një ushtar të BIA-s të quajtur Fatmir?

10 Pë. Ka pas, po.

11 Py. Mbiemri ju kujtohet, apo nofka?

12 Pë. Nuk më kujtohet as nofka, as mbiemri. Nuk më kujtohet.

13 Py. Pra, i drejtoheshit me emrin Fatmir?

14 Pë. [E padëgjueshme].

15 Py. Po dikush tjetër i quajtur Avni?

16 Pë. Për këtë nuk e di.

17 Py. Thatë gjithashtu se njihnit dikë të quajtur Darda.

18 Pë. Po, ka qenë. Po.

19 Py. Të gjithë këta ishin anëtarë të BIA-s?

20 Pë. Përveç atyne që thash që nuk e di, Avni nuk e di kush
21 është, për këta ët tjerët, po kanë qenë të gjithë pjesëtarë të
22 BIA-s. Nuk e di kush është Avniu. Edhe mund të ketë qenë por
23 unë nuk e di.

24 Py. Po. Për Avniun nuk e dinit nëse ishte anëtari i BIA-s apo
25 nëse kishte mbiemër.

1 Pë. Por me emër s'po më kujtohet. Nuk e di. Nëse keni ndonjë
2 fotografi.

3 Py. Po Dardani, thatë që ishte anëtari i BIA-s, po? Po emrin,
4 mbiemrin, a ja dini?

5 Pë. [E padëgjueshme].

6 Py. Pastaj emri i fundit që kam është Bujar.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.

8 Prokurore, pas pak do të na duhet ta mbyllim. Për sot, flas.

9 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po, e nderuar Gjykatë. Me këtë
10 unë e kam mbyllur pjesën për emrat që kisha në listë kështu që
11 mendoj që është mendimi i duhur për ta mbyllur për sot.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

13 Faleminderit shumë. Po a mund ta informonin Trupin Gjykses,
14 edhe sa kohë do t'ju duhet nesër për pyetjet?

15 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës, mund
16 të shikoj prapë, por nuk besoj se do të më duhen më shumë se
17 15 minuta.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
19 rregull.

20 Mbrojtësja e Viktimave, nesër dëshironi që t'i bëni
21 pyetje dëshmitarit? Sigurisht ju nuk e dini se ç'pyetje do të
22 bëhen në këto 15 minuta të fundit, por deri tani nëse mund të
23 na jepni një vlerësim se ku qëndroni për këtë.

24 ZNJ. PUES: [Përkthim] Unë disa pyetje i kam, përveç nëse
25 do të mbulohen nga pyetjet e tjera të ZPS-së, por nuk besoj më

1 shumë se 20 minuta maksimumi. Mbase edhe më shkurt.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Faleminderit shumë.

4 Dhe ma merr mendja që për të është shumë herët që ju
5 të thoni nëse doni që të bëni pyetje plotësuese apo jo.

6 Z. VON BONE: [Përkthim] Mendoj se do t'i bëjmë disa
7 pyetje plotësuese.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

9 Faleminderit shumë.

10 Z. Mehmetaj, për të ne do ta bëjmë ndërprerjen e
11 seancës në këtë moment. Ju uroj që të pushoni mirë sot. Ju
12 lutem deklaratën tuaj që e keni dhënë këtu mos ta diskutoni me
13 askënd. Do të ri shihemi sërish nesër në orën 09:30 këtu në
14 sallë. Faleminderit.

15 DËSHMITARI: Gjykatëse, faleminderit. Gjyqtarë.

16 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

18 Faleminderit, znj. Asistente e sallës.

19 Të shohim, znj. Prokurore, dëshironi që të ngrini ndonjë
20 çështje tjetër tani?

21 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Jo.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

23 Mbrojtësja e Viktimave?

24 ZNJ. PUES: [Përkthim] Jo, faleminderit.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Avokati i Mbrojtjes?

2 Z. VON BONE: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës, sa i
3 takon rendit të dëshmitarëve, është vetëm një pyetje nëse
4 duhet që ta bëjmë me protokoll, me parashtrim të protokolluar,
5 apo me email, sepse nuk është e qartë kjo. Për shembull, sipas
6 procedurës së [e pakuptueshme] nuk ka qenë e qartë nga ana e
7 Prokurorisë, por nëse është problem, ta bëjmë edhe parashtrim
8 të protokolluar.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ne do
10 të preferonim parashtrim të protokolluar. Faleminderit që e
11 bëtë këtë pyetje.

12 Z. VON BONE: [Përkthim] Po me shumë gjasë do ta bëjmë për
13 të gjithë muajin prill. Do të përfshijmë sigurisht edhe javën
14 e ardhshme dhe do të supozojmë tre dëshmitarë për javë.
15 Faleminderit.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
17 duhet të mbani parasysh edhe vlerësimin tuaj. Do të ishte mirë
18 që për t'ju përshtatur më mirë kalendarit, mund të ndryshoni
19 edhe rendin, por këtë jua lë juve në dorë. Por nëse do të keni
20 probleme për këtë, gjithmonë mund ta ngrini si çështje përpara
21 Trupit Gjykses.

22 Z. VON BONE: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar].

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
24 rregull atëherë. Nëse nuk ka gjëra të tjera për t'u ngritur
25 sot, do të rifillojmë nesër, e enjte 24 mars. Vetëm për një

1 sesion, nga ora 09.30, deri në orën 11.00. Të shikojmë nëse do
2 të përfundojmë nesër, përndryshe pastaj do të vijojmë të
3 hënën. Nuk duam që t'i ngutim gjërat.

4 Falënderoj palët dhe Mbrojtësen e Viktimave për praninë.
5 Gjithashtu falënderoj znj. stenografe dhe përkthyesit,
6 teknikët audio-vizivë, dhe personelin e sigurisë për
7 asistencën.

8 Këtu ndërpritet seanca.

9 --- Seanca mbyllet në orën 16.19

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25